

INTERPRETIMI I ËNDRRËS NË LETËRSI / DREAM INTERPRETATION IN LITERATURE

VALBONA GASHI BERISHA
Fakulteti i Filologjisë
Universiteti «Hasan Prishtina»
Prishtinë, Kosovë
E-mail: valbonagashi@uni-pr.edu

Përmbledhje

Prej Antikititetit grek e deri në ditët e sotme, letërsia ka trajtuar tema të ndryshme dhe njëra prej preokupimeve më të rëndësishme ka qenë ëndërra. Artemidori është interpretuesi më i njohur i ëndërrave në Antikititetin grek dhe shumë i famshëm gjatë gjithë periudhës së mesjetës. Më vonë edhe Frojdi ka pasë një konsideratë të veçantë për shkrimet e tij. Floberi e paraqet në mënyrë ironike ëndrrën e Ema Bovaris e cila e paknaqur me jetën e saj me Karlin, ëndërron për një "muaj mjalti". Mund të themi se të gjithë ne, sikurse Ema dhe personazhet tjerë ëndërrojmë për një jetë romantike, për një jetë më të hareshme, për një moment ideal që vetëm ëndërra i realizon. Në këtë punim do të shtjellojmë ëndrrën e personazhit më të njohur të letërsisë frënge të marrë nga romani *Madam Bovari* i Gystav Flober, ëndrrën e Ema Bovaris.

Abstract

From Greek antiquity until today, literature has treated various topics and one of the most important preoccupations has been the dream. Artemidori is the best known interpreter of dreams in Greek Antiquity and very famous throughout the Middle Ages. In his later work Freud has had a particular consideration for his writings. Flaubert ironically represents Emma Bovaris dream, which is unhappy with her life with Charles, dreams about "honeymoon". We can say that we all, as Emma and other characters dream for a romantic life, a more joyful life for ideal moment that only fulfil dreams. This paper will examine the dream of most famous character of French literature taken from the novel *Madame Bovary* of Flaubert Gystav dream of Emma Bovaris

Hyrje

Prej Antikititetit grek e deri në ditët e sotme, letërsia ka trajtuar tema të ndryshme dhe njëra prej preokupimeve më të rëndësishme ka qenë ëndërra. Artemidori është interpretuesi më i njohur i ëndërrave në Antikititetin grek dhe shumë i famshëm gjatë gjithë periudhës së mesjetës. Më vonë edhe Frojdi ka pasë një konsideratë të veçantë për shkrimet e tij.

Edhe Floberi e paraqet në mënyrë ironike ëndrrën e Ema Bovaris e cila e paknaqur me jetën e saj me Karlin, ëndërron për një "muaj mjalti". Mund të themi se të gjithë ne, sikurse Ema dhe personazhet tjerë ëndërrojmë për një jetë romantike, për një jetë më të hareshme, për një moment ideal që vetëm ëndërra i realizon.

Në këtë punim do të shtjellojmë ëndrrën e personazhit më të njohur të letërsisë frënge të marrë nga romani *Madam Bovari* i Gystav Flober, ëndrrën e Ema Bovaris.

Interesimi për studimin e ëndrrës në kuptimin e plotë të fjalës gjindet në çështjen e domethënjes, e kuptimit të saj: domethënje sa i përket funksionit biologjik dhe psikik. Ëndrrat janë ndrydhja e dëshirave të shfrenuara që secili prej neve i mbyll në vetevete dhe në një mënyrë këto ëndrra *realizohen* në momentin kur funksioni i koshiençë sonë është i ngadalhtë, gjatë gjumit, dhe atëherë mesazhet e shfrenuara kanë tendencën e "zbrazjes". Koshienca jonë është gjithnjë prezente,

edhe pse e ngadalësuar gjatë gjumit, ajo s'pushon së funksionuari dhe formon ëndrrën duke na lënë për detyrë të zgjidhim enigmën.

Fryma romaneske e shekullit të Floberit kishte marr hov shumë të madh dhe kishte domethënjen e vet se ishte shumë më mirë dikund tjetër, dikund në horizont, dikund larg se sa aty ku gjendemi. Kjo dukuri ishte tani më e njohur dhe ndikoj majft në frymën romaneske të Emës qysh në moshën 12 vjeçare. Një vit më vonë ajo u vendos në manastir dhe në moshën 15 vjeçare, Ema pasionohet pas letërsisë e sidomos i adhuron veprat e Walter Scott. Mirëpo shumë shpejt, me kthimin e saj në shtëpi pasi që i kishte vdekur e ëma, jeta e saj ndryshon dhe nga jeta e saj ëndërrimtare kalon në jetën e saj reale.

Jeta për Emën është një ëndërr dhe kjo ëndërr është e domosdoshme për mbijetesën e saj. Por, nga vjen kjo dëshirë që e tërheq Emën për të ëndërruar aventura të mrekullueshme për derisa ajo bën një jetë nga më të zakonshmet? Përshkrimi i ndjenjave të saj është aq i drejtë, saqë një term është shpikur për të përshkruar të keqen që e bren : bovarizmi.

Ëndrra dhe bovarizmi - E keqja e ashtuqajtur bovarizmi

Fjala bovarizëm vjen prej romanit të Gustave Flaubert, *Madame Bovary*, të publikuar në vitin 1856 dhe i pari që e përdor konceptin e bovarizmit është Jules de Gauthier (1911). Me këtë term

përshkruhet gjendja e paknaqshme afektive dhe shoqërore e një personi i cili e shtyn atë të ëndërroj në një lumturi të paarritshme. Fjalori *Le Petit Larousse* (2000) jep këtë definicion: “sjellje e cila ka të bëjë me ikjen, shmangjen në ëndërr të paknaqësisë së përjetuar në jetë”.

Mirëpo kuptimi i termit bovarizëm dyfishohet : është ai i cili e ve në ironi ëndrrën dhe veqanërisht klishet romaneske dhe romantike që gjinden në të: kështu në romanin *Madame Bovary*, autori paraqet në mënyrë ironike ëndërrat e Emës, e cila fatkeqë në jetën bashkëshortore, ëndërron për një muaj mjalti.

Floberi identifikohet me personazhin e Emma Bovaris dhe përshkrimi që autori i bënë është pothuajse një përshkrim i gjendjes në të cilën ai vet gjendet pasi që vuante nga ëndrrat, iluzionet dhe halucinacionet.

Vetëm pas martesës së saj me Charles Bovary e kuptojmë se Ema është e zhgënjyer me jetën e saj reale.

“Dhe Ema dëshironte të dij se ç’do të thotë me të vërtetë në jetë fjala lumturi, pasion dhe dehje, që i’u kishin dukur aq të bukura në libra” (f.36).

Fjalët “aq të bukura në libra” shprehin mënyrën e jetesës së veçantë të Emmës e cila mundohet të përjetoj në jetën aktuale atë që ka përjetuar në libra: “lumturi”, “pasion”, “dehje”. Mirëpo, përjetimi i tyre në realitet është pasojë e gjendjes së saj të dëshpërimit.

Edhe dëshira e Emës ishte të gjindej në disa vende që “duhej ta krijonin lumturinë si ndonjë bimë të veçantë që del në një vend dhe s'bëhet dot askund tjetër”. Ajo mendon se do të ishte e lumtur nëse do të shkonte diku në Skoci apo do të mund të kishte një vilë zviceriane dhe një burrë të veshur me frak dhe çizme lëkure. • Ëndrrat për këto vende të bukura janë prelud i zhgënjimit dhe tragjedisë në fund të romanit. Për Sharlin mendon se ai po të donte do ta kishte kuptuar dhe se Ema do ta zbraste zemrën nga gjithçka ndiente. Ajo mendonte se sa më shumë e lidhte jeta bashkëshortore aq më tepër shkëputej shpirtërisht prej Sharlit. Mendonte se po t'i përkushtohej qeverisjes së shtëpisë, në këtë mënyrë do të dilte disi nga monotonia që i ishte krijuar dhe nuk largohej dot.

Ema martohet me Charl Bovari, burri që nuk ka asgjë të përbashkët me burrat që ajo ëndërron. Ai e mërzi pa masë. Ajo zbulon tek ai, që në ditët e para të martesës, njeriun që jeton në të tashmen, kur ajo ende jeton në të ardhmen, atë i cili jeton në të tashmen, kur ajo ende jeton në imagjinatën. Ai është krejt ashtu siq ajo urren më së shumti në botë: ai është realiteti. E dijmë se Ema ka kaluar kohën e saj të fëmijërisë duke lexuar dhe se ajo është e lumtur vetëm në ëndërr. Madje edhe në

ëndërr, edhe në momentet e lumturisë Ema përjeton mërzin: ajo nuk flen: ajo është në një gjysmë gjumi « elle fait semblant » “ajo shtret sikur” po flen. Ajo e paraqet jetën e vet në skenë: jetën reale me jetën në ëndërr.

Gjendja shpirtërore e Emës është mjaftë mirë e paraqitur në kthetratë e vizioneve të saj edhe pse ndodh që disa herë, sidomos gjatë fillimit të jetës bashkëshortore, të ketë momente të pashlyeshme. Gjatë një feste në një kështjellë të pasur dhe fisnike ajo mahnitet me jetën luksoze që sheh dhe admiron burra të shquar që janë prezent. Ndjehet apo më mirë të themi mendon se ndjehet mirë në këtë atmosferë. Ema ka vallëzuar me viskontin vetëm një herë, në fillim të jetës bashkëshortore, mirëpo imazhi i tij ka mbetur në mendjen e Emës gjatë gjithë jetës. Kontakti i tyre i vetëm ka qenë gjatë vallëzimit në kështjellën e markizit Vaubyessard:

“Filluan me ngadalë, pastaj vallëzuan më me të shpejtë. Nisën të rrotulloheshin: gjithçka vinte vërdallë rreth tyre, llambat, mobiljet, muret e veshura me dru parketi, si ndonjë disk mbi boshtin e vet. Kur kalonin pranë dyerve, cepi i fustanit të Emës fishkëllonte pantallonat e tij; këmbët e tyre plekseshin me njëra-tjetrën; ai ulte sytë drejt saj, ajo i ngrinte të saj të drejt tij; këtë po e kapte një topitje dhe u ndal në vend. Ia nisën përsëri; dhe viskonti, duke lëvizur më shpejt, e tërhoqi dhe fluturuan që të dy deri në fund të galerisë, ku ajo duke gulquar, gati sa s’ra përtokë, dhe, për një çast, mbështeti kokën te gjoksi i tij. Pastaj duke u rrotulluar vazhdimisht, por këtë radhë më ngadalë, ai e çoi në vendin e saj; ajo u mbështet pas murit dhe mbuloi sytë me duar” (54-55).

Për Emën, viskonti ka pamjen e heronjëve të saj, duke marrë parasysh se edhe rrethi i tij është i ngjashëm me atë të ndonjë romani. Sa i përket shikimit, mund të themi se për viskontin është padyshim shikim i zakonshëm mirëpo për Emën ai shikim është një gjest që shpreh dëshirë për joshje. Gjatë kësaj kohe idetë e saj janë të fiksuara, ëndrra e saj merr një formë më konkrete. Mënyra nga më të ndryshme të ëndrrave janë ngulitur në kokën e saj, ëndërronte Parisin, bulevarde, teatro, opera. Për një kohë të caktuar Madam Bovari do të jetë një grua që do të jet pjesë e këtyre vendeve. Kjo botë e bën të ëndërroj. Dhe kjo ëndërr e nxit të shikojë jetën e saj të lënë pas dore, të ulët dhe të trishtuar, shtëpinë e saj dhe ajo më e keqja pamja e të shoqit: “Çfarë njeriu i shëmtuar ! O Zot! Çfarë njeriu i shëmtuar pëshpëriste ajo duke kafshuar buzët e saj.

Dhe ja, tani autori e bën të pranishëm dashnorin. Ky është Leoni, i ri dhe i bukur dhe me paraqitje elegante. Kur Ema e sheh për herë të parë, ai nuk është edhe aq shumë tërheqës. Ai i pëlqen sepse

është një burrë sikurse që është Madam Bovar një grua. Ai ëndërron për Parisin, ka lexuar disa romane dhe ka mendime për muzikën italiane. Për te, Ema shpreh një simpati, por jo edhe dashuri. Ajo ka gjithashtu besim dhe mbështetje tek ai. Në gjendjen shpirtërore në të cilën ishte Madam Bovari, kjo miqësi sentimentale dhe vëllazërore do ti mjaftonin për një kohë të mjaftueshme.

Emës i pëlqen fakti që Leoni është një djalë i ri me shpirt të lirë dhe ëndërrimtar. Mendon se ai ka shpirt të ndjeshëm ndaj artit dhe të bukurës në përgjithësi.

Por ai largohet. Mërzitja e Emës dyfishohet, ditët janë të gjata dhe ëndërrat i sillen vërdall nëpër kokë. Realiteti ndjehet në pakënaqësinë e saj, gjithnjë e më shumë, përmes monotonisë së pamëshirshme, "Sa e trishtuar ishte ajo të dielave, kur këmbanat binin për lutjen e mbrëmjes !"

Pastaj Emma nuk ëndërron më, aq shumë ëndërrat janë bërë monotone sa që tani asaj i duken gjithmonë të njëjta, identike. Ajo është e gatshme për gjërat më tutje. Autori në këtë rast mund të sjellë Leonin, por nuk e bënë këtë. Sigurisht se Madam Bovari është e gatshme të vazhdojë gabimin e saj; sigurisht se nëse Leoni kthehet, ajo do të ishte me të, në një kohë të caktuar, dhe se gabimi do të ndodhte. Por Leoni është i njëjtë sikurse Madam Bovari, me një dallim të vogël se karakteri i tij është më i ulët se sa i saj.

Rodolfi shfaqet atëherë kur Ema ka nevojë për dashuri në kuptimin e argëtimit dhe ka dëshirë për gjëra të papritura në jetën e saj.

Takohet me të për dashuri dhe jo për Rodolfin si njeri, dhe fjalët e saj të para pas takimit me të nuk janë të zakonshme sikurse " e dua"! , por : « Kam një të dashur ! Kam një të dashur ! » (167). Kjo na bën të kuptojmë se Ema nuk ka pasur marrdhënje jashtëmartesore deri në ato momente, pra deri kah mesi i romanit. Pastaj ndjenjat e saj shprehen me këto fjalë : "... duke u argëtuar me mendimin e një puberteti tjetër. Ajo më në fund do të ketë këto gëzime të dashurisë, këto ethe të lumturisë për të cilat ajo i kishte humbur shpresat. Ajo po përjetonte diçka të mrekullueshme ku çdo gjë do të jetë pasion, ekstazë, çmëduri, ëndërr." (f. 167)

Pra, mund të themi se Madam Bovari është e dhënë më shumë pas dashurisë se sa pas Rodolfit, sikurse që do të jetë më vonë e dashuruar më shumë me Leonin se sa me ndjenjat për të dashurinë. Ky ndryshim në të kundërtën e të zakonshmes është një goditje e thellë për moralin e asaj kohe. Madam Bovari nuk është sensuale; ajo mbi të gjitha është romantike.

Dhe e gjithë lidhja e saj me Rodolfin është kryesisht një çështje e imagjinatës. Kjo lidhje e saj na len të

kuptojmë mjaftë mirë se çfarë kërkonte në të vërtetë që një dekadë, ëndërrën e përjetshme të vendeve të largëta, të Spanjës me kitara, të Italisë me valët e detit, të vendeve të Orientit me minare. Dhe të mos gabojmë, Rodolfi nuk është ai që Ema e ka dashur më së shumti; por është ai që më së shumti ia ka plotësuar ëndërrat e saj.

Ndarja e saj me Rodolfin është një krizë tragjike për jetën e saj dhe vdekja më vonë e tregon mënyrën e vullnetshme që ajo vepron.

Madam Bovari takohet prapë me Leonin. Ajo e ka dashur gjithmonë. Edhe pse ky nuk ishte njeri i ndritshëm dhe i fortë, të paktën në sytë e Emës, dhe i aftë për të plotësuar ëndërrën e bukur romantike; ai ishte njeri i butë dhe i dhembshur, pak i dobët, kështu që Ema e sheh se do të dominojë, robëroj atë, dhe do të depërtojë në shpirtin e tij.

Dhe ndjenjat e saj aspak stabile, që duke dashur vetëm Leon, ajo ëndërron një tenor të opera-komik që ajo e sheh një natë duke luajtur në një rol, na tregojnë se ajo e adhuron.

Këtu e shohim këtë progresion fatal me një këndvështrim tjetër. Të jetosh përtej horizontit, ishte krejt çka dëshironte Madam Bovari. Ajo ende jeton në të njëjtën mënyrë; por ngushton horizontin e vet. Dikur Ema ëndërronte për udhëtimet e largëta, peisazhet ekzotike, gondolat dhe xhunglat. Më vonë ajo ëndërronte Parisin dhe shkëlqimet e tij. Tani " përtej horizontit " është qyteti Rouen dhe një dhomë te porti me një nëpunës noterie.

Ëndërrat e Emës mund t'i ndajmë në katër periudha: periudhën e ëndrrave që ndalen dhe fiksohen mbi njeriun që besohet të jetë në gjendje të kuptoj dhe të realizoj këto ëndërra; periudha çmenduri sensuale dhe argëtuese; periudha që përzihet me poezinë e papërshkrueshme dhe që jep ndjenjën se dashuria është ende gjallë në një roman, edhe pse më vulgare; së fundi, periudha e ëndrrave thjeshtë fitimprurëse të cilat janë të ngjashme me atë të tregtisë të Monsieur Lheureux.

Madam Bovari është gati për të hyrë në periudhën e fundit dhe nuk hyn. Ajo ndjen se aty nuk ka ajër dhe se ndjenja e ngulfatjes do ta mbytet dhe nuk do ta len të thith ajrin e librave që përmbajnë gjëra të shkëlqyera.

Emma është protreti më i kompletuari prej të gjitha femrave në letërsi duke marrë parasysh evoluimin e karakterit të saj dhe ndryshimet e njëpasnjëshme që ndodhin gjatë tërë jetës së saj. Skenat e ëndrrave luhen para syve tanë, jeta e saj shpaloset aty: nga jeta ëndërrimtare në jetën reale dhe nga jeta reale në jetën ëndërrimtare.

Bibliografia:

Gustave Flaubert, *Madame Bovary*, édition établie par Claudine Gothot-Mersch, « Classiques Garnier », Bordas, 1990.

Annie Goldmann, *Rêves d'amour perdus*, Denoël / Gonthier, 1984.

Didier Philippot, *Le Bovarysme, la psychologie dans l'œuvre de Flaubert*, annoté et présenté par Didier Philippot, suivi de neuf études réunies et coordonnées par Per Buvik, aux éditions du Sandre, 2007.

Jean-Maurice Gautier, « *Les lectures d'Emma* », *Le lecteur et la lecture dans l'œuvre* - Actes du Colloque International de Clermont-Ferrand, présentés par Alain Montandon, 1982.

LAMPS OF THE ROMAN PERIOD FROM THE ANCIENT CITY OF APOLLONIA IN ALBANIA

KANDILA TË PERIUdhËS ROMAKE NGA QYTETI ANTIK I APOLONISË NË SHQIPËRI

KLODIAN VELO

Qendra e Studimeve Albanologjike,
Tiranë, Shqipëri.
klodianvelo@hotmail.com

Përmbledhje

Kandilat janë objektet kryesore që shërbenin për ndriçim gjatë periudhës së antikitetit. Qëllimi i kërkimit është identifikimi i tipave të ndryshme të kandilave që kanë qarkulluar në Apoloni gjatë periudhës romake. Identifikimi i lidhjeve ekonomike dhe tregtare që qyteti antik i Apolonisë ka pasur gjatë kësaj periudhe me qytetet e tjera. Identifikimi i punishteve lokale që kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në Apoloni dhe në territorin përreth qytetit. Për këtë kërkim u mbledh materiali arkeologjik i dalë nga gërmimet e ndryshme që janë zhvilluar nga vitet 1920 deri në vitin 2014 në Apoloni. Grupi i kandilave gjetur në Apoloni mbulon të gjithë periudhën kohore nga shek. I para Kr., deri në shek. IV pas Kr. Nga ky studim arrijmë në përfundimin se Apollonia edhe në shek. II pas Kr. ruan marrëdhënie të forta ekonomike dhe tregtare me qytetin që e themeloj, Korintin.

Fjalët çelës: Kandila, periudha romake, Apollonia, Shqipëri.

Summary

Lamps are key facilities that served to enlighten during antiquity. The aim of the research is to identify the different types of lamps that have circulated in Apollonia in the Roman period. Identification of economic and commercial ties of Apollonia with other cities during this period. Identification of local workshops that developed their activity in Apollonia and in the territory around the city. For this archaeological research the material is collected out of various excavations conducted from 1920 to 2014. The group of lamps found in Apollonia covers the entire period from 1st century BC – 4th century AD. From this study we conclude that even in the 2nd century AD Apollonia maintain strong economic and trade relations with the mother colony, Corinth.

Key words: Lamps, Roman period, Apollonia, Albania.

Hyrje

Qyteti antik i Apolonisë ndodhet në anën lindore të detit Adriatik. Në pjesën jugperëndimore të Republikës së Shqipërisë, pranë qytetit modern të Fierit. Apollonia u themelua si qytet nga kolonë grek të ardhur nga Korinti dhe Korfu. Si datë e përafërt e themelimit të qytetit merret viti 588 para kr. Apollonia ishte një nga qytetet më të mëdha të tokës Ilire me rreth 60 000 banorë. Në shek I para kr. Ciceroni e cilëson Apoloninë si “Qytet të madh dhe hijerëndë”. Oktavian Augusti, perandori i parë romak ka studiuar oratori në shkollën Apoloniate. Kur bëhet perandor Augusti e shpall Apoloninë qytet të lirë dhe e përjashton nga taksat. Kjo i dha mundësi lulëzimit të tregtisë në këtë qytet. Zhvillimi i madh i këtij qyteti vjen edhe si pasojë e pozitës së tij gjeografike. Apollonia e humb rëndësinë e saj në shek. III-IV pas kr. duke i dhënë fund një qytetërimi 1000 vjeçar. Arsyet e shkatërrimit të këtij qyteti janë të ndryshme dhe lidhen me problemet ekonomike, ndryshimet sociale dhe natyrore që pëson qyteti gjatë kësaj periudhe. Gërmimet e shumta arkeologjike që janë zhvilluar në këtë qytet prej viteve 20 të shekullit të kaluar kanë nxjerr në dritë një material arkeologjik të pasur e të larmishëm. Kandilat prej balte janë një pjesë e rëndësishme e

këtij materiali. Kandilat janë ndër objektet kryesore që shërbenin për ndriçim gjatë periudhës së antikitetit. Ky material arkeologjik i cili gjendet pothuajse në çdo gërmim është shumë pak i studiuar nga arkeologët shqiptarë. Deri tani studimi i këtij materiali qëndron në suazën e prezantimit nëpër kontekste të ndryshme si dhe pak artikuj analizues. Disa artikuj mbi kandilat prej balte janë bërë nga profesorët: S. Anamali (Anamali, 1986), A. Mano (Mano, 2006), G. Hoxha (Hoxha, 2003), B. Vreka (Vreka, 2004). A. Mano ka kryer gërmime të shumta në territorin e Apolonisë për një periudhë të gjatë kohore dhe në zona të ndryshme të qytetit, duke zbuluar një pjesë të mirë të materialit të marr në studim.

Materiali dhe metodat

Për këtë studim u mbledh materiali arkeologjik i dalë nga gërmimet e ndryshme që janë zhvilluar në Apoloni nga vitet 1920 deri në vitin 2014. Gjithsej u grumbulluan 259 kandila që i përkasin periudhës romake. Studimi i kandilave është bërë mbi baza tipologjike sipas mënyrës bashkëkohore. Sipas tipit që i përkasin kandilat janë ndarë për lehtësi studimi në grupe më të mëdha. Për të diferencuar



prodhimet vendase u bë edhe një ndarje tjetër midis materialit të importuar dhe prodhimit lokal. Mbi bazën e metodologjisë krahasuese të gjithë kandilat e importit nga Apolonia u krahasuan me kandilat e dalë nga qendrat kryesore të Mesdheut në periudhën romake. Krahasimi na bënë të mundur identifikimin e qendrave të prodhimit të kandilave të gjetur në Apoloni. Identifikimi i këtyre qendrave na tregon edhe lidhjet tregtare që ka pasur Apolonia me qytetet e tjera të botës antike.

Rezultate dhe diskutime

Më poshtë po paraqes grupet kryesore të kandilave që kanë qarkulluar në territorin e Apolonisë nga shek. I para kr. – fundin e shek. III pas kr.

1. Kandilat e grupit “me dekor radial floreal”

Ky grup përbën rreth 2% (5 objekte) të kandilave të periudhës romake të marr në studim (foto 1). Kandilat janë të punuar me kallëp. Rezervuari me formë bikonike. Vegja vertikale. Disku i ngushtë. Sqepi i gjatë në formën e kudhrës. Mbi sqep formohet një kanal i cekët që nuk komunikon me diskun. Fundi unazor i ngritur, në formë ovale. Si periudhë e qarkullimit merret shek. I para Kr.

Foto 1

Kandilat e Apolonisë paraqesin ngjashmëri me kandila të gjetur në Efesos dhe Pulia (Fiorello, 2012: 91). Efesos njihet si qendër prodhuese dhe eksportuese kandilash gjatë periudhës helenistike dhe romake. Nga ky qytet kanë origjinë disa tipa kandilash. Pulia në këtë rast mund të ketë shërbyer si qendër portuale për mallrat nga Efesos në Apoloni. Kandilat e këtij grupi kanë ndikime të forta nga tradita helenistike e prodhimit. Kjo gjë vërehet në formën e sqepi si dhe dekorimin e tij. Dekorimi në periudhën helenistike bëhej në pjesën e shpatullave të kandilit për shkak të formës së rezervuarit i cili krijonte një hapësirë të gjerë dhe të përshtatshme për aplikimin e dekorit.

2. Kandilat me voluta

Përbëjnë rreth 20% (43 objekte) të kandilave të periudhës romake të marra në studim nga Apolonia (foto 2). Fillimet e këtij grupi kandilash i përkasin periudhës së sundimit të perandorit August. Ky grup paraqet disa karakteristika të reja në prodhim siç janë: shpatulla shumë e ngushtë, disku i gjerë dhe i dekoruar rrethohet nga disa rrathë koncentrik, rezervuari trung konik i përmbysur. Periudha e qarkullimit: fundi i shek. I para Kr., shtrirjen më të gjerë e kanë në gjysmën e dytë të shek I pas Kr. Prodhimi i këtyre kandilave vazhdon edhe për një pjesë të mirë të shek. II pas Kr.

Foto 2

Qendrat kryesore të prodhimit të kandilave me voluta që kanë qarkulluar në Apoloni janë ato të

Italisë Qendrore. Me këtë grup kandilash kemi edhe shkëputjen nga tradita helenistike e prodhimit. Ndryshon forma e kandilit, shpatulla e kandilit zvogëlohet shumë ndërsa hapësira më e madhe i rezervohet diskut. Disku është edhe vendi ku tanimë aplikohet dekorit. Hapësira e madhe e diskut i jep poçarit mundësinë e aplikimit të dekoreve komplekse. Ndër temat kryesore të dekoreve në këtë grup kandilash janë: skenat me gladiatorë, skena me perëndi dhe heronj mitologjik, skena erotike, skena nga jeta e përditshme etj. Kandila të këtij grupi në territorin e Apolonisë përveç materialit të importit kemi edhe prodhime



lokale. Këto kandila janë gjetur si inventar varresh që datojnë në fundin e shek. II pas kr.

3. Kandilat e grupit “me sqep të shkurtër e të rrumbullakët”.

Përbëjnë rreth 40% (114 objekte) të kandilave të periudhës romake gjetur në Apoloni (foto 3). Pjesa më e madhe e gjetjeve vjen nga nekropoli i dystë i periudhës romake dhe teatri i Apolonisë. Ky grup kandilash përbën formën më të përhapur të periudhës perandorake. Të ngjashëm me kandilat me voluta për nga forma e trupit dhe dekorit i diskut. Në aspektin e përgjithshëm kandilat e këtij grupi përfaqësojnë një nga format më të thjeshta dhe karakterizohen nga një sqep i shkurtër e i rrumbullakët. Prodhimi i këtyre kandilave sipas disa autorëve ka filluar rreth vitit 40 pas Kr. në Italinë Qendrore. Përhapjen më të gjerë e arrin në gjysmën e dytë të shek I pas Kr. duke e vazhduar prodhimin por me dekadencë deri në shek. III-IV pas Kr. Shpërndarjen më të madhe ky grup e ka pasur në zonën e Mesdheut. Në territorin e Apolonisë nga ky grup kandilash ndeshim prodhime të qytetit të Korintit dhe të qendrave italice. Prodhimet e Korintit me ato italice kanë forma të njëjta por ndryshojnë në disa element. Kandilat korintik janë të pa lyer me vernik ndërsa ato italice po.

Foto 3

Disku i kandilave Korintik është më konik dhe dekorohet kryesisht me kanelyra që dalin nga qendra në formën e rrezeve të diellit. Kandilat e Korintit kanë kopjuar nga prodhimet italike elementin e vrimës së ajrimit që shërben për ushqyerjen e flakës. Shpatulla është e gjerë dhe e sheshtë e dekoruar kryesisht me gjethe dhe vile rrusi. Shpesh në fundin e kandilave të prodhimit Korintik është shkruar me incizim, me shkronja greke emri i prodhuesit. Këta kandila kanë qarkulluar shumë në qytetet greke të Korintit, Athinës, Spartës, Korfuzit etj. Duhet theksuar se në Apoloni kandilat e prodhimit Korintik janë tipi më i përdorur gjatë shek. II pas Kr. Sipas Aleksandra Mano-s (Mano, 2006: 372) mbi 50 për qind e kandilave të shekullit II-III, pas Kr., që janë gjendur në nekropolin e dystë të Apolonisë, janë prodhime korintike dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre, u përket kandilave të grupit me kanal.

4. Kandila të grupit “firmalampen” ose me kanal

Përbëjnë rreth 20% (41 objekte) të kandilave të periudhës romake të marr në studim (foto 4). Emërtimi “firmalampen” është përdorur për herë të parë në literaturë, në fund të shekullit XIX, nga studiuesi Fischbach (Fischbach, 1896: 11), më vonë ky term u adoptua nga Loeschcke (Loeschcke, 1919: 255) në fillim të shekullit XX dhe pas tij nga shumë autorë të tjerë. Është fjala për kandila të prodhuar me kallëp, me rezervuar në formë trangu konik, të përmbysur. Vegja vertikale unazore është karakteristikë, por nuk është e pranishme gjithmonë, në varësi të prodhuesit. Shpatulla është e pjerrët nga jashtë dhe në të janë vendosur dy ose tre panele në formë piramide. Disku është i sheshtë, gjendet në nivelin e shpatullave, ndërsa në qendër të tij ndodhet vrima e ushqimit. Në shumë raste, disku është dekoruar me maska teatrore apo maska skllavi, buste, kurora gjetesh në relief etj. Një kreshtë e lartë që qarkon diskun, sqepin dhe vrimën e djegies krijon kanalën që i ka dhënë emrin këtij grupi. Kandilat e grupit “firmalampen” kanë filluar të prodhohen diku nga mesi i shekullit I, pas Kr., në Ultësirën Padane (Italia e Veriut). Ky grup kandilash ka qenë në qarkullim deri në shekullin IV, pas Kr (Buchi, 1975: 29-33). Prodhimet e shekullit I-II kanë forma të rregullta të trupit, por duke filluar nga shekulli III, kandilat e këtij grupi pësuan disa modifikime, veçanërisht në formën e trupit, e cila bëhet më pak e rregullt, pothuajse në formë “dardhe” (Gualandi-Genito, 1977: 161). Kandilat kanë një cilësi të lartë, me një



thjeshtësi që lejon prodhim të shpejtë, në sasi të madhe dhe që mund të transportohen lehtë.



Foto 4

Numrin më të madh të gjetjeve të këtij grupi në Apoloni e përbëjnë kandilat me prejardhje nga punishtet lokale, ku mbizotërojnë punishtet e prodhimit nga qyteti i Bylisit, me firmat FELIX BYLLIS, BYLLIS FORTIS, CASSI B, L CASSVS. Ajo që duhet të theksohet është se të gjithë kandilat e prodhimit lokal të grupit “firmalampen” imitojnë prodhimet e Italisë Qendrore edhe pse firmat e imituara janë me origjinë nga Italia Veriore, siç është rasti i firmës FORTIS. Kjo mund të ketë ndodhur për dy arsye: 1) kemi të bëjmë thjesht me plagjiaturë të emrit ose 2) prodhuesit e këtyre kandilave kanë qenë kolonë nga Italia Qendrore, të vendosur në Bylis. Nga burimet e shkruara dihet që qyteti i Bylisit u shndërrua në koloni romake, në vitin ‘30 para Kr. dhe me urdhër të Oktavian Augustit, aty u vendosën qytetarë italikë (Anamali, 1986: 9). Në përfundim mund të thuhet se është përcaktuar hapësira kohore e qarkullimit të kandilave me kanal në Apoloni. Fundi i shekullit I - fillimi i shekullit II, pas Kr. duhet marrë si periudha fillestare e qarkullimit. Si fazë e fundit e qarkullimit është datuar fillimi i shekullit III, pas Kr.

Përfundime

Në përfundim të studimit mund të themi se kandilat e gjetur në Apoloni mbulojnë të gjithë periudhën kohore nga shek. I para kr.- fundi i shek. III pas kr. Qarkullimin më të madh ky material e ka pasur gjatë shek. II-III pas kr. Përqindjen më të madhe të kandilave në qarkullim gjatë periudhës romake e zë materiali i importuar nga qendrat greke të prodhimit e në veçanti Korinti. Kjo gjë nënkupton që edhe gjatë shek. II-III pas kr. Apolonia ruante marrëdhënie të mira tregtare me koloninë mëmë Korintin.

Literaturë

- Anamali S. (1988), *Dy punishte kandilash me firma në Bylis, Iliria 1, Tiranë, 216-219.*
- Buchi E. (1975), *Lucerne del Museo di Aquileia, vol. 1. Lucerne romane con marchio di fabbrica, Aquileia.*
- Fiorello S. (2012), *Ceramica Romana nella Puglia Adriatica, Lucerne fittili nella Puglia centro-settentrionale tra tarda repubblica e Principato, Bari, 83-109.*
- Fischbach O. (1896), *Römische Lampen aus Poetovio, Graz.*
- Gualandi-Genito MC. (1977), *Lucerne fittili delle collezioni del Museo civico archeologico di Bologna, Bologna.*
- Hoxha G. (2003), *Scodra dhe Praevalis në antikitetin e vonë, Shkodër.*
- Loeschcke S. (1919), *Lampen aus Vindonissa, Zurich.*
- Mano A. (2006), *Apolonia e Ilirisë. Tiranë.*
- Vreka B. (2004), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité- IV: Actes du IVe Colloque international de Grenoble, Paris, 269-291.*

KRISTOFORIDHI, LËVRUES I FUSHËS SË PËRKTHIMIT KRISTOFORIDHI, A FOSTERER OF TRANSLATION

MANOLA KAÇI (MYRTA)

Departamenti i gjuhës shqipe
Universiteti "Aleksandër Moisiu",
Durrës, SHQIPËRI
E-mail: manola.myrta@yahoo.com

Përmbledhje

Kostandin Kristoforidhi përbën një nga figurat dhe personalitetet me kontribut të pamatë në gjuhësinë shqiptare. Tek ky gjuhëtar gjejmë të mishëruar fonetikanin, gramatologun, dialektologun, leksikologun, por edhe përkthyesin. Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah vlerat e Kristoforidhit si përkthyes. Përkthimi i "Dhiatës së re" nga greqishtja në shqip prej Kristoforidhit është bërë objekt studimi i gjuhëtarëve të ndryshëm, të cilët kanë spikatur aftësinë e tij në përkthimin e fjalëve nga një gjuhë në tjetrën, por edhe në përshtatjen me kuptimin e përgjithshëm të tekstit. Objekt i punimit janë edhe parimet e përkthimit të ndjekura nga Kristoforidhi. Nëpërmjet metodës së analizës rezultojnë një përputhshmëri e dukshme me parimet e përkthimit të ditëve të sotme, rezultat i cili i shkon për shtat përcaktimit të Kristoforidhit si mjeshtër në fushën e përkthimit.

Fjalët çelës: përkthyes, mjeshtëri gjuhësore, përshtatje, parime, ngjashmëri.

Hyrje

Përkthimi, përbën një aspekt mjaft të rëndësishëm të veprimtarisë së Kristoforidhit. Veprat e përkthyerat prej tij kërkojnë një vëmendje të veçantë, jo vetëm për vlerat që paraqesin në këndështrimin e parashtrimeve shkencore, në përshkrimin dhe interpretimin e të dhënave dhe dukurive, por edhe për vetë faktin se ato shërbejnë edhe si një dëshmi mjaft domethënëse për nxjerrjen në pah të koncepteve teoriko-shkencore të Kristoforidhit. Nismën e tij për të sjellë në shqip "fjalën e shenjtë", gjuhëtarit Tomor Plangarica e shikon "si një tregues mjaft domethënës të vetëdijes së një shkencëtari që po hapte një etapë të re në lëvizimin e gjuhës së shkruar shqipe" (Plangarica 2002: 147).

Veprimtaria e Kristoforidhit lidhur me përkthimin e Shkrimeve të Shenjta, shihet si "dëshmi e mprehtësisë së gjuhëtarit dhe filologut që përzgjedh realitetet më funksionale për të studiuar e kultivuar shqipen e shkruar. Autori përzgjedh Shkrimet e Shenjta, Biblën, që është konsideruar nga studiuesit si vepra që "duke pasur një hapësirë të gjerë përmbajtësore, paraqet kodin e madh letrar të kulturës dhe civilizimit evropian, kod i cili, njëherazi, është dhe i atyre vlerave letrare dhe kulturore të popujve të ndryshëm, të atyre trevave të lëvizjeve të mëdha e të gërshetimeve të kulturave të ndryshme, por, njëkohësisht, edhe të atyre vlerave hyjnore të njeriut që komunikojnë me Zotin, natyrisht edhe me përdorimin e dendur të figurshmërisë letrare të simboleve, të parabolave dhe të figurave të tjera" (Plangarica 2002: 147-148). Ndoshta edhe vetë Kristoforidhin mund ta shqetësonte mungesa e këtij kodi të madh vlerash shpirtërore e kulturore për shqiptarët. Para se të ndërmerre punën për të përkthyer në shqip "Dhiatën e re", ai shprehet: "Shqiptarët kurrë nuk e

kanë dëgjuar fjalën e Zotit të thënë në gjuhën e tyre, ata nuk i njohin fare zbuluesin hyjnor, profecitë e Perëndisë që i përmbajnë Shkrimet e shenjta..." (Lloshi 2005: 226).

Nëse do t'i referohemi historisë në fjalë dhe fakteve gjuhësore të trashëguara, dimë që Kristoforidhi nuk është i pari që bëri përkthimin e "Dhiatës së re" në shqip. Edhe ai vetë e dinte shumë mirë këtë gjë, e dinte se para tij ishte bërë një përkthim nga Vangjel Meksi. Atëherë, si është e mundur që ai shprehet më lart rreth mosnjohjes së fjalës së shenjtë nga shqiptarët? Përgjigjen na e sjell vetë Kristoforidhi kur shprehet se ka një rishikim të "Dhiatës së re" të përkthyer nga V. Meksidhe të botuar në Korfuz më 1827, por "ky është më tepër një parafrazim, sesa një përkthim fjalë për fjalë dhe është shkruar në një dialekt kaq të prishur, të përzier me aq shumë fjalë të greqishtes së re dhe në shumë vende duke lënë jashtë fjali të tëra, sa që vështirë se mund të kuptohet nga vendësit e mirëfilltë të Shqipërisë" (Lloshi 2005: 226). Sidoqoftë, Kristoforidhin nuk e shqetësonte vetëm fakti që ky botim nuk ishte i kuptueshëm. Atë e rëndonte edhe një tjetër realitet të cilin e shpreh nëpërmjet kësaj fjalie: Ky version është shterruar kaq sa unë nuk kam parë asnjë kopje të vetme në ndonjë qytet ose fshat të Shqipërisë (unë kam udhëtuar shumë herë përmes gjithë vendit) dhe asnjë nga shqiptarët nuk e dinte nëse fjala e zotit kishte qenë përkthyer ndonjë herë në gjuhën e tyre apo jo (Lloshi 2005: 226). Ishte, pikërisht, kjo mosdije që u kthye në një shtysë të fuqishme për Kristoforidhin për përkthimin e "Dhiatës së re". Ja si shprehet vetë ai lidhur me këtë fakt: "Përkthimi i Dhiatës së re në gjuhën shqipe, të cilën unë e ndërmora me shtytjen e misionarëve në Stamboll, do të bëhej në një gjuhë

të pastër e të përgjithshme, ashtu siç flitet në Shqipëri ose në pjesën më të madhe të saj, kështu që njerëzit ta kuptonin lehtë fjalën e Zotit kur ta lexonin. Më 1 mars 1875 fillova, në Stamboll, përkthimin nga origjinali në dialektin toskë, i cili është i përdorur më gjerësisht, pasi flitet nga afër 1.000.000 njerëz, të cilët i përkasin kryesisht kishës greke. Më 1858 e kisha përkthyer Dhiatën e re në gjuhën shqipe” (Lloshi 2005: 227).

Fillimisht, Kristoforidhi u mor me përkthimin në toskërisht, por me sa duket kjo gjë nuk e justifikoi tërësisht punën e mundin e tij e, për më tepër, synimin themelor që të gjithë shqiptarët ta kishin në duar e të mund ta lexonin fjalën e shenjtë. Kështu, fill pas mbarimit të këtij varianti, ai nis punën për variantin në gegërisht. Ja si paraqitet ky moment në mendimet e botëkuptimin e Kristoforidhit ndër dokumentat e ardhura tek ne prej studiuesit Xhevat Lloshi: “Kur mbarova rishikimin nisa menjëherë të kopjoja nga dorëshkrimet e përgatitura një Dhiatë të re shqipe në dialektin gegë, që flitet nga një gjysmë milioni njerëz në Veri të Shqipërisë, të cilët i përkasin kryesisht fesë myslimane”. Ky kalim nuk përbënte ndonjë vështirësi të madhe për të, pasi, duke qenë se kishte lindur në pjesën veriore të Shqipërisë, ku flitej dialekti geg, duke qenë se shkollën e kishte ndjekur në pjesën jugore, ku flitet dialekti tosk, duke shtuar edhe faktin që gjithë jetën e kishte kaluar herë në veri e herë në jug të Shqipërisë, këto dy dialekte, shprehet Kristoforidhi “janë bërë krejt familjare për mua” (Lloshi 2005: 227).

Nëse përqendrohemi në mënyrën se si është përkthyer “Dhiata e re”, ajo çka bie në sy është mjeshtëria e Kristoforidhit për të bërë përshtatjen gjuhësore të fjalëve dhe idiomave të ndryshme nga greqishtja në gjuhën shqipe si dhe ndikimin e tyre në kuptimin e përgjithshëm të tekstit (Toska 2002: 310). Në përkthimin e bërë prej tij vihet re, gjithashtu, përdorimi dhe përshtatja me mjaft natyrshmëri në gjuhën shqipe e një sërë kalkesh frazeologjike dhe proverbash (Jashari 2002: 265). Teknika dhe dora mjeshtërore e këtij gjuhëtari e studiuesi bëjnë që kjo vepër, jo vetëm të zërë një vend me vlerë në tërësinë e përkthimeve në shqip, por edhe të spikatet për përçimin të idesë së përgjithshme mjaft natyrshëm tek lexuesi, nisur sidomos nga periudha në të cilën u bënë këto përkthime.

Mbase në këtë pikë mund të vijojmë me këtë pyetje: Çfarë e bënte të vlerë përkthimin e bërë prej Kristoforidhi, krahasuar me përkthimet e bëra nga paraardhësit e tij në këtë fushë? Cilën praktikë pune ndiqte ai gjatë procesit të përkthimit?

Në një prej dokumentave të tij ai shprehet se, pasi kishte përfunduar së përkthyeri “Dhiatën e re” në shqip, pa humbur kohë kishte filluar ta rishikonte

“duke e krahasuar me origjinalin greqisht dhe me botimet e fundit të përkthimeve anglisht, italisht, greqishte e re e turqisht dhe,- vijon Kristoforidhi, kur gjeja ndonjë ndryshim midis këtyre versioneve, kërkoja në komentaret anglisht për këto raste të vështira. Në këtë mënyrë e kam shqyrtuar herë pas here përkthimin tim shqip, duke u përpjekur që ta sillja në përsosurinë më të madhe që kisha mundësi” (Lloshi 2005: 227).

Jo të paktë janë studiuesit dhe gjuhëtarët të cilët, jo vetëm e vlerësojnë së tepërmi punën e Kristoforidhit, por edhe e shohin atë si përkthyesin e pazëvendësueshëm për kohën kur ai punoi. Lidhur me përkthimet e Kristoforidhit, Lumo Skëndo shkruan: “Nderi që të punojë bukurë dhe me fjeshtësi të madhe gjuhënë shqip ish ruajturë te Kostandin Kristoforidhi nga Elbasani. Kur mejtohem se gjer ahere shqipja kish mbetur si një gjuhë e egërë, pa shkronja, pa libra, pa literaturë, kur mejtohem se shqipeja nukë përdoresh përveç se për të kuvënduarë dhe për ca këngë dhe vjersha, dhe për ca letra të rralla, s’munt të mbajmë vethenë së çudituri për durinë dhe diturinë e thellë të Kristoforidhit” (Istori 1909: 3).

Kristoforidhi ishte i mbrujtur me forcën, talentin dhe thellësinë e interpretimit, gjë e cila pasqyrohet në tërësinë e veprës së tij. Nëpërmjet saj ai na paraqet fakte, të dhëna, interpretime, vlera dhe kontribut shkencor. Rëndësinë e kësaj pune të madhe shumëvjeçare e kanë vënë në dukje shumë studiues, por më me interes për çështjen që po trajtojmë është teza e prof. Rexhep Qoses i cili është i mendimit që: “Përkthimi i librave të shenjtë, vetvetiu, e ngre dinjitetin e gjuhës shqipe si gjuhë e letërsisë, e shkencës dhe e kulturës, më në fund si gjuhë e mundësive të mëdha shprehëse, estetike dhe shkencore” (Qosja 2000: 441).

Në këtë kontekst vlerash dhe paraqitjesh shkencore, një vend të rëndësishëm i duhet dhënë *konceptit të Kristoforidhit për përkthimin, parimet dhe veçantitë që duhet të ndiqen gjatë këtij procesi*, përmes të cilit gjuha mund të shfaqë vlera të pakufizuara. Mjeshtëria me të cilën Kristoforidhi ka përcaktuar parimet mbi të cilat ai do të përkthente Shkrimet e Shenjta dhe këndvështrimet e shkencore në përcaktimin e tyre, ka bërë që nga shumë studiues ky punim, të vlerësohet si një traktat që hedh themele të qëndrueshme në teorinë e përkthimit në mendimin shkencor shqiptar (Plangarica 2002: 155).

Cilët janë, në të vërtetë, parimet në të cilat “është mbështetur” Kristoforidhi gjatë procesit të përkthimit?

Në një prej dokumenteve të shkruar në Maltë, më 15 mars 1860, autori paraqet rregullat e përgjithshme që ka patur parasysh gjatë përkthimit të “Dhiatës së re” nga greqishtja (Lloshi 2005: 227-228).

Duke bërë përkthimin nga gjuha origjinale në gjuhën shqipe autori shprehet që ka ndjekur këto rregulla të përgjithshme:

1- Të jap një përkthim fjalë për fjalë vetëm duke e kthyer konstruktin grek në shqip (ashtu siç bëhet në të gjitha versionet për çdo gjuhë të huaj), pra duke zbatuar ato rregulla sintaksore të përshtatjes dhe të renditjes së fjalëve për të formuar fjali të plota, siç i përshtaten gjuhës shqipe.

2- Të jap fjalët, të cilat në original janë lënë jashtë, mbasi kuptohen lehtë nga konteksti, duke përdorur fjalët e shkruara me kursiv ose të futura në kllapa, siç është rasti në versionet e tjera, me qëllim që të plotësohet kuptimi.

3- Të mos përdor asnjë idiomë greke që nuk mund të kuptohet në gjuhën shqipe.

4- Të shpjegoj ato fjalë greke ose hebraishte që në disa versione të tjera janë lënë ashtu siç janë në gjuhën origjinale (duke e futur shpjegimin në kllapa)

5- Të zgjedh ato fjalë, që përdoren përgjithësisht ose kuptohen nga të gjithë në çdo qytet të Shqipërisë.

6- Ato fjalë, të cilat nuk mund të përkthehen fjalë për fjalë në gjuhën shqipe, t'i shpjegoj duke përdorur një ose më shumë fjalë, që japin kuptimin e drejtë.

7- Të shmang gjithë solicizmat ose fjalët e huaja.

Këto janë disa prej kritereve të ndjekura prej tij, gjatë përkthimit të "Dhiatës së re", ndërkohë që më poshtë do të paraqesim tërësinë e kritereve të djekura prej tij gjatë përkthimit të tërë "arsenalit të tij të shenjtë", nëse do të mund t'i përcaktonim kështu, Shkrimet e Shenjta:

- Të përkthehet, duke përshtatur konstruktet e gjuhës prej nga përkthehet, me ato të gjuhës shqipe.

- Të shqipërohet dhe jo vetëm të përkthehet, pra, të jepen edhe fjalët që në origjinal janë lënë jashtë.

- Të përdoren ato idiomat që kuptohen më lehtë dhe më mirë në gjuhën shqipe.

- Të shpjegohen sa më qartë fjalët e huaja, kur është e nevojshme.

- Të përdoren ato fjalë që kuptohen nga të gjithë, në çdo qytet të Shqipërisë.

- Të gjenden togfjalësha përgjegjës, kur nuk gjenden fjalë përgjegjëse të drejtpërdrejta në gjuhën shqip.

- Të shmangen fjalët e huaja.

- Të zgjidhen problemet e ndryshme që lindin gjatë përkthimit, përmes një njohjeje të thelluar teorike të gjuhës amtare (përveç një formimi të plotë intelektual dhe arsimimi sistematik).

- Të zotërohen mirë gjuhët e huaja, si: greqishtja e vjetër, latinishtja, greqishtja e re, italishtja, turqishtja, gjuhë me të cilat shqipja është në kontakt, në mënyrë që të përzgjidhen fjalët dhe

idiomat e gjuhës shqipe, në mënyrë të vetëdijshme, për të shmangur gabimet në përzgjedhje.

- Të përshtatet gjuha e përkthimit me veçoritë dhe karakteristikat e lexuesit dhe dëgjuesit, të cilit i drejtohet mesazhi (në varësi të të cilit Kristoforidhi përktheu toskërisht dhe gegërisht).

Nëse përqendrohemi në njërin prej rregullave të sipërpërmendura (Të përdoren ato fjalë që kuptohen nga të gjithë, në çdo qytet të Shqipërisë) vëmë re që, Kristoforidhi, përveçse kishte si qëllim të sillte në shqip fjalën e shenjtë, dëshira e tij e madhe ishte që të formësonte një punim i cili, mbi të gjitha, të kuptohej nga të gjithë shqiptarët ose, siç shprehet ai vetë, që fjalët të kuptoheshin nga të gjithë në çdo qytet të Shqipërisë.

Në këtë pikë të parashtrimit, mbështetur në tërësinë e parimeve të cilat qëndronin në themel të botëkuptimit të Kristoforidhit si përkthyes, mund të formësojmë pyetjen se në ç'raporte qëndrojnë këto parime të përcaktuara para një dekade, me parimet të cilat qëndrojnë sot në themel të përkthimit të teksteve të ndryshme nga gjuhë të huaja.

Në të vërtetë, nëse do të shfletojmë një manual teorik për teorinë bashkëkohore të përkthimit, do të hasnim këtë tërësi kriteresh shohim të cilat parashtrohen në trajtë pyetjesh:

- A është globalisht e organiksht i saktë kuptimi i tekstit të përkthyer?

- A është idiomatike dhe detyrimisht e saktë në përdorimin e fjalëve gjuha në të cilën

është përkthyer teksti origjinal?

- A respektohet ngjyrimi stilistikor i tekstit origjinal?

- A janë ruajtur veçantitë e qytetërimit që përfaqëson teksti origjinal?

- A janë trajtuar siç duhet aluzionet letrare e folklorike të tekstit origjinal?

- A janë patur parasysht qëllimet e autorit që nuk shfaqen hapur në tekstin origjinal?

- A i përshtatet teksti i përkthyer publikut të cilit i drejtohet? (Plangarica 2002: 156).

Nëse do t'i bënim një krahasim këtyre kritereve që përcakton Kristoforidhi për një përkthim të suksesshëm me ato të cilat janë përvijuar dhe pranuar nga teoritë e sotme të përkthimit, ndonëse i përkasin dekadave të ndryshme, vërejmë që ka një përputhje të dukshme. Këtë përputhje e ka vënë re, së pari, gjuhëtari elbasanas T. Plangarica i cili ngre natyrshëm këtë pyetje: E ç'mund të themi më tej për Kristoforidhin i cili shfaqet kaq i ngjashëm me realitetin e ditëve të sotme në të cilin ai qëndron në mënyrë kaq dinjitoze? Dhe përgjigjen na sjell vetë gjuhëtari, i cili shkurtimisht shprehet: "Faktet në përjasje janë mjaft domethënëse" (Plangarica 2002: 155-156).

Më lart u orvatëm të paraqesim një përmbledhje të shkurtrë rreth përkthimit të bëra nga Kristoforidhi, parimet e ndjekura si dhe vlerat e veprave të përkthyer prej tij. Nga interpretimet e paraqitura nga studiues të ndryshëm ai mund të quhet, me të drejtë, një përkthyes i mirëfilltë dhe mjaft i zoti.

Po, le të mbetemi paksa në të qenit përkthyes. Në manuale të ndryshme të hartuara mbi teknikën e përkthimit na pasqyrohen edhe të ashtuquajturat cilësitë e një përkthyesi të mirëfilltë, cilësi të cilat kërkojnë që mbi të gjitha përkthyesi:

- Të njohë shumë mirë gjuhën amtare në të cilën kërkon të përkthejë.
- Të njohë shumë mirë gjuhën e huaj nga e cila kërkon të përkthejë.
- Të dijë të analizojë e të kuptojë një tekst a ligjëratë të dhënë në të tërë parametrat e tyre.
- Të dijë të bëjë një përkthim jo vetëm gjuhësor, por edhe interpretativ.
- Të ketë një bagazh njohurish që dalin jashtë kuadrin gjuhësor, domethënë, të ketë atë që quhet “kulturë e përgjithshme” e që mbështetet në një kureshtje të gjithanshme dhe në një kujtesë të fortë. Pra, një përkthyes duhet të njohë historinë, kulturën, jetën shoqërore e artistike të atij populli nga gjuha dhe në gjuhën e të cilit do të përkthehet, madje, në është e mundur edhe diçka nga mënyra e jetesës.
- Të zotërojë njohuri mbi përkthimin si teknikë, art e profesion.
- Të ketë pasionin e dhuntinë e të lexuarit, të kuptuarit, të folurit, të shkruarit dhe të të krijuarit si në gjuhën amtare, ashtu edhe në atë të huaj që e zotëron mirë.
- Të ketë një kureshtje të mprehtë intelektuale e të jetë i hapur ndaj botës që e rrethon (Tupja 200: 48-49).

Nëse do të realizojmë sërish një krahasim të këtyre cilësive, me aftësitë dhe cilësitë e përgjithshme të Kristoforidhit të vëna re edhe nga gjuhëtarë të ndryshëm, do të pohojmë që me të vërtetë kemi të bëjmë me një përkthyes i cili mvesh e ndërthur në identitetin e formimin e tij të tëra cilësitë që duhet të ketë një përkthyes i mirëfilltë. Në dorëshkrimet e lëna prej tij, mbështetur gjithashtu edhe në tërësinë e veprimtarisë së tij letrare, si studiues i gjuhës, por edhe si përkthyes, takojmë dukshëm: njohësin mjaft të mirë e të thelluar të gjuhës amtare dhe të dy dialekteve të saj; studiuesin me aftësinë për të interpretuar ngjyrimet gjuhësore dhe karakteristikat e veçanta të dialekteve apo të folmeve të ndryshme; njohësin mjaft të mirë të disa gjuhëve të huaja, përkthyesin i cili kërkonte të sillte në gjuhën shqipe jo vetëm një tekst të përkthyer nga një gjuhë e huaj, por, mbi të gjitha, një tekst i cili të ishte qartësisht i kuptueshëm për të gjithë, etj.

Pra, nëse na duhet të flasim për Kristoforidhin si përkthyes, tashmë e kemi më se të qartë faktin që ai nuk ishte thjesht një përkthyes, ai ishte një përkthyes në kuptimin e plotë të fjalës. Arsyeja e suksesit të Kristoforidhit, natyrisht, duhet ta kërkojmë në “përgatitjen e plotë teorike filologjike të Kristoforidhit, në talentin e tij të lindur si dhe në njohjen e thelluar të procesit të përkthimit” (Plangarica 2002: 155).

Si përfundim, mund të themi që meritat për krijimin e këtij konteksti gjuhësor të gjerë e të pasur i qëndrojnë në mënyrë të padiskutueshme, vetë Kostandin Kristoforidhit, pasi: “Gurët që vuri ai në përkthimin e librave të shenjtë nuk janë mbijetoja, por gjedhe konkrete për të të gjithë ata që merren me punët e shqipes” (Jashari 2002: 265).

Pra, nëse i hedhim një sy historisë së përgjithshme të tërësisë së përkthimeve të bëra në gjuhën shqipe që nga fillimet e saj, një vend të rëndësishëm në këtë rrugëtim zë, natyrisht, edhe gjuhëtari, studiuesi i gjuhës dhe përkthyesi Kostandin Kristoforidhi.

Përfundime

Në tërësinë e veprimtarisë së Kristoforidhit bien në sy dukshëm jo vetëm aspekte studimore me interes, por edhe risi të sjella nga autori në mendimin e përgjithshëm gjuhësor shqiptar. Përveçse është shquar si studiues i gjuhës, Kristoforidhi spikat edhe si përkthyes. Nga vlerësimet e bëra prej gjuhëtarëve shqiptarë dhe të huaj, Kristoforidhi përcaktohet si: “përkthyesi i shkëlqyer, i motivuar dhe me idetë fundamentale dhe unigjillore”, “një përkthyes i talentuar, shkrimtar i shquar, tregimtar, mësues i palodhur, shkencëtar i periudhës së Rilindjes Kombëtare”, etj. Veprat e tij të përkthyer dallohen jo vetëm për stilin e përdorur, por edhe për veçori të veçanta gjuhësore. Duke marrë në konsideratë gjendjen e sotme të përkthimit biblik, përkthimi i Kristoforidhit është tejet i arrirë dhe mjeshtëror deri në detaje. Ky përkthim është dëshmi e një njohjeje më se të plotë të gjuhës shqipe, i një aftësie gjuhësore të admirueshme në përzgjedhjen e elementeve gjuhësore, si dhe në aftësinë për të përkthyer e përshtatur më së miri në gjuhën shqipe tërësinë e leksikut të besimit kristian.

Nga një krahasim i parimeve të përkthimit të ndjekura nga Kristoforidhi në periudhën kur ai i realizoi përkthimet e tij, me parimet që ndiqen nga përkthyesit në ditët e sotme, është vënë re një ngjashmëri e dukshme. Kjo përputhshmëri vërteton edhe një herë faktin që tek Kristoforidhi janë të mishëruara natyrshëm qoftë talenti për të hulumtuar e për ta studiuar gjuhën shqipe, ashtu edhe talenti për të sjellë edhe në gjuhën shqipe, në mënyrën sa më të mirë e sa më origjinale të mundshme, tekste të shkruara në gjuhë të tjera.

Bibliografia

Ali Jashari, *Përdorimi i kalkeve frazeologjike dhe i shprehjeve të tjera në përkthimet e Kristoforidhit*, në "Përmbledhje me studime për Kristoforidhin", Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra kërkimore-shkencore, sektori i Albanologjisë - Ballkanologjisë, Elbasan, 2002.

Edmond Tupja, "Këshilla një përkthyesi të ri", Onufri, 2000.

Istori e shkrimit shqip, në Diturija, v. I, 1909.

Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 2000.

Teuta Toska, *Mbi përzgjedhjen e elementëve gjuhësorë në përkthimin e Kristoforidhit te Dhita e Re*, në "Përmbledhje me studime për Kristoforidhin", Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra kërkimore-shkencore, sektori i Albanologjisë-Ballkanologjisë, Elbasan, 2002.

Tomor Plangarica, *Vepra e K.Kristoforidhit - hapësirë që mundëson mendim mendim shkencor*, në "Përmbledhje me studime për Kristoforidhin", Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Qendra kërkimore-shkencore, sektori i Albanologjisë-Ballkanologjisë, Elbasan, 2002.

Xhevat Lloshi, "Kristoforidhi përmes dokumentimit", Tiranë, 2005.

**KRITERET DHE NIVELET E PËRBASHKËTA TË KUADRIT TË REFERENCËS PËR GJUHËT
SIPAS BE- SË
COMMON CRITERIA LEVELS FRAMEWORK OF REFERENCE FOR LANGUAGES
ACCORDING TO EU**

LENDITA GJIKOLLI

Universiteti "Hasan Prishtina",
Fakulteti i Filologjisë,
Prishtinë, Kosovë
Email: lenagjikolli@gmail.com

Përmbledhje

Të mësuarit e një gjuhe padyshim se është një sfidë që kërkon përkushtim dhe një sistemim procedural të të dhënave duke u bazuar në referencat e BE –së. Ne do të mundohemi ta paraqesim në këtë punim tendencën për të gjetur mënyrën më të lehtë dhe më efektive për të thjeshtuar, harmonizuar, nivelizuar njohuritë gjuhësore . Do të theksojmë gjithashtu edhe rëndësinë e të mësuarit të ndërsjellë të gjuhëve në kontekstin ndërkulturor si mjet diverziteti, por edhe ndërveprimi që ka për qëllim edhe pranimin dhe respektimin e llojllojshmërisë gjuhësore dhe kulturore në të gjitha vendet e Evropës. Gjithnjë duke theksuar karakteristikat e përgjithshme, strategjitë dhe objektivat e KE në fushën e politikave gjuhësore e si dhe risitë në fushën e mësimdhënies së gjuhëve të huaja dhe veçanërisht prurjet e Kuadrit evropian të përbashkët të referencës për gjuhët.

Fjalët çelës: Kuadër, referencë, diverzitet, strategji, kontekst

Abstract

Learning a foreign language certainly is a greater challenge that requires dedication and a procedural adjustment data, based on the EU references. We will try to present in this paper work a tendency to find the easiest and most efficient way to simplify, harmonize and leveling out the language skills. We would like also, to stress the importance of mutual learning of languages in the context of intercultural the diversity tool, as well as the interaction, which aim the recognition and respect of linguistic and cultural diversity in all, European countries. Always, stressing the general characteristics, EC strategies and objectives in the field of language policies, and the innovations in the field of teaching foreign languages and especially the flow of the common European Framework of Reference for Languages.

Key Words: Framework, reference, diversity, strategy, context

Hyrje

Duke u nisur nga ajo që komunikimi gjegjësisht të folurit apo më mirë të themi gjuha është një ndër elementet bazë të shprehjes së kulturës, traditës dhe identitetit të një populli, është ndër nevojat e një riformatizimi, një rimodelimi ,një ndryshimi të mënyrës së të mësuarit duke u mbështetur në Kornizën e Përbashkët Evropiane për gjuhët. E cila është fryt i një reflektimi dhe një pune shumë të gjatë të ekspertëve eminent, lingvistëve të shumtë në mënyrë që të gjindet një formë e përbashkët, të ketë një transparencë në llojllojshmërinë e sistemeve arsimore, edukative, në diverzitetin e sistemeve të vlerësimit e certifikimit në shtetet e ndryshme të Evropës.

Qëllimi ishte të krijohet një identitet i përbashkët Evropian i mësimdhënies, mësimdhënies, vlerësimit të kompetencës gjuhësore i krijuar mbi vlerat e përbashkëta Evropiane. KPEGJ-ja paraqet një bazë të përbashkët për elaborimin e programeve të gjuhëve, provimeve, të referimeve, manualve në Evropë.

Në të njëjtën kohë "Korniza e Përbashkët Evropiane për gjuhët definon mjetet administrative, konceptet e programeve, formimin e mësimdhënësve, komisioneve të provimeve, trajnuesve ose moderatorëve etj".

Kështu që çështjet lingustike si plurilinguizmi, kompetencat lingustike, çasjet e të mësuarit e gjuhëve të huaja, marrëdhëniet në klasë, mënyrat e të vlerësuarit ishin tejet të diskutueshme edhe pse me një vizion pozitiv dhe përshkrues të kompetencave, që ndërlidheshin me evaluimin dhe njohjen e gjuhëve të huaja paraprakisht nuk kishte harmonizim të sistemeve arsimore ndaj njohja dhe vlerat nuk ishin ekuivalente në KE. Prandaj, edhe lindi ideja që të krijoheshin kriteret e përbashkëta në mënyrë që edhe diplomat të ishin të barazvlefshme dhe të mbështeteshin në politikat dhe strategjitë e KE-së.

Më 8 Prill 1994 Austria, Franca, Holanda, Lihtenshtejni, Zvicra, Greqia, Malta dhe Sllovenia themeluan Qendrën Evropiane për Gjuhët Moderne. Krijuan në të vërtetë një "Marrëveshje të pjesëshme të zgjeruar" të Këshillit të Evropës që kishte për qëllim bashkëpunimin, që mundëson ushtrimin e disa aktiviteteve, të cilat nuk kishin mbështetjen e të gjitha shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Rrjedhimisht, vetëm disa nga shtetet anëtare të interesuara merrnin pjesë në Marrëveshje për t'i përballuar shpenzimet e saja».

Sot QEGJM-ja numëron 33 shtete anëtare. Marrëveshja e pjesëshme për ECML është "e zgjeruar", që

do të thotë se shtete jo anëtare të Këshillit të Europës gjithashtu kanë mundësi t'i bashkangjiten Qendrës.

Më 8 Prill 1994 gjithashtu u vendos që në bazë të Rezolutës (94)10, QEGJM të funksiononte përkohësisht, për një periudhë prove deri në dhjetor të vitit 1997. Rezoluta parashihte, që QEGJM -ja do të vlerësohej nga një grup i jashtëm evaluimi. Gjatë kësaj periudhe pasi që vlerësimi dhe rekomandimet ishin pozitive, në korrik të vitit 1998 Komiteti i Ministrave me anë të Rezolutës (98) 11 vendosi ta kthente Qendrën në një Institucion permanent. Rezoluta qartëson synimet dhe objektivat e Qendrës, përcakton strukturat, konturon përbërjen dhe detyrat e çdo organi. QEGJM-ja hyn në kompetencat e Drejtorisë së IV të Përgjithshme të Këshillit të Evropës – Edukimi, Kultura Trashëgimia, Rinia dhe Sporti.

Politikat gjuhësore të Këshillit të Evropës sipas standardeve të vendosura me konsensus bazohen në dokumentet bazë të Këshillit të Evropës si Kuadri i përbashkët evropian i referencës dhe Portofoli evropian për gjuhët.

Politikat gjuhësore të Këshillit të Evropës promovojnë mësimin e gjuhëve të huaja me programe dhe kualifikimeve të standardizuara të cilat mundësojnë shkëmbimet e kurrikulave dhe përvojave profesionale në Evropë.

Në bazë të nenit 22 parashikohet që Bashkimi Evropian të respekton diversitetin gjuhësor, ndërsa në nenin 21 ndalohet çdo diskriminim për sa u përket gjuhëve. Ajo promovon si në vijim:

Respektimin e diversitetit gjuhësor. Promovimin e plurilinguizmit dhe plurikulturizmit;

Bënë luftë kundër intolerancës dhe ksenofobisë nëpërmjet përmirësimit të komunikimit dhe të kuptueshmërisë reciproke të individëve;

Mbron dhe zhvillon trashigiminë gjuhësore dhe diversitetin kulturor të Evropës.

Lehtëson lëvizjen personale dhe shkëmbimin e ideve.

Promovon një plurilinguizmi të një shkalle sa më të gjërë.

Duke u mbështetur në politikat Evropiane mbi gjuhët edhe Kosova fillon dhe vazhdon me implementimin e tyre mbështetur në Deklaratën e OKB-së, që përmban dispozita më të hollësishme, të cilat thuhet se: Shtetet duhet të mbrojnë identitetin kulturor dhe gjuhësor të komuniteteve brenda kufijve të tyre të njohur dhe të miratojnë masat e nevojshme për të arritur këto rezultate.

Sipas Evelyne Rosen " Ky program nuk ka mbetur një letër e vdekur por Këshilli i Evropës ka marrë me përgjegjësi gjetjen e përgjegjësve për analizimin e sistemeve edukative të vendeve të ndryshme evropiane për krijimin e një Kornize të tillë që bënë përshkrimin e mësimdhënies, mësimnxënies së

gjuhëve në të gjitha nivelet". Në të vërtetë që nga fillimi ideja ishte që ky mendim, reflektim me interesa të përbashkëta të lansohej në mënyrë apo rrugë institucionale me ç'rast do të zbatoheshin politikat gjuhësore të KE –së.

KPEGJ-ja u formua në Zvicër në Rüşchlikon në një simpozium ndërqeveritar me temën: "Transparenca dhe koherenca në mësimin e gjuhëve në Evropë" që për synim kishte certifikimin, nivelizimin e njohurive vlerësimin mësimin e gjuhëve të huaja duke respektuar dallimet kulturore etj.

KEPGJ- ja dhe PEGJ- ja në Kosovë

Në Evrope kjo formë e vlerësimit ka filluar që nga vitet e nëntëdhjeta për fat të keq në Kosovë fillon me shumë vonesë për shkak të okupimit dhjetë vjeçar dhe luftës së fundit. Duhet cekur se pas luftës së vitit 1999 në vendin tonë instalohen një numër i konsiderueshëm i organizatave të ndryshme civile, humanitare si dhe ato të forcave paqëruajtse gjë që ndikoi në rritjen e nevojës dhe interesimit tek njerëzit për të njohur, zgjeruar dhe certifikuar njohuritë e tyre në një ose më shumë gjuhë të huaja.

Duke u mbështetur në politikat Evropiane mbi gjuhët edhe Kosova bënë përpjekjet e saj dhe ende vazhdon me implementimin e tyre mbështetur në Deklaratën e OKB-së që përmban dispozita më të hollësishme, në të cilat thuhet se shtetet duhet të mbrojnë identitetin kulturor dhe gjuhësor të komuniteteve brenda kufijve të tyre të njohur dhe të miratojnë masat e nevojshme "për të arritur këto rezultate".

Rindërtimi i marrdhënieve, rivendosja e Zyrës Ndërlidhëse të Francës në Prishtinë dhe themelimi i Qendrës Kulturore Françeze në vitin 2001, kishte një rëndësi të veçantë për sesibilizimin e studentëve, si dhe të gjithë frankofonëve për rëndësinë e diplomave DELF dhe DALF si dhe për përgatitjen, e mësimdhënësve vendës në Francë të cilët më pas do t'i transmetonin njohurit dhe përvojat e tyre me mësimdhënës të tjerë nga gjithë bota tek studentet. Stimuloheshin njëkohësisht, edhe studentët, u mundësoheshin apo ipeshin bursat për të avansuar gjuhën frënge gjë që vazhdon edhe në ditët e sotme.

U licensua edhe kuadri për trajnimin e kuadrove kryesisht, mësimdhënës të shkollave fillore sipas Standardeve të përcaktuara në bazë të Kornizës dhe Qendrës Kombëtare të Studimeve Pedagogjike të Francës CIEP- "Centre international d'études pédagogiques"- për të qenë pjesë e jurive gjatë provimeve.

Në vitin 2010 organizohet një trajnim me temën" Trajnimi i korrigjuesve të DELF-it dhe DALF- it "Formation de correcteur du DELF et DALF". Parashihen edhe shumë aktivitete si trajnimi licencimi i mësimdhënësve etj.

Një ndër çështjet themelore pa dyshim mbetet çështja e vlerësimit përmes këtyre 6 niveleve:

A1-A2, B1 -B2, C1- C2 të cilat paraqesin përparimin e nxënësit në çdo etapë të të mësuarit dhe çdo çast e moment të jetës." Le diplôme d'études de langue française" dhe "Diplôme approfondi de langue française "mundësojnë pavarësinë e kandidatit të regjistrohet sipas zgjedhjes së tij në provim ose ta vërtetoj njohurinë ose përceptimin e tij nga komisioni gjegjës me ç'rast do të përcaktohej niveli që ai ka.

Në secilin nivel janë 4 kompetenca:Të kuptuarit dhe të reprodukuarit me gojë dhe të kuptuarit dhe të reprodukuarit me shkrim. Ndërkaq sa i përket kompetencave të përgjithshme ato ndahen në tri pjesë nga themeluesit e CECR-së: Në kompetencë linguistike, përbërjen socio linguistike (gram, fonologji, orthografi dhe leksik) dhe atë pragmatike (të ligjeratës, funksionet etj dhe në konceptin semantik.

Pra, aktiviteti gjuhësor pothuajse mbështetet tërësisht dhe operon në vazhdimësi të aktiviteteve gjuhësore. Sa i përket kompetencës gramatikore asaj pothuajse nuk i kushtohet vëmendje e veçant duke u nisur nga ajo që gramatika duhet të reduktohet, të memorohet dhe gjuha të mësohet nga konteksti d.m.th gjuha familjare, sociale komerciale ose profesionale. Qëllimi është që të mësohen mënyrat e komunikimit, kodet për të gjitha rastet dhe në nivel të aktiviteteve të ndryshme, në të vërtetë tentohet që të arrihet maksimumi përmes temave alternative ndonjëherë të propozuara edhe nga vet nxënësit.

Inicohet " Evaluimi joverbal që është qenësor duke vlerësuar evaluimin e të reprodukuarit Që nga pas lufta është filluar me pilot projekte që janë realizuar në formë periodike ose në faza të ndryshme për të qenë pjesë e standardizuar në çdo aspekt me vendet tjera Evropiane.

Në fund mund të konkludojmë se : Ideja evropiane është ngritur mbi dy kërkesa të pandashme në ate të universalitetit të vlerave morale të përbashkëta dhe diversitetit kulturor.

Duhet theksuar se përshkak të mosdefinimit, ndarjes dhe përshkrimit të saktë të niveleve janë bërë polimika të shumta rreth përcaktimit të niveleve dhe se ende është tejte e domosdoshme të elaborohen nivelet e Kornizës së Përbashkët

Evropiane për Gjuhët me qëllim që të promovohen dhe të lehtësohet bashkëpunimi, respektimi i dallimeve kulturore sidomos në vendet në tranzicion e që ende nuk janë pranuar në BE siç është rasti ynë Kosova, ku nuk ka lëvizje të lirë gjë që edhe më shumë ngadalson aftësimin, standardizimin dhe realizimin e objektivave të BE-së. Gjithashtu vihet në përfundim se:

Mësimnxënia e gjuhëve duhet të prekë qëllimet e lartpërmendura për një kohë të gjatë dhe të promovojë të lehtësoj sistemin mes institucioneve të shteteve të ndryshme përderisa të krijohen kadro të trajnuar sipas politikave gjuhësore të KE-së.Të mbështetën dhe promovohen njohurit reciproke të gjuhës. Duhet të vazhdohet të intensifikohet, mësimdhënia dhe mësimnxënia e gjuhëve në shtetet anëtare për një mobilizim më të madhë, një komunikim ndërkombëtar më efikas që respekton identitetin dhe dallimet kulturore me një theks të veçantë informimin, bashkëbisedimin, përmirësimin e relacioneve të punës si dhe kuptueshmëri reciproke .

Mësimdhënia të bëhet sipas standardeve evropiane duke filluar nga kopshti i fëmijëve e deri te të rriturit.Përkundër nevojës së madhe dhe përpjekjeve për t'i realizuar këto qëllime në Kosovë ende nuk është arritur implementimi i standardeve Evropiane por, mendohet se në sistemin parauniversitar në vitin 2016 të reformohet sistemi arsimor në tërësi.

Megjithate, mund të thuhet se ka pasur ndryshime periodike me anë të pilot projekteve, trajnimeve të mësimdhënsve etj... por është shkuar një formë graduale edhe pse sistemi arsimor në Kosovë para luftës kishte ngecur për dhjetë vite.

Duhet pasur parasysh edhe ate se për të realizuar objektivat dhe politikat gjuhësore të BE-së duhen të krijohen kushtet materiale, objekte të reja shkollore (dihet fare mirë se në shkollat e Kosovës ende mësimi mbahet në dy ose tri ndërime), të sigurohen gjithashtu edhe laboratorë të gjuhëve, laboratorë profesional për lëndë të ndryshme si fizikë, biologji, kimi, aftësim profesional nëpër shkolla të mesme profesionale etj.) salla të përtshatshme mësimi, salla të edukatës fizike etj, të sigurohen mjete të ndryshme didaktike si kompjuter, portabël, projektor si dhe mjete tjera ndihmëse.

Bibliografia

Division des politiques linguistiques Strasbourg, "Cadre européen commun de référence pour les langues" (2005), Didier, Paris.

Division des politiques linguistiques Strasbourg, "Cadre européen commun de référence pour les langues", (2005), Didier, Paris.

HALOÇI Andromaqi (2013), "Politikat gjuhësore të këshillit të Evropës një sfidë dhe përgjegjësi për sistemin arsimor në Shqipëri", Aktet e Takimit Vjetor, Vëll. II, Nr. fq.49.

HALOÇI Andromaqi (2013), "Politikat gjuhësore të këshillit të Evropës një sfidë dhe përgjegjësi për sistemin arsimor në Shqipëri", Aktet e Takimit Vjetor, Vëll. II, Nr. fq.49.

HALOÇI Andromaqi,(2013), "Politikat gjuhësore të këshillit të Evropës një sfidë dhe përgjegjësi për sistemin arsimor në Shqipëri", Aktet e Takimit Vjetor, Vëll. II, Nr. fq.50.

<http://www.coe.al/index.php?faqe=content/detail&id=173&mnu=184>

LLAPASHTICA, Feime (2015), zyrtare për plan-programe, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Prishtinë.

Politikat e gjuhëve në Kosovë, Studim politikash II , (2011) , Ministria për Minoritete ,Prishtinë, Shtator.

ROSEN Evelyne, (2007), "Cadre européen commun de référence pour les langues " CLE international, Paris.

ROSEN Evelyne, (2007), "Cadre européen commun de référence pour les langues " CLE international Paris.

KULTI I SHPELLËS E DISA KULTE TË TJERA ME MBISHTRESËZIME FETARE THE CAVE CULT AND SOME OTHER CULTS WITH RELIGIOUS OVERSTRATIFICATIONS

IRENA GJONI
Universiteti i Tiranës,
Filiali në Sarandë
Sarandë, Shqipëri
E-mail: gjoniirena@yahoo.com

Përmbledhje

Botëkuptimin e vetë për hapësirën, njeriu arkaik e ka ndërtuar mbi distinkcionin e hapësirës së njohur e të banuar dhe hapësirës së panjohur e të pabanuar që e ka rrethuar. Shpellat futen te të dytat. Në këtë studim nënvizohet se nëpër këto topose kanë jetuar e kanë pasur vendqëndrimin e tyre përfaqësues të ndryshëm e të llojllojshëm të së mirës e të keqes. Që këtu ka qenë edhe nevoja e krijimit të kultit për to. Lënda e shtruar rrihet në kontekst të ruajtjes së mbijetojave të kulteve të blatimit, gjithnjë duke e krahasuar me mitologjinë antike greke dhe areale të tjera mitike mesdhetare e botërore. Paraqitja e shpellave në shpjegimet mitologjike veçon dhe përpunon disa nga anët e faltores. Në secilën periudhë historike ka pasur të papriturat e tyre, të cilat kanë krijuar kushte të volitshme për lindjen e zhvillimin e fantazisë, të përcjellë përmes besimesh e legjendash të ndryshme dhe për dhënien e tipareve ktonike ose hyjnizuese. Shpjegimet që u jepen shpellave janë pjesë përbërëse e dëshirës së njeriut të hershëm t'i shpjegojë fenomenet e natyrës në mënyrë naive, atëherë kur kanë munguar shpjegimet dhe interpretimet shkencore. Përveç kësaj, dëshmohet se shpellat shpesh kanë luajtur role të rëndësishme praktike për jetën e njeriut. Shpellat paraqiten si vendlindje dhe vendqëndrim i hyjnive e shenjtoreve (Hadi, Zeusi, Dionisi, pse jo edhe Krishti) vendblatim i shenjtoreve (Shpella e Spilesë, Shpellat e Panit nëpër Greqi; Shpella Halile – vendnderim i hyut të udhës), vendmitizim i personazheve të eposit heroik (aty fitojnë fuqinë e jashtëzakonshme Muji e Halili), vende të martesës së personazheve mitike (Jansoni me Medenë, Eneu me Didonën); vendstrehim i luftëtarëve dhe vendngritje e sundimit (Shpella e Gramës, Shpella Halile, Shpella e Haxhi Aliut), vendqëndrim i iniciantit për ta fituar statusin e ri shoqëror, por në to mbyllen përkohësisht edhe personazhet e eposit heroik pasi kanë përfunduar misionin e tyre (për t'u shfaqur më vonë kur të ndihet nevoja), vendjetesë e përbindshave (Lubia, Kuçedra në Palermo). Si përfundim, shpellat shihen si vendbanim mitologjik e topose blatimi.

Fjalët çelës: shpellat, vendbanim, mitologjik, topos, blatim, krahasim, Bregdet.

Summary

The outlook for the space, the archaic man has built it on the distinction of known space and the inhabited and uninhabited unknown surrounded space. Caves are introduced to the second. In this study is noted that in these topos they had lived in their current residence of various representatives of diverse of good and evil. Since there has been the need of creating cult for them. Beaten paved content in the context of preserving the offering cults survive, always comparing ancient Greek mythology and other mythical realm Mediterranean world. Presentation of caves in mythological explanations separates and processes some of the sides of the shrine. In each historical period had their contingencies, which have created favorable conditions for the emergence and development of fantasy, followed by the legends of different faiths and providing ktonike or divinizing features. Explanations given to the caves are an integral part of early human desire to explain the phenomena of nature naively, when there were no scientific explanations and interpretations. In addition, it is proven that the caves have often played important roles in practical for human life. The caves are presented as the birthplace and residence of the deities of the saints (Hadi, Zeus, Dionysus, why not Christ) place for the saints (SPILE Cave, Cave of Pan in Greece; Halil Cave – honorplace for the deity of way), mythicplace for the characters of heroic epos (there Muji gain extraordinary power of Halili), marriage places for mythical characters (Jansson with MEDENA , Eneu with Didona); hidingplace for fighters shelter and rule (Cave of Grama , Halil Cave , Cave of Haji Ali), site of iniciantit to win new social status, but also to temporarily shut heroic epos characters after completing their mission (to be shown later when a need), livingplace of monsters(Lubin, dragon Palermo). In conclusion, the caves are seen as the mythological abode of offering TOPOS.

Keywords : caves, township, mythological, TOPOS, offering, comparison, Coast .

SHPELLAT

Megjithëse prezenca e shpellave është më pak dominuese në natyrën e Bregdetit të Jonit se ajo e maleve apo ujërave, ato (shpellat) janë një anë tjetër e gjeologjisë së kësaj zone. Mendohet se kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lashtësi. Karakteristikë e tyre ishte fakti që ato gjendeshin afër bregut të detit, por njëkohësisht ato dëshmojnë edhe lashtësinë e miteve, jo vetëm të kësaj

krahine, por edhe në traditën e përgjithshme shqiptare.

Shpellat janë vende ndenjeje, por ruajnë njëkohësisht edhe karakterin e egër të tyre – vendstrehime për ata që kishin nevojë, larg nga vendbanimet njerëzore.

Ashtu si dhe malet, shpellat krahasohen në mite me një periudhë të së kaluarës së largët. Paraqitja e

shpellave në shpjegimet mitologjike veçon dhe përpunon disa nga anët e faltores.

Shpella paraqet parimin femëror, sepse i ka tiparet e barkut të Nënës Tokë. Si pjesë përbërëse e malit, shpella ka të ngjashme shumë nga simbolikat, por tek ajo dominojnë parimet e mbyllura të femërores, përballë malit që i përket të jashtmes, të dukshmes. Shpellat ishin të futura brenda në një perëndi, d.m.th. Gjean. Për këtë fakt, hyrja në një shpellë do të thoshte se dikush vinte në takim të afërt me shenjtin. Një destinacion në të cilin ofroi shteg një shpellë, ishte vetë mbretëria e Hadit.

Lindja dhe ditët e para të disa prej perëndive u bënë në shpella. Zeusin, që foshnjë e mbajtën në një shpellë, megjithëse kishin mëdyshje se në cilën prej tyre. Nuk është shumë çudi që shumë vende si në Kretë dhe në Arkadi kërkonin këtë nder. Dionisin, gjithashtu e mbajtën në një shpellë. Një çast i bukur, i vizatuar paraqet Ermin të dorëzoi fëmijën e sapolindur të saj tek nimfat për ta rritur (Larson 2001: 54).

Në shpellë, si simbol i botës nëntokësore dhe e varrit, më shpesh janë bërë ritet e iniciacionit. Hyrja në shpellë është hyrje e dytë në barkun e Nënës Tokë. Kalimi nëpër të paraqet ndryshimin e pozitës shoqërore (Lampic 1999: 107-108). Besohet se kur lindin fëmijët, vijnë nga shpellat ose nga humnera të ngjashme.

Eliade përmend një besim që ka të bëjë me shtatzaninë. Sipas tij, gratë mbeten shtatzanë kur i afrohen vendeve të ndryshme: shkallëve, shpellave, drunjve, lumenjve (Eliade 1992: 185). Kjo më tej interpretohet sipas besimit në pavdekshmërinë e shpirtit, sikur në vende të këtilla kanë bërë roje shpirtërat e të parëve dhe për fekondim ata kanë pritur nëpër këto vende sekrete të Tokës – Mëmë.

Pra edhe shpella, si personifikim i lindjes së jetës, shpesh është ndërlidhur me blatimin. Nëpër shpella janë bërë edhe martesat mitike, siç është martesat midis Jasonit e Medesë në mitologjinë greke, ose i Eneut me Didonën te *Eneida* e Virgjilit.

Kjo ndërlidhje e shpellës me blatimin vërehet në Bregdetin e Jonit te shpella e **Spilesë**. Është konsideruar si një ndër shpellat më të hershme të kësaj krahine dhe jo vetëm kaq. Arkeologu italian L.Kardini, në vitin 1939 bën gërmimin e parë në shpellën e Spilesë (Himarë), (botuar nga D. Mustili). Ai provoi se shpella ishte banuar në Epokën e Neolitit të Ri (3000 – 2100 p. l. K.). Sipas gojëdhënave, thuhet se në shpellën e Spilesë në Himarë jetojnë zanat e detit dhe njerëzit e konsideronin si vendkult ku i adhuronin këto zana. Kjo vërtetohet akoma më tepër gjatë gërmimeve arkeologjike në këtë shpellë, ku, sipas Ilir Gjipalit, shpella nuk ka shërbyer si vendbanim i përhershëm, sepse nuk janë gjetur mbetje të strukturave të qëndrueshme. Por kjo shpellë është përdorur si

vend kult, ku janë ngritur struktura druri të futura në tabanin e shpellës nëpërmjet gropave të hapura për fiksimin e shtyllëzave (Gjipali 2004: 43).

Për vetë lashtësinë e saj, shpella e Spilesë përmendet sipas gojëdhënës popullore si vendi ku gjeti strehim Odisea i Homerit, që përjetoi me shokët e tij peripecitë me ciklopin Polifem.

Edhe në Greqi shpellat ishin një vend për adhurimin e nimfave. Dy nga shembujt më të njohura janë: shpella Vari në Imito të Atikës dhe Korrikio në Delfi të Parnasos (Brewster 1997: 97). Perëndia Pan ishte i lidhur gjithashtu me shpellat, kryesisht pas fillimit të adhurimit të tij në Atikë në shek. V p. l. K.. Megjithëse shumica e shpellave të Panit gjendeshin në vend të hapur, kishte dhe përjashtime. Kur athinasit e vendosën faltoren e tij në një shpellë në pjerrësinë jugore të Akropolit, i bashkangjiten qytetit një pjesë të egërsisë bujqësore.

Ka dhe një lidhje simbolike më të qartë në sistemin e ideve që e lidhin një perëndi nga e quajtura “protokulturë”, Arkadia prehistorike, me një pjesë të natyrës-shpellën, që ndihej se i përkiste të kaluarës së largët. Me një simbolikë të tillë, Eriniet nderoheshin në një shpellë të shenjtë afër Areo Pago. Pamja e jashtme e frikshme e këtyre perëndive dhe roli i tyre në ndjekjen e vrasësve, solli një zgjidhje logjike në veçimin e tyre në një vend të egër të natyrës.

Në këtë kontekst, në Bregdetin e Jonit është edhe shpella e Palermos. Sipas traditës gojore në Palermo (pranë kështjellës sot) ishte një gropë e thellë ku mendohej se rronte Lubia (Arkivi vetjak i familjes Gjoni. Mblodhi Irena Gjoni nga Maro Kodhima, 84 vjeçe, Qeparo 1996). Qeniet gjysmë kafshë e gjysmë njeri popullonin edhe shpellat buzë detit. Ato ishin tinzare e të fuqishme dhe lëshonin klithma. Po t’u afrohej ndokush, ato dilnin te gryka e shpellës dhe njerëzit iknin të lemerisur. Nuk rrëmbenin as fëmijë, as bagëti. Po t’i shihje këta përbindës, ishte ogur i keq për të dalë në det (Papeleka 2004: 445).

Gryka e Shpellës (Hidronim buzë detit Jon në Lukovë). që e ka marrë emrin nga shpella që gjendet m’u në buzë të detit Jon, është një tjetër vend i rëndësishëm në këtë kategori. Aty përfundojnë ujërat e Përroit të Hundecovës bashkë me Xhindet, që mendohet se jetojnë në to.

Në eposin heroik shqiptar dhe në mbijetojat e mitologjisë së Bregdetit të Jonit, hasen gjurmë të attributeve të mësipërme që u vishen shpellave.

Shpella në Bregdetin e Jonit zakonisht është e pranishme si vendstrehim i personazheve për t’iu shmangur rrezikut:

- a. si një vendstrehim dhe stacion i detyrueshëm,
- b. si një vendqëndrim i përzgjedhur për t’iu shmangur një rreziku evident; dhe
- c. si vendtërheqje, për t’u paraqitur përsëri.

Rastin e parë e gjejmë te **Shpella e Gramës**, një ndër shpellat më të rëndësishme në Bregdetin Jonian (mund ta gjejmë të emërtuar edhe shpella e Gramatës). Kjo shpellë është krijuar nga shfrytëzimi i gurores më të madhe të vendit tonë me një hapësirë prej 200000m³ me faqe vertikale deri në



Gjiri i Gramës

Në shek. III p. I. K., në faqet shkëmbore të saj ka filluar gdhendja prej detarëve e mbishkrimeve që zgjaten gjatë gjithë anës lindore të Gjirit. Siç e ka



vënë në dukje Paçi, mbishkrimet u takojnë kohëve të ndryshme. Duke bërë një klasifikim të tyre, do të dallojmë mbishkrime të shkruara drejtpërsëdrejti në shkëmb dhe të tjera të vendosura brenda një sipërfaqeje katërkëndëshe të thelluar në shkëmb.

Mbishkrimet e Gramës

Gjithashtu, nga mënyra e të shkruarit dallohen mbishkrime të skalitura dhe një grup më i vogël të shkruara me bojë të kuqe. Një pjesë e mbishkrimeve i përkasin periudhës shek. III – I p. I. K.. Përgjithësisht janë lutje kushtuar Dioskurëve, perëndive mbrojtëse të tyre. Një vend të veçantë zënë edhe figurat e gdhendura në shkëmb ku dallohen anije, një skenë me një kasolle dhe një grua pranë saj, amfora dhe shenja të tjera.

Periudhës së dytë të mbishkrimeve në Gramë i përkasin ato të shekujve VI – XI pas Krishtit. Gjithsej janë rreth 500 mbishkrime (Ceka/ Zeqo 1984/2:

50m. I ndodhur në një pozicion të favorizuar, midis ngushticave të Korkyrës dhe Otrantos ku kalonin rrugët e rëndësishme, bregdeti Kaon e pikërisht Grama rrihet edhe prej detarëve të antikitetit (si stacion i detyruar).

131). Një vizatim na jep një kompozim, një anije e pranë saj figura amforash të mëdha. Njëri vizatim është bërë në një sipërfaqe vertikale të shkëmbit, me një përpunim të bazamentit të poshtëm tamam si për vendqëndrim (Zeqo 1986: 135). Mendoj se kemi të bëjmë me nderimin e kultit të ujit të pijshëm të paraqitur simbolikisht me figurën e amforës, enës ujëmbajtëse.

Në atributin, si një stacion i detyrueshëm, është edhe **Shpella e Halile**. Horaci na dëshmon se “Shkëmbinjtë Akrokeraunianë janë shumë të famshëm për shkatërrimin e anijeve” (shek. I p. e. s.) (Pukëvil 1999: 66). Në tabelën e Pentigerit, një hartë rrugore e shek. III – IV, Acroceraunia përmendet si një stacion i rëndësishëm në rrugën nga Aulona në Foinike, për në Nikopol. Traseja e kësaj rruge dhe mure mbështetëse të saj, ruhen në Shpellën e Halile, në të vetmin shteg natyror, midis fushës së Qeparoit dhe të Borshit (Koçi 2006: 5). Sipas gojëdhënës, në këtë shpellë duhej bërë një pushim si një nderim ndaj hyut të udhës.

Shpella, si një vendstrehim i përzgjedhur për t’iu shmangur një rreziku evident, është ajo e **Haxhi Aliut**. Konsiderohet si një ndër shpellat më të mëdha në bregun e Jonit e legjendarizuar në folklorin detar shqiptar. Kënga popullore e quan këtë detar “Hyri të detit” (është fjala për një figurë mitologjike femër që përfaqëson detin, një Posejdon femër). Shpella e Haxhi Aliut, nga arkitektura e saj shkëmbore, të kujton përskrimin që i bën Homeri shpellës së Polifemit. Brenda shpella i ngjan mjedisit të një katedraleje gotike që kulmohet deri në 60m. Në hyrjen e shpellës, në thellësi 40m, janë gjetur amfora të shekujve V – II p. I. K.. Në thellësi 8 – 9m duke zbritur, duket një grykë tjetër nën ujë, një shpellë e cila quhet me kate. (Zeqo 1986: 67-68).

Emërtimi i myslimanizuar tregon për mbishtresëzimet fetare dhe për përdorimin funksional të këtyre shpellave edhe në kohë më të vona. Sipas M. Zeqos, Haxhi Aliu te kjo shpellë fuste anijen e tij, derisa u vra nga venecianët:

*“Haxhi Aliu me të birin
Porsi mbreti me të birin”.*

Këto dy vargje, të mbledhura nga Thimi Mitko, tregojnë se mbretëria e këtij detari me të birin, ishte deti e brigjet e tij. (Mund të jetë shpella e vendstrehimit të detarit ulqinak Haxhi Alia, me çka përkon edhe emri i të vrrit nga venciianët rreth vitit 1710). (Shuteriqi 1959: 93).



Shpella e Haxhi Aliut

Heronjtë e eposit heroik strehohen nëpër shpella, njësoj si Haxhi Aliu i mitologjisë bregdetase të Jonit. Gati edhe konteksti i strehimit është i njëjtë: Muji e Halili të mos e paguajnë haraçin, kurse Haxhi Aliu të mbetet gjallë.

Shpella është konsideruar edhe vendstrehim i dashnorëve (Haxhihasani/ Sako 1966: 283), si është rasti i strehimit të Halilit me të dashurën e tij Tanushën, që të mos zbulohet nga ndjekësit:

*"Met e foli nusja pej oxhaku:
- Mos ki dert, thotë, Sokole Halili!
Kam ndi babën, tha, dert-e tu e ba:
"Me ba mreti ndojherë me na ra,
ën qet bjeshk-e ni shpellë qi e kam,
për tri vjet-e myhemat qi ka,
topi as pushka s'kanë ca me na ba.
Msyje shpellën, Halil! i ka thanë"*

(Çetta 1974: 6).

Sipas teorisë së iniciacionit, me këtë rast do të flitej për iniciacionin e dasmës, me hyrjen e iniciantëve në botën e kaosit, vdekjen e përkohshme, si konsiderohet ky akt, dëshirohet të rilindet në një status social tjetër.

Në këtë kontekst shpella është vendburgosja e të Bukurës së Dheut nga Kuçedra, për shpëtimin e të cilës do të angazhohet i Bukuri i Dheut, personazhe të shpeshta të përrallave shqiptare dhe jo vetëm shqiptare, por edhe të popujve të tjerë.

Shpella në folklor, zakonisht është e pranishme jo vetëm si vendstrehim i personazheve për t'iu shmangur rrezikut, por ka edhe atributin ritual të transformimit të statusit të njeriut, kur bëhet fjalë për teorinë e iniciacionit, si dhe të mbretërisë së ndonjë luftëtari. Në eposin heroik ajo zë një vend të rëndësishëm, ka një rol të veçantë dhe ndërlihet me jetën dhe veprimet e personazheve. Paraqitet edhe si qendër e botës dhe "simbol i kozmosit." Por edhe vendtakim i individuale me hyjnoren, pra i takimit të botës njerëzore me atë qiellore.

Shpella në eposin heroik shqiptar shërben edhe si vendburim i forcës fizike. Në shpellë Mujin e kojnë orët "me tamël gjini" ose me lëng lulësh dhe e transformojnë nga një qenie njerëzore, në një kolos mitik:

*"Larg ni shpellë sa ni dritë e ki pa;
shkoi pas drite e shpelln e ki gjetë,
qaty bajke konak për me fjetë"*

(Çetta 1974/1: 2).

Këto vargje mund të interpretohen edhe si faza e "vdekjes së përkohshme", por këtu nuk bëhet fjalë për fazën e iniciacionit të Mujit, edhe pse pas daljes nga shpella ky ndryshon statusin e tij: fiton forcë kolosale, në sajë të qumështit që i kishin dhënë zanat si shenjë falenderimi për kujdesin që tregoi për foshnjat e tyre. Muji tani fiton një status të ri dhe me këtë rast ndërron edhe emrin, sepse ia kërkonte pozita e re shoqërore:

*"E ternoi ai emnin e babs t'vet,
ja ka ngjitë as posestrima e vet –
"Mujë" i tha, e Mujë, besa i ka petë,
me qat emen ka rrnuat 'iqin vjet.
E ka njoftë, po, besa, krajl e mret"*

(Çetta 1974/1:3)

Shpella ka edhe atributet e ringjalljes: heronjtë e eposit heroik shqiptar, kur u kalon koha, tërhiqen në shpellë, për t'u rikthyer përsëri kur të paraqitet nevoja.

Po kështu në Bregdetin e Jonit e përmendur dhe e rëndësishme është edhe **Shpella e Piratëve** me gojëdhënat e saj. Apo **Shpella e Pëllumbave**, një vepër arti e natyrës, simbiozë pasionante e skulpturore e detit dhe e gurit. Emërtimi i saj e fut te kategoria e shpellave që kanë një lidhje mitike, si dhe Shpella e Dukë Gjonit me shumë mbishkrime të lashta (Zeqo 1986: 67-68, 160).



Shpella e Dukë Gjonit Karaburun

Përfundim

Pra siç e shohim, shpellat janë të pranishme si në mitologjinë e Bregdetit të Jonit, ashtu edhe tek areale të tjera mitike. Mes tyre vërehen pika të përbashkëta, por edhe dallime. Ndër të përbashkëtat veçojmë:

1. Tek të dyja mitologjitë, shpellat ruajnë karakterin e tyre të egër.
2. Paraqitja e tyre veçon dhe përpunon disa nga anët e vendkultit e faltores.
3. Kryesisht popullohen nga shumë hyjni që i përkasin së njëjtës kategori (zanat, xhindet, nimfat, eriniet).
4. Hyjnitë që i popullojnë, përgjithësisht mbartin një konotacion frike.
5. Tek të dyja mitologjitë, shpellat shërbejnë si rrugë lidhëse drejt Hadit.

Bibliografia

ARKIVI vetjak i familjes Gjoni.

BREWSTER, H. (1997), *The river Gods of Greece; Myths and Mountain Waters in the Hellenic World*, London and New York.

CEKA, N. / ZEZO, M. (1984/2), *Mbishkrimet e Gramës: Monumentet*, Tiranë.

ELIJADE, M. (1992), *Aspekti na mitot*, Kultura, Skopje.

GJIPALI, I. (2004), *Kërkime arkeologjike në bregdetin Jonian*, Tiranë.

LAMPIC, M. (1999), (Përgatitur), *Mali recnik tradicionalnih simbola*, Beograd.

LARSON, J. (2001), *Greek Nymphs: Myth, Cult, Lore*, Oxford.

PAPLEKA, A. (2004), *Deti dhe ulliri në traditën gojore të Bregut: Himara në shekuj*, Tiranë.

PUKËVIL, F. (1999), *Në oborrin e Vezirit të Janinës*, Tiranë.

TIRTA, M. (2004), *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tiranë.

ZEZO, M. (1986), *Motive arkeologjike*, Tiranë.

Ndërsa përsa u përket prioriteteve përmes dallimeve, mendoj se:

1. Shpellat e Bregdetit të Jonit janë shpella në buzë të detit dhe mund të jenë më të hershme si vendkulte, sesa shpellat e arealeve të tjera mitike.
2. Këto të fundit, mendoj se kanë një prioritet përsa i përket popullimit të tyre nga disa prej hyjnive që janë ndër më të rëndësishmet në mitologji si: Zeusi, Dionisi, Pani (paçka se mund të ishte një popullim momental).
3. Shpella në Bregdetin e Jonit zakonisht është e pranishme si vendstrehim i personazheve për t'iu shmangur rrezikut:
 - a. si një vendstrehim dhe stacion i detyrueshëm,
 - b. si një vendstrehim i përzgjedhur për t'iu shmangur një rreziku evident.
 - c. si vendtërheqje, për t'u paraqitur përsëri.

SOCIOLINGUISTIC CONTEMPLATE IN THE KNIGHTS EPOS OF NIKAJ - MËRTUR KUNDRIME SOCIOLINGUISTIKE NË EPOSIN E KRESHNIKËVE NË NIKAJ - MËRTUR

DEDË QOKAJ

Gjimnazi "Elez Isuf Ndreu",

Kamëz, Tiranë, ALBANIA

E-mail: dede.qokaj@gmail.com

Përmbledhje

Kultura e etnografisë së të folurit në Eposin e Kreshnikëve në Nikaj - Mërtur është model ligjërimit. Vlerat e thënies, dallimet e të folurit gjinor, zgjedhja e fjalëve, stili poetik, rendi kumtues, sidomos në kuvende, mes kreshnikëve, janë norma juridike kanunore, që reflektojnë pasuri të jashtëzakonshme etnolinguistike të trevës nikajmërturase. Etika e komunikimit në kuvende ligjërimore dhe në Epos, format e shprehjeve, dëshmojnë për modele arkaike të lashtësisë gjuhësore, si: *kreshtë, rrekem, shpatë, heshtë, ashtë, drum, zanë, orë, fiskajë, breshtë etj.*

Etnografia e të folurit në kuvende, në këndvështrimin fonetik, shfaqet e lëmuar, e rrafshuar si standard, në evoluimin dialektor, jo në shumë variante fonetike, por që kërkon një studim më të imët, në përshtatje me arealin gjuhësor. Stili i të folurit në Eposin e trevës është elitare, me fjalor të zgjedhur, duke mbartur në vetvete një model poetik të një niveli shumë të lartë.

Fjalë çelës: Epos, etnografi të foluri, sociolinguistikë, kuvend, odë, ligjërimit.

Abstract

Ethnographical culture of speaking of the Knights Epos in Nikaj - Mërtur is a model based speaking. The values of quotes, differences in gender speaking, the word choosing, poetic style, its order of comprehending, especially in Kreshnik's courts are loyal canun norms that reflect extraordinary ethnolinguistical values of the range in Nikaj - Mërtur. The ethic of communication in speech assembly and in the Epos, forms of phrases, it declares about archaic models of the ancient literature such, as: *kreshtë, rrekem, shpatë, heshtë, ashtë, drum, zanë, orë, fiskajë, breshtë etc.*

The ethnography of speaking in courts in a phonetical way of perception, is softly appeared, lined like a standard in dialect evolution in not more than a lot of phonetical varieties, but it required a hard study that fits with the literature divided into districts. The style of speaking in the Epos of these places is essential with a chosen vocabulary inheriting itself a poetry model of a high level.

Key words: Epos, ethnographical of speaking, sociolinguistic, assembly, room, lecture.

Hyrje

Me këtë Epos jam mëkuar që fëmijë, por edhe nga studimet filologjike, ku një pjesë janë marrë në vendlindjen time Curraj i Epërm, si: "Fuqia e Mujit", "Martesa e Halilit", "Gjergj Elez Alia", "Ajkuna kjan Omerin" dhe "Omeri prej Mujit" (Visaret II 2005), të cilat kanë edhe etnografinë ligjërimore të kësaj treve, rapsodëve të tyre, edhe pse shihet dora e mbledhësve jezuitë, për çka kemi përdorur edhe kompetencën gjuhësore të folësit.

Në këtë studim bëjmë me dije se do të shprishim disa veçori sociolinguistike të traditës kuvendore në ligjërimit, veçantë, nga Eposi i kësaj treve, si pjesa më elitare e etnografisë së të folurit. Kuvendet në Nikaj - Mërtur kanë qenë një traditë e hershme, sepse ishin një parlament popullor, ku merreshin vendime të rëndësishme komunitare, si pjesë e Pultit mesjetar.

E drejta kuvendore si etnografi të foluri

Sipas Kanunit ka qenë e përcaktuar: kuvendet bëheshin "tu Kisha e Nikajvet" (Kanuni 2010: 101), me tri vendime (Kanuni 2010: 119-121) e më pas më 1905, 1907, 1908, 1910 dhe 1911 etj. e më vonë. Bile, këtë e dëshmon një dokument i shkruar shqip, që i përket vitit 1689, në verilindje të Shqipërisë, i nënshkruar nga krerët e Gashit, i gjetur në arkivat e Romës (Maloku 1969: 2).

Vetë fjala "kuvend" krijon një familje të tërë fjalësh, si: *kuvendoj, me kuvëndë, bāj kuvend, nxâm kuvend, hîm n'kuvend, me lidh kuvend, me shtrue kuvend, me i bâ temél kuvëndit, me çel kuvend, kuvëndçar,*

kuvendâmbël, kuvëndvogël etj (Shkurtaç 2004: 89 - 90). Askush nuk ia priste fjalën tjetrit. Madje ekziston edhe sot shprehja "me m'pre kuvëndin m'kie pre djalin". Lidhur me fjalën "kuvend" përdoren edhe shprehje të ndryshme, si: *I ka grat fjala; I ka grat kuvendi; I pret hollë kuvendi; Di m'e dredh kuvendin; Ja bâ hullinë kuvendit; Ia di rendin kuvendit; Burri fol me rend e me mend; Gjej vëndin e bâ kuvendin.*

Pra, shprehjet ishin të përcjella si togje të gatshme nga përvoja e të tjerëve ose ishin kompetencë gjuhësore e folësit që i shkonin atij kuvendi burrash, si etnografi të foluri. Ja disa prej tyre, që unë i kam dëgjuar shpesh apo i kam qëmtuar ndër të tjerë, apo në literaturën e botuar nga krahina:

A. *Tuⁿ gatjeta burra! Mirë se u gjeta burra! Mos, bre, mos lueni burra, mos u çoni t'tân n'kâmb!*

B. *Mirë se vjen burri i burrit apo burri i dheut! Burri erdh. Paj luejnë edhe zojt e jo burri per burrin;*

A. *A je P. Nika? A je C. Qerimi? A je K. Ndou? A 'ini burrat e katundit?*

B. *T'paqim shndosh a je si jje M. Sadiku?*

Brenda shtëpisë autoriteti kryesor i kuvendit ishin "i zoti i shpīs" dhe "e zoja e shpīs", që ishin pleqnarët kryesorë për çdo problem, por secili brenda tagrave të vet administrativë. Etnografia e të folurit me ta ishte shumë e kujdesshme, mirënjohëse dhe e përcaktuar në formulat e saj të komunikimit, edhe sipas pozicionit dhe shtresave moshore, si: "Á ka vje' i zoti i shpīs. Páleni (pushoni), se á ka vje ký e po u

gjê ka bâni zhurm'. Ai â kulmi i shpîs e duhet me u que n'kâmb te tân per tâ. Pa tâ s'kena t'gjall". Ai â ora e shpîs etj.

Për këtë, zonja e shqiptarëve, Edith Durham, vinte në dukje se “ata kanë një forcë të mrekullueshme bindjeje, kur besojnë se bindja është e nevojshme dhe zakonisht i binden të zotit të shtëpisë absolutisht” (Durham 1990: 164).

Autoriteti i dytë në shtëpi ishte “e zoja e shpîs”. Ekzistojnë shprehje të ndryshme për “zoja shpie”, si: *Ajo â grue e përtë burrit. Asaj i bâ edhe kângji (gjeli) voe. Ajo grue di me i mbyllë tâna birat e shpîs.* Për këtë janë dhënë edhe opinione të ndryshme për gratë, si: - *Ka pase gra qi kan'da pleqni e kan' pajtue gjaqe!* - *Permenden gra kuvendtare e qi u ndihej fjala n'kuvend t'burrave.* - *Grueja e meçme mban nji ship rob - Nji grue e mîr ka nji kâli pâre per shpi t'robit!* - *Burri e mban shpîn, grueja e kurdarîs (administron),* (Tahiri 2009: 185-187).

Në kuvende të tilla diskutohej për rregullat themelore të bashkëjetesës në katund. Shprehjet më karakteristike që përdorehin në raste të tilla ishin:

A. *Tu^o gatjeta juej e mir' se rrii burra!*

B. *Mir'se erdhe burri i katundit. Burri erdh.*

A. *Jo i gjeta ktu burrat.*

B. *Pâde t'lumt goja filani, ça kie me u thân' ktyne burrave?*

Fjala e burrave në kuvend ishte më e hekurt se çdo dispozitë ligjore në kohët moderne. Ishte tërësisht produkt mençurie dhe diplomacie të hollë, ndaj ka ekzistuar edhe mallkimi: “*T'u preft' fjala n'kuvend burrash!*”, por edhe urimet: - *T'lumt goja mir' po thue!* - *T'lumt' goja, o Gjelosh Rama, se qebésa e burrave, i madh e i vogël, jena me tý!* - *Tu preft' me mjaltë!* - *la laq djalit!* - *T'pjeqnoft' djali!*”.

Sociolinguistika në Eposin nikajmërturas

Në Epos etnografia e të folurit është më e zgjedhur. Modelet e komunikimit janë të sistemuara, si në një kod rregullash të bëra nga juristë me përvojë. Gjuha është brenda një standardi të saktë, si: fonetik, morfologjik, sintaksor, por edhe leksikor.

Ne do të spikatim, vetëm disa veçori që lidhen me etnografinë e të folurit kuvendor (Gjurmime 9/2009, 2010: 80). Ajo çka të bie në sy është se kreshnikët janë zbatues të përpiktë të normave kanunore, si në rend kuvendi a muhabeti me njëri - tjetrin, në etikë komunikimi, e cila ruan format standarde të shprehjeve në “bvetje”, përsëndetje, në dallime mes të folurit mashkullor dhe femëror, në stilin e tyre komunikues etj. Por logu i kuvendit ishte parlamenti ku vendosej për fate të pastajme, vendime të cilave gjithkush u rrinte në mënyrë të barabartë, në atë “odë” burrash “ku peshohej fjala e ndahej drejtësia, kërkohet: “kujto e mendo, fol e mos gabo” (Krasniqi 2012: 49-50).

Në Epos ky “parlament” i fjalës funksiononte më mirë se askund, ku më i madhi, kryesori, në shtëpi, në oda burrash, në log kuvendi, merrte fjalën dhe të tjerët respektonin mendimin e tij. Fjala e tij ishte ligj, si më i

madhi, në shenjë respekti, si etikë komuni-kimi: *Kanë nisë trimat Mujin p'e pëvetin: - Qysh Halilin s'e martove?! - Faqe - bardhë, more shokë, ju kjoshi/ Se mirë hallin po ma dik'i burra!* (Palaj & Kurti 2005: 26).

Formulat kryesore në nisje të kuvendit, muhabetit, të zënies së fjalës, janë pothajse standarde, si rregull dhe disiplinë për ta dëgjuar tjetrin: *Aty plaku u paska folë: "Pa ndigjoni, o krushq darsmorë!/ Pa ndigjoni ju gjahëtarë!/ Se kuvend burrash djali paska shtrve: Pa ndigjo, more ti djalë!/- Ka folë plaku Osman Aga; - Pa nigjo, more krajle kapedane!* (Visaret 2005: 2, 8, 27, 39).

Rendi i të folurit, “rëndi i kuvëndit, shtegu i fjalës” janë etikë e veçantë e etnografisë së të folurit në ciklin nikajmërturas, si: *Rend me rend, Mujo, po flasim!/ Ka britë t'madhe plaku Basho Jona...* (Visaret 2005: 27).

Mençuria në kuvend, sintagmat etnografike të të folurit “*me di:t se ku vret fjala; m'e ma:t fjalën, atherë me fol; me u mat dhet herë e më folë 'i herë*”, gjejnë përdorim të shpeshtë në Epos, nën shprehjen: *Fjal'n e mbrame e paska folë: "Zâna jini e zâna kjoshi!/ "Besa besë, e fjala fjalë...!"* (Visaret 2005: 9).

Përcjellja e fjalëve në kuvend, replikat mes aktorëve janë një model tjetër etnografik i të folurit, ku dhe fraza “*...një plak i urtë..*” del shpesh. Frazat janë ndërtuar sipas sintaksës popullore, në ujdi me rendin e shqipes. Ka natyrshmëri dhe nuk gjen klishe të huazuara, siç ndodh në stilin libror: “*At-herë djali Mujit te i ka thanë: "Çetash gjogun, Mujë, ti me m'a dhanë!/ Atëherë kâ çitë krajli e i ka thânë: - Ti hoshgjeltën, Ali aga i ri,/ Atëherë foli Gjeto Basho Muja: - Fjalë të keqe ndër vedi s'po bâjmë, / Kâ qitë Muja e u kâ thânë: - Kângëtarë, kush mos këndon!"* ose “*Shka kâ qitë krajli e i ki' pëvetë apo Atëherë foli Sokole Halili: - Un n'at çetë, Krajl, vetë s'jo këndë,/ Qysh kâ folë ai Osman Aga i ri: - Pâsh nji Zot, krajl, qi t'kâ dhânë.../ Shka kâ thanë një plak i urtë: - E fort po tutem se krajli na njeh; Atëherë foli Arnaut Osmani: - Për ket punë hiç me u ngushtue*” (Palaj & Kurti 2005).

Në të drejtën zakonore herë - herë, gruaja merr pamje e pozitë burri, liri që e gjejmë në të drejtën e pashkruar në shumë shtëpi, por gjykimet e tyre jepeshin tërthorazi, bile shumë herë kanë ndarë edhe pleqësi, por duke ua deleguar “mençurinë” burrave (Tahiri 2009: 185 - 187). Ja një rast: Mblidheshin burrat shpesh për një ndodhi në fshat dhe nuk e zgjidhnin dot marrëveshjen me të dëmtuarin. Një të diel, kur gruaja mendonte se i shoqi duhej të qëndronte në shtëpi, e sheh të bëhet gati për në Kuvend. E habitur dhe e nevrikosur, me malin e punëve që kishte, i drejtohet të shoqit:

Gruaja - *Ka je ka shko, more ti nieri?*

Burri - *Po n'qat pjeqni si nuk e kena zgïdh edhe.*

Gruaja - *Po pse a prap' nuk e kini zgïdh-a?*

Burri - *Jo, brë grue nuk prandon i dâmtuemi.*

Gruaja - *Po si âsht puna, more ti nieri?*

Burri - *Qêni i filânit ki' pa kapshue kojshin e mrapa ki' pa' dëk. Ndoshta qêni â kânë i térbue. I dâmtuemi nuk i prando paret, po kërko m'e vra dikâ.*

Gruaja - Uuuu! Po a për qet punë kini ndëj' qe gjasht' muej-a? A s'ju vje' marre tân' atyne burrave?

Burri –Po ti si thue me bâ, mori grue?- thotë burri me ironi.

Gruaja – Atij kini me i thanë: O merri paret për dekë si t'ka ndôdh, o vraj gjaksin!

Habitet burri e shkon duke përsëritur me vetveten pleqërinë e gruas. Hapet kuvendi dhe, në debat e sipër, jep mendimin që i dha gruaja duke habitur pleqtë. Një nga burrat pleqnarë të kuvendit i thotë në vesh: - Pse bræ na læ tash gjasht muej peng e s'na kie tregue zgïdhjen? - M'ka msue grueja, brë burr, se as û s'e kam dît (Vukaj 2006: 132-133) dhe të dy shkrihen së qeshuri.

Është me interes pozita e gruas, sidomos *Ajkuna* apo "nana e motnueme", nusja, fjalët me peshë të tyre në këshilla, udhëzime, vendimmarrje, ku dalin krah i kreshnikëve.

Në cikël kemi: *Mirë po i flet nana e motnueme: "Po ti ç'bâne, more bir, /Gjogun djalit qi s'ia dhae?; Atëherë foli nusja prej oxhakut: - Amanet, Gjeto Basho Muji,/ Zo kush âsht ai njeri, qi bërtet/ E ká qitë e âma e i kâ*

thânë: - A t'ka dekë mik a probatin?" (Visaret 2005: 29, 121, 141).

Përfundim

Për nga veshja poetike, sidomos "*Martesa e Halilit*" (Visaret 2005: 27), zgjedhja e fjalëve, leksiku i lashtë dhe frazeologjizmat e përdorur, ky *Epos*, me epiqendër artistike Mirash Gjonin e rapsodë të tjerë të Currajve të Epërm e deri në anën më skajore të Nikaj - Mërturit, me Sokol Martinin e Brisës, që zotëronte mbi dhjetë mijë vargje, është krenaria folklorike dhe gjuhësore e popullit shqiptar (Haxhihasani 1962).

Në lëmin fonetik, veshja gjuhësore e ligjërimit të ciklit, është e lëmuar, afër standardit letrar, me elemente arkaike të një shqipeje të vjetër, në vokalizëm, konsonantizëm, si areal gjuhësor, me elemente edhe verilindore, edhe veriperëndimore, por edhe me evoluime të reja dialektore (Lafe 3/1964: 135-136).

Hulumtimet sociolinguistike, në kundritime të ndryshme, në tërë hapësirën e arealit, në ligjërimit dhe artin poetik, onomastikë, si pjesë gjenerale e një monografie shkencore, do sjellë risi përmes një arsyetimi silogjik, si pengu im profesional.

Bibliografi:

Dukagjini, Pal (1996), *Mehmet Shpendi e Mark Sadiku i Shalës*, Romë, f. 53 - 55.

Durham, Edith (1990), *Brenga e Ballkanit...*, Tiranë, f. 164.

Gazeta "Koha jonë" (14 janar 2003), f. 21.

Gjeçovi, Shtjefën (2010), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, botimi III, Shkodër, f.101, 119 - 121

Gjurmime albanologjike, (39/2009, 2010), Seria e shkencave filologjike, Prishtinë, f. 80, 92.

Haxhihasani, Qemal (1962), "Rezultatet e kërkimeve të ciklit të kreshnikëve pas çlirimit", Kumtesë e mbajtur në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Hylli i Dritës, 9 – 12 (1942), f. 151.

Krasniqi, Emin (2012), *Etnografi e të folurit në odë*, f. 49 - 50.

Lafe, Emil, *Studime filologjike 3/1964*, f. 111 - 116 dhe 135 - 136.

Maloku, Latif (1969), revista "Përparimi", nr. 1, Prishtinë, f. 2.

Palaj B. & Kurti D., (2005), *Visaret e Kombit*, botim II, Shkodër, f. 2, 3, 4, 5, 26, 27, 29, 30, 39, 54, 57, 118, 120, 121, 140, 141, 169, 172, 173, 193, 194, 197.

Shkurtaj, Gjovalin (2004), *Etnografia e të folurit*, f. 89 - 90.

Tahiri, Kolë (2009), *Tahir Sheremeti mahitet me njerëzit dhe kohën...*, Tiranë, f. 185 - 187.

Vukaj, Frrok (2006), *Krenari për vendlindjen*, Tiranë, f. 132 -133.

MITI I GJUHËS TEK AUTORËT E PARARILINDJES KOMBËTARE THE MYTH OF LANGUAGE TO THE AUTHORS OF THE BEFORE RENAISSANCE NATIONAL

AGATA ROGOŚ

Institute of Slavic Philology
Adam Mickiewicz University
Poznań, Poland
Email: a.a.rogos@gmail.com

Hyrje

Miti i gjuhës në traditën shqiptare lidhet me disa nga kategoritë themelore të teorisë së nacionalizmit dhe të ndërtimit të identiteteve në kohën e Rilindjes kombëtare, të cilat dukshëm kanë ndikuar në ndërtimin e kombit dhe, në të njëjtën kohë kanë kushtëzuar dhe kanë ndihmuar ndërtimin e sistemit të simboleve dhe të miteve në kohën moderne. Kështu, ndërgjegjësimi e vetëdijesimi kombëtar, bashkë me ndërtimin e strumbullarit të identitetit ka luajtur një rol vendimtar në një moment shumë të rëndësishëm për historinë e popullit shqiptar.

Miti i gjuhës është një nga shtresat e „vellos së misterhme”, përcaktojnë Althusser e Zhizhek. Funksioni i *ideologjikritikës* nuk është vetëm për të parë ose perceptuar gjera, siç janë në të vërtetë, por, në fakt për të parë se si realiteti nuk mund të qëndrojë i vetëm pa këtë mistifikim. Ky mistifikim riprodhon kushte për të manipuluar me ideologjinë sunduese (Zhizhek 2013: 94). Ndërkaq nëse ndjekim Benedikt Andersonin (Anderson 1997: 9-12) do të kishim pikëpamjen se rrëfimi i bashkësisë së imagjinuar e përforcon unitetin e bashkësisë ose unitetin e një grupi.

Eric Hobsbawmi, thekson se me këtë temë ballafaqohen format e identifikimit popullor në dimensione gjithëhapësimore, që kanë lidhje të ngushta politike si me shtetin dhe institucionet e tij, ashtu edhe me gjuhët e grupeve, që, në momente të caktuara mund të quhen lidhje universale dhe të përshtatshme (Hobsbawm 1990: 101–130).

Në këtë studim do ta analizojmë zhvillimin e mendeve të autorëve të Pararilindjes Kombëtare rreth çështjes së gjuhës shqipe dhe vlerësimin e saj në kontekstin të ndërtimit të identitetit kombëtar.

(1) Miti i gjuhës si faktori dallues të origjinës të përkatësisë teritoriale

Mitin në këtë perpektivë do ta trajtojmë, sipas Barthesit, si mistifikim dhe elementin shenjues (*signifiant*) do ta kuptojmë si formë, ndërsa shenjuesit (*signifié*) si koncept, dmth. definicion i cili mund ta shpjegojë këtë imazh.

Pranimin vullnetar të mitit, sidoqoftë mund ta përcaktojë e gjithë literaturë jonë tradicionale: kjo letërsi – e paraqitur në mënyrën normative – është një sistem i shenjuesit mitik: ka një kuptim – kuptimi i ligjërit; ka një *signifiant*, i cili si një formë apo mënyrë e shkrimit është ligjërimi vetë; ka një *signifié*, i cili krijon konceptin e letërsisë dhe ka një kuptim, i cili e krijon ligjërimin letrar (Barthes 2000: 267).

Rrëfimet mitike flasin për dallimet e origjinës, si dhe në ç'mënyrë grupet kanë ndikuar dhe kanë luftuar me njëri-tjetrin në të shkuarën dhe në vijimësi. Ato mund të funksionojnë si zëvendësuese apo nënshtrës të dallimeve të vërteta. Mitet u mundësojnë anëtarëve të grupeve t'i asgjësojnë dhe injorojnë ngjashmëritë e dukshme duke i ulur proporcionet e dallimeve midis unitit dhe tjetrit (Kolstø 2005: 3-4).

Këtu duhet të përmenden disa burime të hershme, të cilat, në traditën shqiptare e kanë ndërtuar strukturën dalluese mes Unitit dhe Tjetrit dhe kanë ndikuar në procesin e krijimit të identitetit shqiptar me themelin gjuhësor.

Një nga materialet e para që i referohen gjuhës shqipe është „Legjenda e kohës së Car Samoilit mbi prejardhjen e kombeve” e fillimit të shekullit XI, e regjistruar në punimin e Radoslav Grujiqit në revistën jugosllave (*Glasnik Skopskog Naucnog Drustva*, Skopje, 13 (1934), p. 198- 200) në vitin 1934 në të cilën lexojmë: Thuhet se ka gjuhë të ndryshme në botë. Midis tyre ka pesë gjuhë ortodokse: bullgare, greke, siriane, iberiane (gjeorgjiane) dhe ruse. Tri prej këtyre gjuhëve e përdorin alfabetin ortodoks: greqishtja, bullgarishtja dhe iberishtja. Janë dymbëdhjetë gjuhë të etnikumeve gjysmë besimtare: gote, franke, ungare, indiane, jakobine, armene, saksone, lehe (polake), arbanase (shqiptare), kroate, hize, gjermane.

Gjuha shqipe paraqitet këtu midis gjuhëve të tjera dhe me këtë vertetohet një traditë e fortë kulturore dhe e implementuar në botën mesjetare. Në këtë formë – miti i gjuhës – është përdorur shumë herë, jo vetëm në traditën shqiptare, por edhe në kultura të ndryshme, si bazë e mitit të origjinës, i cili, në këtë rast është shumë i lidhur ngushtë me strukturën gjuhësor, duke e trajtuar si artefakt kulturor.

Hasim edhe tregime të tjera, më vonshme, të cilët, zakonisht janë gjetur te udhëpërshkrues të huaj. Te këta gjuha shqipe paraqitet si *signifiant* d.m.th. një formë e esencës dhe origjinës së traditës. Në këtë rast: shqiptare, duke shënuar hapësirën simbolike dhe fizike (teritoriale). Në dokumentin latinisht nga Raguza të vitit 1285 gjejmë fragmentin në vijim: „Dëgjova një zë në mal, që thërriste në gjuhën shqipe” (Dokument latinisht nga Raguza, 1285).

Më tej te udhëpërshkruesi francez i vitit 1308 haset informata shumë e rëndësishme mbi studimet etnoghjuhësore dhe etnologjike: „Shqiptarët e lartë-

përmendur kanë një gjuhë të ndryshme nga ajo e latinëve, grekëve e sllavëve, prandaj aspak nuk merren vesh me popujt e tjerë” (Një udhëtar francez anonim, 1308). Mendimi i këtij udhëtar anonim francez ishte konfirmuar 30 vjet më vonë nga prifti francez Gulielmus Adae (1332), i cili mbretit francez i ka raportuar me këto fjalë: „Sado që shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinët, përsëri kanë në përdorim dhe në të gjitha librat e tyre shkronjat latine” (De regno Rassie, quomodo faciliter sit capiendum, f. 485).

Argumente të këtilla kishin nxitur Frang Bardhi në vitin 1635, gjithashtu të nënvizojë: „**vetë gjuha e popullit epirot ose gjuha shqipe** ndryshon kryekëput në mënyrën e të folurit nga ajo greke dhe ajo ilirike ose sllave, megjithëse vendi ynë është në kufi ndërmjet këtyre dy popujve”¹.

Këtu flitet drejtëpërdrejt mbi prejardhjen e veçantë të popullit shqiptar, mbi të cilën është ngritur origjina e tij, në periudhat e mëvonshme ishte rikonstruktuar miti i origjinës dhe i prejardhjes së lashtë të gjuhës së tyre, që ka përbërë strumbullarin e ideologjisë nacionaliste, herën e parë në kohën e Rilindjes Kombëtare, më pastaj, me vallën e dytë të nacionalizmit shqiptar në kohën e diktaturës. Po edhe kështu thekson Kolstø, miti i gjuhës shqipe fillimisht ka të bëjë me mitin e origjinës, si element dallues, midis unit dhe tjetrit. Megjithatë rrënjët e këtij miti janë trasuar që në kohën e Humanizmit Evropian dhe ka luajtur rol kryesor në konstruimin e identitetit shqiptar.

(2) Gjuha si faktor të ndërtimit të identitetit

(Gjuha – komunikimi në grup = signifiant (shenjimi), ndërtimi i kombit)

Po të flitet në një mënyrë jospesifikë, lidhur me raportet midis gjuhës dhe kombit (shtetit) shpesh ndeshen dy qëndrime të kundërta: qëndrimi sipas të cilit „kombi ekziston sepse ka një gjuhë”, pra identiteti i kombit e derivohet nga gjuha, në të kundërtën e qëndrimit tjetër, sipas të cilit „kombi ekziston, pra duhet t’i krijohet një gjuhë”, që domethënë se identiteti kombëtar paraekziston, ndërsa gjuha vjen si element që e shoqëron atë (Ismajli 2005: 251).

Elementi politik dhe ideologjik është shumë i dukshëm në procesin e konstruimit të gjuhës. Ai mund të zhvillohet nga „korrigjimi” dhe standardizimi i gjuhëve letrare e kulturore, përmes formimit të gjuhëve të tilla prej tërësisë së mbivendosjes së formave dialektore, deri në ringjalljen e gjuhëve të vdekura ose pothuajse të shuara, që arrin në zbulimin e të rejave (Hobsbawm 1990: 111). Sipas

mitit nationalist gjuha është baza e vetëdijes së kombit, përderisa në aspektin tjetër mund t’i referohemi çështjes së artefaktit kulturor (Haugen 1966, 1968: 267 – 84).

Mbështetur në konstatimin e Wittgensteinit (Wittgenstein 1972: 16) se gjuha është një trashëgimi, edhe ne, në analizën tonë gjuhën do ta trajtojmë si artefakt kulturor dhe jo vetëm si formë të shprehjes apo si mjet komunikimi. Gjuha si vlerë kryesore është një njësi simbolike brenda sistemit të simboleve. Gjuha nuk është kuptuar si lëndë e hulumtimit gjuhësor, por në aspektin funksional të përafrimit (krahasojmë) me konceptin e „atdheut”, i cili, ky i fundit në vetvete përmbledh një dimension simbolik të ekzistimit të një teritori të veçantë.

Fjala shqip, që lidhet me zhvillimet të etnonimit shqiptar, me vlerë ndajfoljore, ndeshet pastaj katër herë në veprat e Budit (1618 dhe 1622), tek i cili, ashtu si te Buzuku, nuk ndeshet fare ndajfolja arbënisht. Kurse Bardhi në Fjalorin latinisht-shqip të vitit 1635 përdor vetëm ndajfoljen arbënisht. Ndajfoljen shqip e gjejmë të përdorur (dy herë) edhe në veprën e Bogdanit të vitit 1685. Por te Budi, Bardhi e Bogdani gjejmë të përdorur rregullisht (dheu) i Arbën-it dhe (gjuha) e arbëneshe.

Nga këto më herët dokumentohet fjala e parme shqip, të cilën e ndeshim një herë të vetme qysh në “Mesharin” e Gjon Buzukut (1555, faqe XXVa²): „Mbasandaj thu, prift, Pater noster, **qi vjen me thashunë shqip: Ati ynë qi je mbë qiell, u festoftë emënitë tat**”, e cila është vendosur në pjesën ku përshkruhet riti i pagëzimit (Çabej 1988: 77 kolona b).

Figura e Buzukut dhe roli i tij në ndërtimin e mitit të gjuhës ka edhe domethënie tjetër. Ai, si kronisti, të thuash dëshmitari i kohës së tij ka vërejtur një çështje të rëndësishme për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe traditën e saj duke shkruar:

U Donih Gjoni, biri hi Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se **gluha** jonëh nukë kish gjaa të endigluom ensëh shkruomit shenjtë, ensëh dashunit, sëh botësë sanëh, desha me u fëdigunëh për saa mujtah meh ditunëh, meh zditunëh pak mendetë e atyneh qi t’eh endiglonjinëh, për seh ata tëh mundëh mernëh saa hi naltë e hi mujtunë e hi përmishëriershim anshtë Zotynë atyneh qi tah duonë em gjithëh zemërë.

Në këtë rast nga fjalët e Buzukut nënkuptojmë se kishte libra të shkruara, por këto nuk ishin të kësaj natyre dhe të këtij niveli si ky i Buzukut. Veçse *Meshari* i Buzukut mbetet në analiza shkencore, sipas të dhënave të disponueshme, libri më i vjetër i botuar në gjuhën shqipe. Konstatimi i Buzukut, ku flitet për botime të tjera ka rëndësi më shumë mitike (mitologjizuese), se sa historike dhe përforcon jo vetëm mitizimin e gjuhës shqipe, por edhe rrëfimet origjinës së popullit ose ta quajmë në gjuhën nacionaliste të kombit shqiptar.

¹ Frang Bardhi 1635 fol. VIv: „Proprium Epiroticæ gentis idioma, feu Albanefia lingua à Græca, & Illyrica, seu Slaonica loquendi ratione planè diuerfa eft, licèt inter utriusq; gentis confinia veluti media confituta confpicitur (në përkthimin shqip e kemi mbështetur te Kolë Ashta, *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, bl. III, Shkodër 2000, 65).

Gjuha është një mjet komunikimi për anëtarët e një grupi të caktuar. Gjithsesi bashkë me atdheun, i cili është përcaktuar si një territor specifik, ku në të dyja aspektet gjuha zhvillohet në nivelin e saj të përdorimit utilitar dhe të funksionimit të simboleve, të cilat kanë rëndësi (Mofas 2007: 202). Pamja gjuhësore është interpretim i realitetit, përfshirë këtu edhe gjuhën me variantet e saj të ndryshme, të cilat mund të përcaktohen si përmbledhje e gjykimeve për botën. Sipas Tokarskit: „çdo gjuhë mund ta konceptualizojë realitetin e njeriut në mënyra të ndryshme, për shkak të nxitjes, lehtësisë dhe sugjerimit të interpretimit tipik të botës për një kulturë të përcaktuar” (Kawka 2000: 9-10).

Fjalori latinisht-shqip (1635) i Frang Bardhit përveç parathënies, në të cilën shtjellon qëllimin e botimit – për ruajtjen e gjuhës shqipe nga asimilimi dhe për mësimin e shqipes nga klerikët e huaj: „Tue pasunë ditë e përditë, të dashunitë e mij, mbassi hina ndë Kolehë, kujtuem me qish copë librë keshë me ndihmuem mbënjaanë **gjuhënë tanë**, qi po bdaretë e po bastardhohetë saa maa parë të ve”, letrave dhe vjershave përshëndetëse, të cilat vijnë menjëherë pas parathënies, fjalori dygjuhësor me radhitje fjalësh sipas latinishtes ka rëndësi të madhe edhe për pjesën e dytë, shtojcën, në të cilën jepen shënimet e para gramatikore të shqipes dhe regjistrimet e para të letërsisë gojore shqiptare (Neziri 1997: 137).

Bogdanit iu desh të bëjë një përpjekje të re, për ta bërë shqipen një gjuhë më të zhvilluar kulture. Ai, me ndërgjegje përpiket që gjuha e tij të tingëllojë bukur si gjuha e punuar italishte: „dëshirova mirëfilli qish po flasëmë italianisht, bukurë të kumbon e të kallëzon arbënisht” (Shuteriqi 1969: 23).

Me frujt të shpirtit vet ende të popullit, të mos lane dijenë e **gjuhën’e** dheut me u dvarunë.

Ky zot fort i urtë më dha fort zemërë me votë paret ndë këtë vepërë, ende tue më ndihmuem pa kuer fort ndë shumë **fjalë t’arbënesha**, të siatë i kish udob e për duer, tue pasunë bamë-ende aj **nji gramatikë fort të godiçime latin e shqip** (Pjetër Bogdani, Të primitë përpara letërarit, Parathania e Çetës së profetëve, 1685).

Kështu Auerbachu (Auerbach 1968, v. II, 67-68), në mënyrë të shkëlqyer e përshkruan ndikimin e Humanizmit mbi ndërtimin e identitetit në momentin kur nis zanafilla e humanizmit në vetëdijen shoqërore. Në këtë kohë është përhapur edhe ideja e mitologjisë dhe e historisë antike, bashkë me predikimet biblike, të cilat ishin kufizuar gjatë asaj kohe jo vetëm nga shkaku i kohës së shkuar, por edhe nga shkaku i kushteve të ndryshme jetësore. Humanizmi traditën antike e ka parë si korrigjim të historisë në perspektivën kohore. Zhvillimi i ashtuquajtur histori krahasimtare ka bërë që më vonë krijimi i konceptit të „modernizmit” të bjerë në kundërshtim me traditën e „antikitetit”.

(3) Sakralizimi i gjuhës shqipe = i atdheut

Epoka e Humanizmit dhe Barokut ka sjellë interesimin mbi gjuhët kombëtare dhe shkrimet e para në gjuhë të ndryshme, të cilat kanë theksuar kërkimin e identiteteve dhe ndërtimin e traditave të ndryshme. Megjithatë ndikimi i traditave universale: *Latinitas* dhe *Ortodoxa* akoma ka qenë shumë i fortë. Me saktësi këtu mund t’i kërkojmë burimet e mitit të gjuhës. Këto dy periudha kanë rëndësi të madhe në ndërtimin e traditave kombëtare, aty ku gjuha, sidomos në shembullin shqiptar ka luajtur një rol parësor. Kjo është koha e Humanizmit me shkrimet e para në gjuhën shqipe dhe kërkimet mbi vendin e gjuhës kombëtare në traditën universale. Pastaj koha e Rilindjes Kombëtare, e cila ka pasur mendime të vetëdijshme mbi çështjen e identitetit me anë të gjuhës si dalluese kryesore në ndërtimin e tij.

Në lavdin drejtuar Zotit (kënga e 16 – të) për ta falur, në Pjetër Budi ka bërë mëkate pse ka shkruar shqip, i lutet t’i japë fuqi, ta ndihmojë, ta miratojë e ta përkrahë idenë e tij për ta thënë veprën e Kreatorit në gjuhën kombëtare:

Shqip të mundem me rrëfyem

Ndonjë kankë të re,

Qi mbë qiellt t’ish pëlqyem

Përpara ty ke je.

(Budi, Poezi, Prishtinë, 2006: 245).

Në këtë këngë dhe në tri këngët në vijim tregohet se ngjarjet e rrëfyera janë strukturuar si përjetim i brendshëm. Budi ngjarjet e rrëfyera të së kaluarës së largët i sjell në bashkëkohësi dhe në Atdhe. Në rrëfimin e kësaj kënge, në mënyrë të drejtpërdrejtë, inkadrohet vetë Budi, i cili duke u ankuar për fatin e vet e të bashkatdhetarëve shpaloj ndjenjën e dashurisë së tij kombëtare. Tema e krijimit të njeriut, e inferiorit të tij ndaj Zotit e nisur në *këngën e parë e të dytë*, fiton funksionalitet praktik me vendosjen, në këtë këngë, të narratorit përballë krijuesit. Vendosja paralele e dy qenieve dhe sjellja pranë e pranë, por në proporcion të kundërt: njëri në shkallën e krijuesit e tjetri në shkallën e të krijuarit, bëhet për ta ndërlidhur narracionin e veprës nga fillimi deri në fund dhe për ta funksionalizuar ndërlidhjen e njëanshme të këtyre dy qenieve. Duke u zhvendosur veprimin nga historia biblike në realitetin shqiptar, Budi i kthehet modelit të veprave të ngjashme të kohës, të Barokut religjioz, në të cilat konkretizimi historik bëhet me aktualizimin bashkëkohor, sidomos bashkëkombëtar (Neziri 1995: 69-70).

Vjershërimi mbyllet me lutjen drejtuar Zotit (kënga e 19 – të) ta ndejë për mëkatet e bëra e ta bekojë për veprën që ka bërë për Arbërinë.

Me këto vargje lokalizohet përkatësia kombëtare dhe vendosja hapësinore e rrëfimit. Ato janë ndërfutur për ta shprehur shqetësimin për bashkëkombasit se të dhënë pas jetës fizike, harrojnë jetën qiellore dhe nuk bejnë kurrfarë përpjekjesh për ta fituar atë.

Ky shqetësim i Budit është një argument historik i depërtimit, në mënyra të ndryshme, të kulturës së re: islame. Kështu, rrëfimtari i veprës së tij, nga një

poet i shqetësuar dhe i angazhuar i Përtëritjes për fatin e Krishterimit papnor, që është dukuri dhe kërkesë e përgjithshme e kohës, kthehet në një rrefimtar, poet i krishterë shqiptar, i shqetësuar dhe i angazhuar për fatin e kombit (Neziri 1995: 72).

Nga ana tjetër për herë të parë në traditën Pararilindjes Kombëtare, brenda kulturës shqiptare hasim traditën tjetër. Kjo është trashëgimia myslimane, prej të cilës kaq shumë u frikësua Budi. Me shkrime të tij në alfabetin arab, me dashurinë mbi gjuhën dhe vendin Ibrahim Nezimi e nis këtë traditë të re. Ai ka krijuar një mit të vetin, duke shtuar se ishte i pari që shkruante shqip. Përpara tij, thotë ai, shqipja paska qenë një gjuhë e lënë pasdore, e bërë „harap“, e dëmtuar. Vetë Nezimi shprehet:

Divan kush pat folurë shqip?

Ajan e bëri Nezimi, (e nxorri në shesh)!

Bejan kush pat folurë shqip? (poezi),

Insan e bëri Nezimi! (për të qenë)

Sakralizimi i gjuhës i cili nga perspektiva e tashme mund të konsiderohet si paralajmërim i kohës vijuese (Rilindja Kombëtare) u krijua në poezinë e Jul Varibobës te vepra *Gjella e Shën Mërisë Virgjër* (1762). Këtu nga veprimtaria fetare letërsia shqipe del në një epokë të re, e cila i ishte dedikuar mendimeve politike dhe kombëtare. Variboba jo vetëm këndoi dhe u frymëzua në gjuhën shqipe, por duke shkruar në këtë gjuhë nxitohet të theksojë se është shumë e ngritur: „Esht **gjuha arbërisht** aqë fruskulorea (pastër), aqë çiota, aqë e përbëtaljëmea saa me të duket se jo jatër fjalë mund thuhet, mose

Bibliografia

ANDERSON, Benedict (1997), *Wspólnoty wyobrażone. Rozważania o źródłach i rozprzestrzenianiu się nacjonalizmu*, Kraków.

AUERBACH, Erich (1968), *Mimesis, vëll. II*, Warszawa.

BOGDANI, Pjetër (1990), Të primitë përpara letërsisë, Parathania e Çetës së profetëve, 1685: *Jeta e profetëve 1*, Rilindja, Prishtinë.

BORDIEU, Pierre (1975), *Language and Symbolic Power*, Harvard University Press.

ÇABEJ, Eqrem (1988), *Meshari i Gjon Buzukut 2*, Rilindja, Prishtinë.

ÇABEJ, Eqrem (1976), *Studime Gjuhësore, vëll. III*, Prishtinë.

DEMIRAJ, Shaban (1988), *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë.

HAUGEN, Einar (1966), *Language Conflict and Language Planning: The Case of Modern Norwegian*, Harvard University Press.

HERDER, Johann Gottfried (2013), *Ideen zur Philosophie der Geschichte der Menschheit*, Berlin.

HOBBSAWM, Eric (1990), *Nations and Nationalism Since 1780: Programme, Myth, Reality*, Cambridge University Press.

ISMAJLI, Rexhep (2005), *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Tiranë.

KAWKA, Maciej (2000), Językowy obraz Macedończyka w najnowszej: „Historii narodu macedońskiego”: *Tożsamość narodowa w społeczeństwie multietnicznym Macedonii*, Kraków.

KOLSTØ, Pål (2005), Assessing the role of historical myths in modern society: *Myths and Boundaries in South-Eastern Europe*, ed. Pål Kolstø, London.

MALINOWSKI, Bronislaw (1996), *Myth in Primitive Psychology*, ribotuar: Robert A. Segal, *Theories of Myths*, New York, vëllim 2.

MITKO, Thimi (1981), *Vepra*, përgatitur nga Qemal Haxhihasani, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

MOLAS, Jerzy (2007), Language and territory as core values in serbian, croatian and bosnian tradition: *Sprawy Narodowościowe. Terytorializm i Tożsamość. Bałkany słowiańskie i niesłowiańskie*, Seria nowa, r. 2007, z. 31, ed. Jolanta Sujecka, Poznań – Warszawa.

NEZIRI, Zeqirja (1997), *Historia e letërsisë shqiptare I*, Shkup.

mallkime, nëm', të shara o veramente për turp" (Jul Variboba, Oj e ndeermja rexhin, 1762). Ai, gjithashtu personifikoi figurën e Shën Mërisë me nënën arbëreshe. Me këtë akt artistik mund të arrijmë në përfundim se me këtë poezi autori iu afrua konceptit kombëtar, duke e harruar epokën e mëparshme. Këtu kemi të bëjmë me dy koncepte: sakralizimin e gjuhës shqipe si gjuhë e dedikuar Zotit, si gjuhë e shënjtë që u kanonizua në përdorimin fetar dhe në personifikimin e Atdheut me figurën e Shën Mërisë.

Përfundim

Do të përfundojmë me fjalët e Andersonit se gjuhët e shkruara kanë ndihmuar në ngritjen e ndërgjegjes dhe krijimin e vetëdijes kombëtare në tre nivele:

(a) *Së pari* e kanë formuar fushën e komunikimit midis latinishtes dhe gjuhëve të folura amtare. Folësit të cilët nuk kishin mundësi komunikimi në gjuhën e tyre kombëtare mund ta gjenin kuptimin përmes shtypit dhe letrës. Kjo i ka bindur se ka miliona përdorues të së njëjtës gjuhë dhe se të gjithë i përkasin një hapësire gjuhësore. Këta folës kanë krijuar bërthamën e bashkësisë kombëtare, si një bërthamë e imagjinuar dhe një padukshmëri e dukshme.

(b) *Së dyti* shtypi e ka thelluar njohjen e gjuhëve dhe ka zhvilluar vizionin e lashtësisë që ka qenë me shumë rëndësi për idenë subjektive kombëtare.

(c) *Së treti* ka krijuar një gjuhë të pushtetit, e cila është dalluar prej gjuhëve të vjetra të administratës (Anderson 1997: 54-55).

NEZIRI, Zeqirja (1995), *Poezia e Budit 1*, Ekoritmi, Shkup.
PUNTSCHER, Riekmann, Sonja (1997), *The Myth of European Unity: Myths and Nationhood*, ed. Geoffrey Hosking, George Schöpflin, London.
SINANI, Shaban (2011), *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Tiranë.
SMITH, Anthony D. (2007), *Nacjonalizm. Teoria, ideologia, historia*, Warszawa.
SCHWANDER-SIEVERS, Stephanie, FISCHER, Bernard J. (ed.) (2002), *Albanian identities. Myth and history*, ed., Indiana University Press.

NDIKIMI I MUZIKËS BLUZ NË PROZËN E ELIS UOKERIT THE IMPACT OF BLUES ON ALICE WALKER'S FICTION

ENTE LA BILALI

Universiteti "Luigj Gurakuqi",
Shkodër, SHQIPËRI

Email: entelabilali@yahoo.com

Përmbledhje

Kritikë të shumtë kanë theksuar rëndësinë e lidhjes midis letërsisë dhe muzikës afro-amerikane. Shkrimtarët afro-amerikanë, të vetëdijshëm për rëndësinë e trashëgimisë kulturore që mbart muzika bluz, shpesh përfshinin në veprat e tyre elemente të bluzit. Një shkrimtare e tillë është Elis Uokeri. Qëllimi i punimit është të analizojë lidhjen midis bluzit dhe prozës së Uokerit dhe të nxjerrë në pah se si Uokeri përdor karakteristikat, gjuhën, strukturën dhe pikëvështrimin e bluzit për të artikuluar kompleksitetin e përvojave të grave zeza në Amerikë. Analiza është mbështetur në studime kritike-letrare të mëparshme të veprës së Uokerit si dhe në studime kritike të muzikës afro-amerikane. Përdoret qasja përshkruese dhe krahasuese. Improvizimi, përsëritja dhe ndryshimi ishin karakteristika të bluzit që gjetën shprehje edhe në prozën e Uokerit. Uokeri na paraqet vitalitetin, kreativitetin dhe spiritualitetin e grave afro-amerikane dhe analizon faktorët që kanë qenë vendimtarë për mbijetesën e tyre në një shoqëri patriarkale dhe raciste.

Fjalët çelës: bluzi, letërsia afro-amerikane, përvoja femërore, improvizimi.

Summary

African American writers have often drawn on the heritage of blues, transforming music into the written word. In the literary world, the blues has long been a topic of interest because it is considered an important influence on the writers of the Harlem Renaissance. Both blues and literature challenge the audience to consider everyday life as an improvisational challenge. The aim of this paper is to analyze the link between blues and Alice Walker's fiction. Walker uses the characteristics, language and structure of blues to point out the complexity of African-American women's experiences. Research for this paper is based on literary criticism on Walker's fiction. Theoretical studies of blues have also been used as sources for analysis throughout the paper. Walker exposes the vitality, creativity and spirituality of African-American women and highlights those factors which have helped them survive in a patriarchal and racist society.

Key words: blues, African-American literature, women's experiences, improvisation.

Hyrje

Shkrimtarët afro-amerikanë femra, të vetëdijshme për rëndësinë e trashëgimisë kulturore që mbart muzika bluz, shpesh përfshinin në veprat e tyre tekstet dhe ritmet e bluzit. Për më tepër, portrete të këngëtareve bluz hasen në shumë prej veprave të shkrimtareve afro-amerikanë si: Toni Keid Bambara, Geil Xhons, Shërli En Uilliams, Zora Nil Hërstën, Toni Morison dhe Elis Uoker. Duke cituar studiuesen Dafne Djuval Herison, Anxhela Deivis (13) na jep një listë me temat më të zakonshme në tekstet e këngëtareve bluz si: braktisja, tradhëtia, largimi, padrejtësitë, homoseksualiteti, varfëria, keqtrajtimi, zhgënjimi, e mbinatyrshtimja, hakmarrja. Pavarësisht se tema e dhunës së burrave ndaj grave të tyre është e përsëritur, testet bluz flasin për gra të cilat nuk hezitojnë që t'i përgjigjen dhunës me të njëjtën egërsi.

Siç thekson Hjuston A. Beikër (Baker 1987: 3), bluzi duhet të perceptohet si një rrjet dhe ky rrjet "është një pikë inputi dhe outputi pafund, rrjet impulsesh që ndërpriten, që kryqëzohen deri në atë pikë sa të

përbëjnë tekstin e shumëfishtë në të cilin është shkruar ligjërimi afro-amerikan. Pra tekstet e shkruara dhe ato gojore, letërsia dhe këngët ndërpresin njëri-tjetrin dhe ndikojnë tek njëri-tjetri. Këngët bluz kanë një element folklorik që ndërthuret me tregimet gojore dhe letrat dhe pavarësisht nga forma, secila prej tyre paraqet përvojat e përbashkëta të grave afro-amerikane. E shkuara dhe e tashmja shkrihen për të formuar një përvojë të përbashkët. Këngët e tekstet këndohen e shkruhen, dëgjohen dhe lexohen nga një komunitet grash që me zërat e tyre kontribuojnë për formimin e përvojës jetësore të grave afro-amerikane.

Mund të themi se këngët bluz të këngëtareve femra sfidonin bindjet ekzistuese të kohës për një inferioritet gjinor të femrave. Duke shprehur pikëpamjet e tyre të ndryshme në lidhje me politikat seksuale, këngëtarët e bluzit ripërcaktuan dhe riafirmuan identitetin e gruas afro-amerikane. Siç shprehet Anxhela Deivis (Davis 1999: 41), tekstet bluz "krijuan imazhe të grave të forta e të pavarura të cilat nuk kishin frikë të mbronin të

drejtën e tyre për t'u trajtuar si qenie njerëzore të pavarura". Gradualisht përvojat e grave afro-amerikane të pasqyruara në këngët bluz gjetën shprehje edhe në forma të tjera të artit siç është letërsia.

Shug Eivëri si mishëruese e shpirtit bluz

Temat e sipërpërmendura të pranishme në tekstet e Besi Smithit përshkrijnë edhe romanet e Uokerit. Shumë shkrimtare afro-amerikane i mvëshën personazheve të tyre femra tiparet dhe përvojat e këngëtareve bluz. Një ndikim të tillë e gjejmë edhe në krijimtarinë e Elis Uokerit e cila kur flet për muzikën afro-amerikane shprehet se: "Muzika është arti të cilin e kam më shumë zili...artistët janë njësh me nënvetëdijen e tyre historike dhe kulturore. Unë po përiqem të mbërrij tek ai vend ku është tashmë muzika e zezakëve; të mbërrij tek ajo ndjenjë e pavetëdijshme e të qenit njësh me bashkësinë; tek ajo natyrshmëri; tek ajo hijeshi (edhe kur është e përvuajtur)" (Walker 1983: 259). Maria Xhonson (Johnson, 1996) pohon se romani i Zora Nil Hërstënit "Sytë e tyre po shihnin Zotin" (Their Eyes Were Watching God, 1937) dhe muzika bluz e këngëtareve si Besi Smith dhe Billi Hollidei kanë pasur një ndikim të madh në veprën e Elis Uokerit. Zora Nil Hërstën, Besi Smith dhe Billi Hollidei formojnë një treshe të shenjtë. Ato ndoqën rrugën e tyre, besonin në zotat e tyre, ndoqën ëndrrat e tyre dhe nuk pranuan të veçohen nga njerëzit "e zakonshëm" (Walker 1983: 91). Xhonson vë në dukje dinamikat që kanë të përbashkëta vepra e Uokerit dhe tekstet e bluzit duke u përqendruar kryesisht tek romani "Ngjyra e purpurt" (The Color Purple, 1982), ku Uokeri "flet" me muzikantët e bluzit dhe me shkrimtarët e tjerë sipas stilit që përdor Zora Nil Hërstëni në romanin e saj "Sytë e tyre po shihnin Zotin". Sipas Henri Luis Geitsit (Gates 1988: xxii-xxiii, xxvii), "Uokeri e përsërit duke e ndryshuar" materialin tradicional, duke e përpunuar dhe personalizuar atë, duke i dhënë "një përgjigje të re një përshkrimi tradicional të një situatë tradicionale".

Ajo [Shugu] e transformon jetën e Silit, protagonistes së romanit, përmes një shndërrimi si ai i tipit të përfaqësuar nga Besi Smithi në këngën "Duke predikuar bluzin". Shugu, ashtu si Besi Smithi, krijon një lidhje të ngushtë me dëgjuesit e saj dhe i jep zë "shpirtit të bluzit" në mënyrë që t'i sjellë lehtësim të përvuajturve që kanë më pak aftësi shprehëse. Por më e rëndësishmja është se ajo e nxit Silin dhe gratë e tjera të abuzuara në roman që të shprehin vetveten dhe të mbrojnë të drejtat e tyre.

Maria Xhonson diskuton gjithashtu mbi rëndësinë e Shugut në roman si personifikim i bluzit femëror duke theksuar se ajo nxit ndërgjegjësimin seksual të

Silit. Xhonson i sheh Shugun dhe Besi Smithin si katalizatorë që ndërmjetësojnë kufijtë e laikes dhe fetares. Ajo shprehet se "Gruaja bluz, kënga e të cilës i ka rrënjët në vlerat dhe bindjet e bashkësisë, i jep forcë atyre që e duan dhe sjell ndryshim tek ata që e rrethojnë (Johnson 1996: 222). Ndërsa Çeril Uoll e sheh personazhin e Shugut si të ndikuar nga bashkësia e grave bluz të viteve '20. Uoll (Wall, 2005: 149) shprehet se: "Shugu nxit shndërrimin e Silit dhe të Albertit sepse ajo është faktor moral i romanit, edhe pse, nëse gjykohet sipas standardeve tradicionale, Shugu është tërësisht imorale (siç ishin Besi Smith, Ida Koks, Ma Rajni dhe të tjera)". Në studimin e tyre për gratë bluz Anxhela Deivis dhe Heizel Karbi e përmendin Shugun si një arketip letrar të këtyre këngëtareve. Ma Rajni dhe Besi Smith, ashtu si Shugu, e shprehin seksualitetin e tyre në mënyrë të dukshme përmes stilit të tyre personal dhe përmes këngëve që pasqyrojnë përvojat e grave zezake në Jug.

Uokeri fillon të analizojë ndikimin që ka këngëtarja bluz dhe muzika që ajo bën tek artistë si vetë Uokeri, tek të tjerët në shoqëri dhe tek komuniteti në tërësi. Një analizë e tillë vazhdon tek romani "Ngjyra e purpurt" ku Uokeri e shqyrton më në detaje rolin e këngëtares bluz si katalizator ndryshimi në shoqëri. Këngëtarja e bluzit kënga e të cilës pasqyron vlerat dhe idetë e bashkësisë i ndryshon ato që ka përreth. Përpjekjet e saj të jashtme dhe konfliktet e saj të brendshme pasqyrojnë vlerat që bashkësia i ka bërë të vetat. Dafne Djuval Herison shpjegon se gratë zezake kishin shumë arsye për të kënduar bluz:

Jeta për gratë zezake të klasës punëtore kishte qenë shumë e vështirë për shkak të statusit të tyre të ulët si pasojë e seksizmit dhe racizmit.... Përpjekja e grave zezake për pavarësi është e kufizuar nga pengesa raciale dhe seksuale dhe nganjëherë çon në sjellje që duket arrogante, e shturur ose e dhunshme, por që në fakt është shfaqje e një tërësie mekanizmash mbrojtës të përdorur për të fituar respekt në një mjedis armiqësor... (Harrison 1988: 6)

Uokeri vë theksin tek muzika bluz origjinale duke lartësuar vitalitetin, ekspresivitetin dhe shpirtin e paepur krijues të artistes bluz. Ashtu si edhe Hërstëni në romanin "Sytë e tyre po shihnin Zotin", Uokeri përdor karakteristikat, gjuhën, strukturën dhe pikëvështrimin e bluzit për të himnizuar jetën dhe veprën e këngëtareve bluz, për të artikuluar kompleksitetin e përpjekjeve të tyre dhe për të vënë në dukje faktorët shtypës që ndikojnë në jetën e grave zezake në Amerikë. Uokeri na paraqet vitalitetin, aftësinë ripërtëritëse, kreativitetin dhe spiritualitetin e grave afro-amerikane duke hedhur dritë mbi ato faktorë që kanë qenë vendimtarë për

mbijetesën e tyre në një shoqëri shfrytëzuese dhe abuzuese ndaj grave në përgjithësi dhe ndaj atyre afro-amerikane në veçanti.

Tomas Marvin është i mendimit se shumë prej kritikëve janë përqëndruar në procesin transformues të Silit dhe në rolin e Shug Eivërit si katalizator. Ata kritikë të cilët e konsiderojnë romanin si “një përrallë” e përshkruajnë Shug Eivërin si një zanë që vjen e maskuar si “shtrigë” (Walsh, 1987: 94). Të tjerë përpiqen ta klasifikojnë romanin si realist. Sipas Marvin, secili prej këtyre interpretimeve që thekson formën europiane të romanit, largon vëmendjen nga përmbajtja e tij afro-amerikane. Në kritikën e tij ndaj qasjeve të cilat anashkalojnë përmbajtjen afro-amerikane të romanit Tomas Marvin shprehet se:

Disa kritikë psikoanalitike e shohin Shugun si “zëvendësuese të nënës” për Silin (Proudfit 24), dhe të tjerë si “shembull e katalizator”. Edhe pse secila nga këto qasje hedh dritë mbi aspekte të rëndësishme të rolit të Shugut në roman, asnjëra prej tyre nuk merr në konsideratë origjinën afrikane të teologjisë së Shug Eivërit. Të dyja, Besi Smith dhe Shug Eivëri mund të konsiderohen “fëmijë” të Legbas, një shpirt afrikan që është i lidhur ngushtë me muzikantët dhe hap dyert drejt botës shpirtërore dhe siguron mundësi për rritjen psikologjike dhe shoqërore të individëve. (Marvin 1994: 420)

Ashtu si Besi Smith, këngëtarja e bluzit, Shug Eivëri, përmes forcës së personalitetit të saj e transformon rrënjësisht jetën e Silit. Siç thekson edhe Marvin, edhe përshkrimi i Shugut shpesh sjell në mend imazhin e Besi Smithit. Sili e përshkruan kështu: "Shug Eivëri ishte një grua. Gruaja më e bukur që kam parë ndonjëherë. Më e bukur se nëna ime. Rreth dhjetë mijë herë më e pashme se unë. E shoh atë me gëzof. Fytyra e saj e kuqe. Flokët e saj si bisht. Ajo qesh me këmbën e vënë në motorçikletën e dikujt. Megjithatë sytë seriozë. Të trishtuar." (Walker 1982: 8) Sili shprehet se është fotoja e parë e një “njeriu të vërtetë” që ka parë ndonjëherë. Megjithëse të dyja duket se jetojnë në botë të ndryshme, shprehja e melankolisë në sytë e Shug Eivërit i bashkon ato dhe i jep Silit forcën që të durojë e më pas edhe të reagojë kur burrat e trajtojnë si kafshë. “Unë nxjerr foton e Shug Eivërit. Shoh sytë e saj. Ata thonë 'Po kështu ka ndodhur nganjëherë.'" (Walker 1982: 8)

Si mishëruese e shpirtit të bluzit, Shugu e nxit Silin që të njohë vlerën e përvojave që e kanë formuar atë, që të çlirojë veten nga ata që e kanë shtypur dhe të kuptojë vlerën e saj si individ. Këto bindje Shugu i përforcon duke kompozuar e kënduar në publik një këngë për Silin. Kënga (një nga shumë pasqyra, metaforike dhe jo metaforike në roman), ashtu si pasqyra të cilën Shugu ia jep për të

eksploruar për herë të parë trupin e saj, gradualisht krijon tek Sili një sens të fortë të individualitetit. “Hera e parë që dikush bën diçka dhe i vë emrin tim,” shprehet Sili me habi (Walker 1982: 65). Keit Bajërmen (Byerman 1986: 65) sugjeron që kombinimi i këngës dhe seksualitetit të Shugut nënkupton për Silin mundësinë e kreativitetit në një kontekst tjetër, të ndryshëm nga ai i riprodhimit. Në lidhjet me Silin, Sofian dhe Skuikun, Shugu bëhet një nga këto gra bluz e cila flet në emër të grave të tjera zezake. Shugu ndryshon jetën e Silit duke nxitur krijimin e qëndrimeve pozitive ndaj seksit, racës dhe fesë. Dashuria e Shugut për këngën e kërcimin, sjellja e saj e guximshme, dashuria e saj për burrat e gratë janë në përputhje të plotë me përkufizimin që jep Uokeri për graristen. Duke e shkrirë bluzin e Shugut me ideologjinë e grarizmit Uokeri krijon një figurë grariste bluz dhe një bashkësi zezake pa kufizime seksiste, raciste dhe fetare. Sofia e cila gjithashtu mishëron shpirtin e bluzit është shembull i rezistencës dhe forcës shpirtërore për Silin. Nga Shugu dhe Sofia, Sili merr dy parimet bazë të bluzit - “agoninë e jetës, edhe mundësinë për ta kapërcyer këtë agoni përmes forcës së shpirtit” (Ellison 1963: 94). Besimi utopik që karakterizon strofat e fundit të teksteve bluz e zbut atmosferën e trishtë të këtyre këngëve dhe të njëjtën gjë shohim edhe në fundin e lumtur për të cilin janë kritikuar shpesh romanet e Uokerit. Në fund të romanit Uokeri e quan veten jo vetëm autore, por edhe “mjet” për personazhet e saj. Si mjet, Uokeri i bën personazhet e saj të ngjashme me këngëtarët bluz Besi Smith e Ma Rejni. Uokeri e shtrin mesazhin e bluzit edhe tek dhuna e personazheve të saj gra që përfaqëson dhunën e të gjitha grave në Jugun racist e seksit.

Konkluzione

Me natyrën e tij revolucionare, shkrirjen e fantazisë me dëshirën, bluzi krijon nevojën e madhe për liri. Lorens Levin (Levine 1977: 270) e përshkruan bluzin si një “muzikë e cila ngul këmbë tek kuptimi i jetës së zezakëve”. Lindja e bluzit ishte provë estetike e një realiteti të ri psiko-social në bashkësinë zezake” që gjeti shprehje edhe në letërsi. Për Levin rëndësia që mori bluzi në shekullin e 20të në kulturën afro-amerikane kishte të bënte me faktin që i jepte vlerë jetës së brendshme të individëve të zhvlerësuar: bluzi këmbëngul se fati i individit burrë apo grua zezake, ajo që ndodhte në jetën e tyre të përditshme, problemet, zhgënjimet, ëndrrat e tyre ishin të rëndësishme për t’u shënuar në këngë. Të njëjtën ide gjejmë edhe në romanet e Uokerit ku artikullohet një vlerësim i ri i ndjenjave dhe nevojave të gruas afro-amerikane si individ. Shembull i kësaj është Shug Eivëri e cila me

personalitetin e saj të fortë dhe të pavarur është një sintezë e shpirtit gararist dhe atij bluz.

Bibliografi

- BAKER, Houston (1987). *Blues, Ideology, and African-American Literature: A Vernacular Theory*. Chicago: University of Chicago Press.
- BYERMAN, Keith (1986). *Fingering the Jagged Grain: Tradition and Form in Recent Black Fiction*. Athens: U of Georgia P.
- DAVIS, Angela Yvonne. (1999). *Blues Legacies and Black Feminism: Gertrude "Ma" Rainey, Bessie Smith and Billie Holiday*. New York: Pantheon Books.
- ELLISON, Ralph. (1963-1964), "The World and the Jug." *Call and Response: Key Debates in African American Studies*.
- GATES, Henry Louis (1988), Jr. *The Signifying Monkey: A Theory of Afro-American Literary Criticism*. New York: Oxford UP.
- HARRISON, Daphne Duval. *Black Pearls (1988): Blues Queens of the 1920s*. New Brunswick: Rutgers UP.
- JOHNSON, Maria V. (1996). "'You Just Can't Keep a Good Woman Down': Alice Walker Sings the Blues". *African American Review* 30:2 (Summer 1996).
- LEVINE, Lawrence. (1977), W. *Black Culture and Black Consciousness: Afro-American Folk Thought From Slavery to Freedom*. New York: Oxford.
- MARVIN, Thomas F. (1994). "'Preachin' the Blues': Bessie Smith's Secular Religion and Alice Walker's *The Colour Purple*". *African American Review* 28:3 (Autumn 1994).
- WALKER, Alice. (1983). *In Search of Our Mothers' Gardens: Womanist Prose*. New York: Harcourt Brace Jovanovich.
- WALKER, Alice (1982). *The Color Purple*. New York: Pocket Books.
- WALL, Cheryl (1995). *Women of the Harlem Renaissance*. Bloomington: Indiana U P.
- WILLIAMS, Sherley Anne (2000). "Some Implications of Womanist Theory." *African American Literary Theory: A Reader*. Ed. Napier, Winston. New York: New York UP, Print.

**NJË RILEXIM I “PASQYRAVE TË NARÇIZIT” TË E. KOLIQIT
REREADING OF “PASQYRAT E NARÇIZIT” (“NARCIS’S MIRRORS”) OF E. KOLIQI**

MIRLINDA KRIFCA BEQIRI

Univesrsiteti Sh. Cirili dhe Metodi
Fakulteti i Filologjisë “Blazhe Koneski”

Shkup, Maqedoni

Përmbledhje

Punimi, duke u mbështetur në studimet nga fusha e imagologjisë, mëton të paraqesë një lexim ndryshe të kryeveprës së Ernest Koliqit, duke u ndalur në raportin e veprës me hipotekstin e saj mitologjik si dhe në dialogun mes *Vetes* dhe *Tjetrit* brenda vetes në këtë margaritar të letërsisë sonë, duke u munduar t’i shfrytëzojmë përparësitë që ofron teoria e Zhak Lakanit. Përfundimi te i cili arrihet në këtë studim është se në këtë vepër vjen në shprehje fenomeni i ndarjes, dyzimit të personalitetit me qëllim të bashkimit të sërishëm, bashkim ky gjatë të cilit vjen deri te bashkimi midis Unë dhe Ne, pra një simbiozë mes identitetit personal dhe kombëtar, duke arritur në këtë mënyrë atë që gjakohet – vetëzbulimin dhe vetënjohjen, si dhe identifikimin dhe sakrificimin e krijuesit për veprën, kreacionin.

Fjlë çelës: imagologjia, vetja, tjetri, komunikim, ego, alter ego.

Abstract

The work, based upon studies from the field of imagology, tents to present an alternaive way of reading Koliqi’s masterpiece, by remaining in the relation of the work with its mythological hypotext as well as in the dialogue between Myself and the Other one inside me of this jewel of our literature, by trying to use the advantages offered by the theory of Jacques Lacan. The conclusion to which we arrive study is that in this work is expressed the division phenomena, duality of the personality in order to be reunited, during which unity is achievend unification of Me and We, i.e. symbiosis between the personal and national identity, by achieving this way the one that is strivind – self as well as identification and sacrificing of the author for the work, its creation.

Key words: imagology, self, the ather, ego, alter ego.

Hyrje

Kryevepra e Koliqit *“Pasqyrat e Narçizit”* që, siç shprehet vetë autori, paraqet *“biografi poetike”*, është një vepër që i takon një zhanri kufitar që gjendet mes poezisë dhe prozës dhe është shkruar nën ndikimin e poetikës së simbolizmit. Ajo paraqet veprën e parë me proza poetike të Koliqit, por jo dhe të fundit e as të parën në letërsinë shqipe në përgjithësi.

Vepër që tejkalon kornizat e letërsisë shqiptare të kohës

“Pasqyrat e Narçizit” paraqet një vepër të veçantë të Koliqit, që shënon një kthesë të rëndësishme në letërsinë shqiptare të kohës. Derisa me *“Hijen e maleve”* dhe *“Tregtar flamujsh”*, Koliqi nuk arrin të shkëputet nga tradicionalja, me këtë vepër ai bën një kthesë të madhe. Vepra paraqet kulmin letrar të Koliqit dhe të kohës kur u shkrua. Bëhet fjalë për një vepër që dallon nga veprat që shkruheshin në atë kohë. Vepra nuk ka ndonjë ngjarje konkrete, në kuptimin tradicional të fjalës.

Pozicionin e ndërmjetëm të veprës së Koliqit, mes traditës e modernes e kanë vrojtuar studiuesit e saj, që janë shprehur se në veprën në fjalë: *“... në rastin e kërkimit mes traditës dhe novatores, tregimi psikospektiv është ai që nxjerr kryet. Nga njëra anë, si i pari eksperimentim i tillë në prozën*

tonë, dhe nga ana tjetër, për periudhën kur u shkrua, si një tregim që përfshihet në një rrymë të njohur narrative në letërsinë evropiane” (Plasari 1991: 102).

Vepra mbështetet në një mit të njohur, siç është miti i Narcizit, me të cilin vendos një dialog të veçantë letrar. E kemi te njohur faktin se thelbin e mitit antik të Narcizit e përbën tema e mohimit, gjegjësisht refuzimit të dashurisë së të tjerëve duke preferuar dashurinë ndaj vetvetes, dashuri kjo që çon deri në asgjësim.

Në dy versionet e veprës në fjalë, gjegjësisht në proza të caktuara të saj, autori më shumë afrohet apo largohet nga miti fillestar, duke u mundur që prej tij të thithë vetëm atë dhe vetëm atë sa i duhet për krijimin e tij. Titulli i veprës, si element i paratekstut (Genette, *Paratexts* 1997), pos mitin antik mbi Narcizin, na kujton edhe teorinë e Frojdit, ku konceptit të narcizmit i kushtohet mjaft kujdes. Koliqi e shfrytëzon mitin e Narcizit, të cilin e kanë shfrytëzuar në forma dhe mënyra të ndryshme autorë nga mbarë bota. Vepra paraqet gjakimin për të gjetur identitetin, sa individual atë edhe kombëtar.

Zëri i narratorit në shërbim të vetënjohjes

Vepra përbëhet prej shtatë pjesëve, që paraqiten si: *“variante të vetënjohjes së autorit para procesit të krijimit dhe gjatë këtij procesi”* (Hamiti 2003: 453). Në të paraqitet një shëtitje e imagjinuar e autorit në atdheun e tij dhe jashtë tij.

Vepra njihet dy botime. Botimi i parë i saj (për të cilin vetë autori shprehet se është i vitit 1936) dihet se i takon vitit 1934 (botuar në *“Gazetën Shqiptare”* të Barit të Italisë), kurse botimi i dytë, i realizuar po ashtu në Itali, i takon vitit 1963. Pra, vepra pati fatin e keq që të dy botimet e saj të bëhen jashtë atdheut duke vështirësuar kështu krijimin e urave të forta të komunikimit me lexuesin mbarëshqiptar. Vepra është e shkruar në një zhanr që qëndron diku mes prozës dhe poezisë, një zhanr letrar që në letërsinë evropiane ishte kultivuar bukur mirë, kurse në letërsinë shqiptare, pavarësisht se s`mund të konsiderohet model i arketipit, gjithsesi paraqet një zhanr të trajtuar pak.

Në parathënien me të cilën shoqëroi botimin e dytë, Koliqi pranon se vepra është shkruar nën ndikimin e poetikës së simbolizmit, poetikë kjo që e kishte bërë Koliqin për vete dhe në veprat e së cilës shihet një art, që dallonte prej atij që krijohet në letërsinë shqiptare të kohës. Tani më, kur e kemi të njohur kohën e botimit të parë të veprës (viti 1934), e kemi të qartë se Koliqi filloi ta shkruajë këtë vepër shpejt pasi kishte përkthyer prozat poetike të Bodlerit.

Vepra është e shkruar në formë të dialogut mes autorit dhe alter egos së tij, Narcizit. *“Kur i drejtohet Narçizit, (alteregos së tij) autori ka krijuar atë procedim që në teorinë narratologjike njihet si iluzion tregimtar i vetës së dytë”* (Shehri 2006: 21). Ky zë në vetën e dytë, siç shprehet studiuesja Shehri, nuk është zëri i tregimtarit, por ai paraqitet si një instancë në tekst, si personazh i rrëfimit dhe shfaqet me fytyrën e Narcizit. Pra kemi zërin e narratorit, të paraqitur në vetën e parë dhe zërin e Narcizit. *“Thënë ndryshe, e gjithë struktura e “Pasqyrave të Narçizit” është ndërtuar mbi dialogimin e dy zërave: zërit të poetit, që rrëfen për poezinë dhe zërit të Narçizit (zëri i brendshëm i poetit), që e modelon poetikisht ligjëratën”* (Shehri 2006: 24). Këto dy zëra herë janë bashkë, e herë të ndarë.

Vepra është e veçantë për shumëçka, sa për zhanrin që i takon, aq edhe për faktin se në të i këndohet poezisë, gjegjësisht sakrifikimit dhe gjakimit për të, sado që mënyra që autori paraqet gjodhi për të rrëfyer këtë vetëflim i takon modelit prozaik.

Mendojmë se vepra *“Pasqyrat e Narçizit”* paraqet një model të mirë të veprës, në të cilën mund të aplikohet teoria e Zhak Lakanit. Në pjesët ku flitet për fëmijërinë, zëri i fëmijës (narratorit) dhe zëri i poetit (zëri i tij i brendshëm) janë të pandarë. Kjo na kujton fazën e parë nga teoria psikoanaliste e La-

kanit, fazë në të cilën fëmija e ndjen veten të pandarë nga nëna e tij.

Në shtatë pasqyrat, aq sa ka vepra, Narcizit do t'i pasqyrohen fytyra të ndryshme në momente të ndryshme të jetës, derisa ta gjejë fytyrën e tij të vërtetë. Paraqiten këtu mënyra të ndryshme si përjetohet prania e tjetrit në zërin e tij. Në kërkim të fytyrës së tij të vërtetë, paraqitet edhe opozita *vetanakja /e huaja: “Eja midis nesh, o Narçiz, që mje sot dashunove mâ fort çezmet e mërmerta zbukuruese fytyrash, se sa krojet e epëra të bjeshkëvet qi fytyrat i pasqyrojnë besnikisht, ashtu si janë”* (Koliqi 2003: 339).

Në kërkim të fytyrës së tij të vërtetë, Narcizi takoi mjaft fytyra, disa prej të cilave e kishte të vështirë t'i njeh. Në fytyrën e tij ai gjen tiparet e të parëve, gjen rrënjët e tij, lidhjet me rrënjët e gjakut, gjë që na kujton lidhjen me nënën nga teoria e Lakanit. *“U përkula me pí në curril të kronit edhe më doli vetja e pasqrueme n`uj të lugut. Me at gashup në shtat, dukeshem një njeri tjetër, i panjoftun. Larg ishin pasqyrat me suaza t`arta të shtëpis s`eme në qytet. Po ishem unë e jo tjetër kush. Syt veçse ndritshin tue qitun do shkëndija të mysterëshme. Sigurisht në fytyrën t`ime aty përtrëteshin typaret e ndoj stërgjyshi bari”* (Koliqi 2003: 338).

Udhëtimi në horizontale dhe vertikale

Narcizi i Koliqit pëson një transformim. E kemi të njohur faktin se karakteri i njeriut, shijet, mendimet, shprehitë ndryshojnë me kohë, ashtu siç ndryshon edhe protagonistin e veprës. Në teorinë bashkëkohore mbi identitetin, faktorit kohë i kushtohet kujdes i veçantë, meqë alteriteti rritet me kalimin e kohës, kështu që *“unë”* sot nuk jam ai që isha dje, por jam *“ndryshe”*, pra *“tjetër”*.

Në pjesë të ndryshme të veprës shihet gjakimi i Narcizit për të depërtuar në vertikale, për të depërtuar sa më thellë, atje ku e thërret zëri i tokës, rrënjët e të parëve, atje ku mund të ndjej gjakun e vet. Pra, në qendër të vëmendjes është gjakimi për të gjetur fytyrën e vërtetë, gjakim ky që kalon nëpër disa faza dhe që shoqërohet me një kronotop të veçantë. Ajo që është e përbashkët për të shtatë pasqyrat është prezenca e rrjedhës së ujit që, si personifikim i kohës që rrjedh, lidh ambiente dhe kohë të ndryshme.

Në aspekt të hapësirës, vepra karakterizohet me udhëtim ciklik hapësinor. Udhëtimi fillon në pusin e shtëpisë së autorit, në qytetin e tij të lindjes, në Shkodër, për të vazhduar brenda qytetit, gjegjësisht në Shkodër (*Pasqyrë e vjetër shkodrane*). Udhëtimi vazhdon pastaj në rrethinë e Shkodrës, në Bardhanjorë, për të vazhduar pastaj jashta vendit dhe për t'u kthyer sërish në brigjet e detit shqiptar e për të mbyllur ciklin në shtëpinë shkodrane, te *“Xhami i dritores s`ime”*.

Ikja jashta vendit është sfidë, meqë paraqet orientim drejt “të huajës”, të panjohurës e cila gjakohet. Interpretuar në gjuhën bashkëkohore, njeriu mëton ta ndërtojë identitetin e tij vetanak, nëpërmjet të dialogut të hapur me të ndryshmen, tjetrën, të huajën. Ky kontakt rrit fuqinë dhe dëshirën e njeriut për kthim, për njohje të rrënjëve, të vetes. Është i njohur fakti se ai që do të zbulojë veten, duhet të kthehet në të kaluarën, ta kujtojë atë, ta rifreskojë, natyrisht jo për të mbetur brenda saj, por për të ndërtuar të ardhmen. E kaluara e ndihmon individin ta zbulojë identitetin e tij të vërtetë.

Pra, në vepër: “*modeli hapësinor i botës bëhet element organizues përreth të cilit ndërtohen edhe karakteristikat jo hapsinore.*” (Shehri 2006: 77, cituar sipas Lotman 1991: 264). Rugëtimi koliqian në këtë vepër fillon dhe mbaron në shtëpi. Duke rikultuar opusin letrar të Koliqit e kemi parasysh se roli që luan shtëpia në vepër e Koliqit është shumë i madh. Për të shtëpia tipike qytetare shkodrane, me çardak të madh, me oborr e me avlli të mëdha, brenda të cilave gjendet pusi, nuk është vetëm vend jetese dhe vend me të cilin e lidhin kujtimet nga e kaluara, por është edhe vend ku ai zbulon dhe një vetveten dhe raportet e tij me njerëzit që e rrethojnë dhe që i do. Vendlindja dhe shtëpia e parë, në veprën e Koliqit, mbetet një skutë e pazëvendësueshme, gjë kjo që na kujton një thënie të Paskalit sipas së cilit: “*Vetëm shprehitë ndikojnë që çdokush prej nesh të jetë i kënaqur nga vendi ku natyra e ka rrënjosur*” (Paskal 1965: 65).

Në aspekt të kohës dominon koha e kryer, meqë prozat poetike paraqesin kujtime për faza të caktuara të jetës së heroit ose të të parëve të tij. E kujtimi ose memorja, siç e kemi të njohur, paraqet një shtytës të rëndësishëm letrar. Rrjedha e kohës në vepër nuk është rrjedhë kronologjike. Në tekste të ndryshme kemi kthim në kohë të ndryshme. Nuk është e vështirë këtu të hetohet kthimi në rini, kthimi në fëmijëri, madje deri në kohën e lindjes. “*Në një natë maji të fali Zoti mun ke rrëja e drandofillit qi lulzon afër pusit. Nuk dij mirë kush të sollli n’oborr t’onë. Ndoj engull i bardhë tue rrëshqitë gjatë njëj rrezje hâne a por Floçka e Pusit qi njëf udhat e nëndhëshme dhe u a bjen nânave fmijt nga mbretnit e largta t’Agimit*” (Koliqi 2003: 318-319). Udhëtimi në kohë vazhdon edhe më tej, duke depërtuar edhe më thellë, në rrënjët e gjakut, në rrënjët e të parëve. Koliqi është ngushtë i lidhur me rrënjët, prej të cilave qe shkëputur, andaj këtë gjakim pas rrënjëve e gjejmë dendur në veprën e tij në përgjithësi dhe në kryeveprën në veçanti. Fundja, biografite e shkrimtarëve të mëdhenj na njohtojnë se ata qenë, jo vetëm individualistë të mëdhenj, por edhe njerëz të lidhur me rrënjët. “*Lëshoju në parzëm të tokës shqiptare, o camërdhok i shqetë e andërrtar, po deshte m’u*

fuqisue në trup e në shpirt për të rrahë nesër trimnisht udhat e vishtira të jetës /.../ Visare të panjehuna mshefen në gjí të kësaj toke dhe në jetën plot pármje të lashta qi ajo ushqen /.../ Kjo áshft fryma qi ushqei të Parët e lashtë, ky áshft zâni i Shqipnis. Pastroju n’at frymë dhe at zâ përpiqu m’e kuptue tue nxjerrë prej si trashigimet e përvojës s’atyne qi të dhuruen gjakun ndër dej. Këta lisa qi të ngushullojnë me hije të lehtë janë vëllazënt të tuej. Të njëjtaj langje ushqejnë ata edhe ty.” (Koliqi 2003: 337).

Atë e thërret zëri i të parëve, me fytyrën e të cilëve nuk do të identifikohet, meqë ka nevojë për një fytyrë të re. Por, gjithsesi, zëri i të parëve i ndihmon në gjetjen e fytyrës së vërtetë. Kontakti me ta e bën të kuptojë se: “*Unë kam dëshire mâ të gjâna e mâ të nalta /.../ Në këtë breshnuer të marrun drite unë due me kundrue fytyrën t’ime të ré jo fytyrat e jueja të vjetra /.../ - Po fytyra jote áshft e jona. Ne jemi përtí në ty. Kët ngushullim falë jeta e brishtë njerzore: drita e gjakut sa fiket në prindin ndezet në djalin e, me të, fisnikija e dëshireve. Ti jé djali i ynë e në ty vlon gjaku që bâni me lulezue prandvernâ t’ona. Mos na bje mohit /.../ Ti jé krejt i yni. Na të kemi gjinikue. Gojdhâna e jonë duhet të vazhdojë në ty e në poezin t’ande.*” (Koliqi 2003: 327).

Hapërimi i tij Brenda dhe Jashtë për të gjetur fytyrën e tij të vërtetë dëshmon prezencën e një dileme identitare, dëshmon dilemën *Ne / Të tjerët*, dilemën *Mal / Det*. Njohja e *Tjetrit* na mundëson të gjejmë atë që kërkojmë nga *Vetja*. Fytyrën e tij të vërtetë Narcizi e gjen te “*Kroni i Bardhanjorvet*”.

Për dallim prej hapësirës, e cila është hapësirë e tokës shqiptare ose tokë e huaj dhe si e tillë është reale, koha që është objekt trajtimi nuk është kohë konkrete, objektive, por është kohë subjektive, mitike, “*Qindrova vetëm dhetë dit në Bardhanjorë, por në kujtimin t’em ajo kohë e shkurtë zgjatohet e merr përpjestimet e një stinë së plotë, stinë e dendur me tronditje shpirtnore të nduernduerta*” (Koliqi 2003: 332). Është kjo një shëtitje, jo vetëm në faza të ndryshme të jetës së heroit, por edhe depërtim në rrënjët etnike, në rrënjët e të parëve, me të cilët identifikohet.

Lidhja me rrënjët është e nevojshme për të gjetur atë që gjakohet –fytyrën e vërtetë. Duke nisur nga bindja se “*Pasqyrat e Narçizit*” është një rrëfim ku tregohet mënyra se si formëzohet poezia, kreacioni poetik, pranohet mendimi se këtë vepër duhet shqyrtuar “*si kërthizë të krijimtarisë së tij si në prozë, ashtu edhe në poezi*” (Shehri 2006: 102).

Rruga e vetëzbulimit

Hapërimi i Koliqit në hapësirë dhe në kohë bëhet më qëllim që të njihet realiteti i thellë i botës që duhet zbuluar e bashkë me të duhet zbuluar edhe shpirtin vetanak, fytyrën e tij të vërtetë. Modelimi i botës bëhet nëpërmjet të dy zërave, atij të

narratorit dhe atij të Narcizit (vetes së tij të dytë). Pra kemi një botë të dualizuar, një botë që depërton brenda natyrës së njeriut, krijuesit.

Rruga e mundimshme për të gjetur identitetin, qoftë ai personal, krijues e kombëtar paraqet esencën e kryeveprës letrare të Koliqit, e veprës që shënon një hyrje të sigurtë drejt një drejtimi të ri letrar, drejt simbolizmit, duke ndikuar kështu në ngritjen e një horizonti të ri të pritjes në letërsinë shqiptare, në një kohë kur hapërimet drejt simbolizmit në poezi i bënte i madhi L. Poradeci, në një kohë kur në një zhanr miks letrar, siç qe proza poetike, simbolistët e mëdhenj botërorë gjenin privilegjet që ofronte edhe njëri zhanr edhe tjetri. Mbase (s') është rastësi që kryevepra e Koliqit dhe ajo e lirikut më të madh të shek. XX, përfaqësuesit të parë të madh të simbolizmit në poezinë shqipe, Lasgush Poradecit, i kushtohet krijuesit, sakrificës së tij dhe atij: "*Mund (i) pa fund për art magjie*" (Poradeci 1990: 351).

Narcizi i Koliqit është një kërkues i vetes, i aftësive të tij krijuese, i kredos së tij. Ky gjakim për vetënjohje, shoqërohet me shumë përpjekje të mundimshme. Atij i duhet të endet brenda e jashtë, të ndalet nëpër pasqyra të shumta, ku gjen të pasqyruar veten dhe të parët, derisa gjen veten e tij. Në këtë rrugë të lodhshme, ai pëson shumë metamorfoza duke u shndërruar në një Antinarciz, pra pëson një transformim të madh, pavarësisht se ai i mbetet prore mirënjohës mitit burimor, në të cilin mbështetet dhe i cili i ndihmon në këtë rrugë të vetënjohjes. Atë e ftojnë kroje dhe pasqyra të ndryshme, ku sheh veten në faza të ndryshme të jetës dhe në gjendje të ndryshme. Sheh në ato pasqyra edhe fytyrat e të parëve, që gjithashtu e ndihmojnë në gjetjen e identitetit vetanak. Bredhjet e tij në këtë lavirinth, fillojnë dhe mbarojnë në oborrin e shtëpisë, atje ku ai, pas vizitave që bëri në qytetin e tij të lindjes, në Alpet shqiptare e në Malësi, në vend të huaj e në bregdetin shqiptar, pas shumë kuvendimeve me rrënjët, prej të cilave s' mund të shkëputet, por te të cilat as nuk don të mbetet, meqë kërkon më shumë se ata, kërkon një fytyrë tjetërsoj, kërkon një kompromis mes malit e detit, duke ndërë brenda vetes diçka "*si një flatër e ndrydhur qi donte m' u lirue e m' u çelë në fluturim. Orvatej kot me fitue lirin*".

Narcizi kupton se brenda tij ka diçka që kërkon lirinë: "*E një dëshirë i thershem më pushtoi me e hapë burgun mbrenda meje ku viente flatra në përpjekje të pafuqishme lirimi edhe burgjet e panjehuna ku mshefet bukurija e vërtetë e sendeve të botës, me i këputë verigat qi mbajnë të ngujueme në heshtje e n'errsi fytyrën e vërtetë t'onë e të çdo njeriu, a gjāsëndi qi na rrethon. Vetëm ajo flatër e kapërthyeme në mish, qi lëvitte në mue, vetëm ajo ndoshta mund të më ndihmonte me përhapun një*

lajm të kulluet lirije e shpërblimi sipër shpirtit të mshefun të sendeve e sipër gjumit të palavdi të vëllazenve", për të vazhduar: "*E u dridh në mue kureshtja e Udhtimit andej jetës, kureshtja e liris mbas zgjidhjes nga verigat e mishit*" (Koliqi 2003: 358-359).

Pasi e kishte gjetur fytyrën e tij të vërtetë, bukurinë e vërtetë, ai tani dëshiron që ta çlirojë atë bukuri nga verigat që e mbajnë të ngjuar. Flatra që ndjente në shpirt kërkonte lirinë. Ai gjakon udhëtimin andej jetës, i prirur nga kureshtja për liri. Narcizi i Koliqit paraqet veten e dytë të rrëfimitarit, që herë bashkohet e herë është i ndarë prej tij. Në qendër të vëmendjes është fenomeni i dyzimit, fenomen ky që në këtë vepër, sipas bindjes sonë, ofron mundësi për aplikim të teorisë së Zhak Lakanit.

Narcizi i Koliqit na kujton fëmijën nga teoria e Lakanit, i cili në fazën e parë të jetës e ndjen veten të pandarë nga nëna, nga matrica, ashtu siç e ndjen veten të pandarë Narcizi nga të parët e tij, nga stërgjyshërit, zëri i të cilëve e ndjek dhe fytyrat e të cilëve i pasqyrohen. Me kohë, në kërkim të vetvetes, ai fillon të kuptojë se ai i takon një kohe të re dhe identifikimi me të parët do të ishte humbje, prandaj ju drejtohet hijeve të të parëve me fjalët: "*Unë kam dëshirë më të gjana e më të nalta /.../ Në këtë breshnues të marrun drite unë due me kundrue fytyrën t'ime të ré jo fytyrat e jueja të vjetra*", diçka që na kujton fazën e dytë nga teoria e Lakanit, kur fëmija fillon ta kuptojë vetën të ndarë nga mjedisi, sidomos nga nëna.

Në këtë fazë, fëmija fillon ta sheh veten në pasqyrë. Në këtë fazë të dytë (gjithmonë sipas teorisë së Lakanit), vendin e *Nevojës*, që dominon në fazën e parë e ze *Kërkesa*. Kjo, sipas Lakanit është sfera e *Imagjinare*, që ndyshe emërtohet edhe si "*stadium i pasqyrës*". Është kjo koha kur fëmija do ta sheh veten në pasqyrë duke filluar, në mënyrë të gabuar, ta njeh Vetën, gjegjësisht ta njeh veten duke u identifikuar me pasqyrën, pra me të jashtmen e jo me ndjenjën, përjetimin e brendshëm të identitetit të veçantë e të plotë. Kjo fazë imagjinare është faza e fotografive, pasqyrave që perceptohen vizualisht.

Në këtë fazë, njeriu fillon ta kuptojë *Tjetërshmerinë* si koncept që ndikon në formimin e pasqyrës së *Vetes*. Kjo fazë e tejkalimit të identifikimit me mjedisin, si fazë e domosdoshme për krijimin e unit vetanak është fazë mjaft e vështirë. Kështu ndodh edhe me Narcizin e Koliqit, i cili në këtë gjakim vëren se: "*në fytyrën t'ime aty përtrëteshin typaret e ndoj stërgjyshi barí*" (Koliqi 2003: 338). Aty ai gjen rrënjët, njohja me të cilët i ndihmon në rrugën e vetënjohjes, por nuk i mjafton. Endja e tij vazhdon edhe jashta vendit, ku ai gjen lirinë që mungonte në mjedisin e tij, duke zbuluar privilegjet që ofronte

deti (oksidenti), që gjithashtu i ndihmojnë në rrugën e vetënjohjes.

Pra, pasqyrimi i tij nëpër pasqyrat e ndryshme i ndihmon në rrugën e vetëbulimit. Natyrisht kjo rrugë, siç shprehet edhe Lakani, është e mundimshme dhe e shoqëruar edhe me ndjenjën e *humbjes*. Autori zbulon rrënjët nëpër pusët që burojnë nga malet, ndarja prej të cilave ishte e pamundur, ashtu siç ishte e dëmshme edhe topitja me ta. Atë nuk e bind as liria që sjell deti, pavarësisht se e turbullon. Njohja me *tjetrën, të huajën* i mundëson atij dhe fisit të tij që ta njohin më mirë Vetën: “*Punojmë për të therët tue punue për vete. Njohim hiret e lumnís së huej, por e dijmë mirfilli se ato fundin e shiptit t'onë e lânë të pakënaqun. Gjaku i ynë, për m`u dhânë shije të vërtetë ditve të shkurtat t`ona mbi ket botë, lypë një lumni origjinale shqiptare, e cila vetëm mund të lulzojë atëherë kur të xâmë me shartue urtisht filiza të njomë qytetnije prendimore në trukun e vjetër të dokeve qi kanë rrâjë të shkamb të shqipeve*” (Koliqi 2003: 354).

Vetja dhe Tjetri brenda vetëvetes

Pas udhëtimit në horizontale dhe në vertikale, Narcizi më në fund i kthehet vetes duke ndjerë lëvizjen e flatrave që kërkonin liri. Tani më ai gjen kredon e tij, gjen artin që i fle në shpirt, gjen misionin që i ishte paracaktuar, vetëzbulohet dhe sakrifikohet në emër të këtij misioni të shenjtë. Pra dialogu i tij me të parët, me vetanaken, sikurse edhe dialogu me të huajën, e ndihmojnë në procesin e mundimshëm të vetënjohjes dhe vetëbulimit të identitetit personal, në këtë rast identitetit të Poetit, Krijuesit. Është kjo faza e komunikimit që Lakani e lidh me fazën e tij *Simbolike*, fazën kur njeriu nëpërmjet të gjuhës, e krijuesi nëpërmjet të kreacionit, arrin t'i shpreh dëshirat dhe nevojat e veta, duke shpalosur atë që dëshiron ose atë që i mungon.

“*Pasqyrat e Narçizit*” është vepër kushtuar kultit të poetit, sakrificës për veprën artistike dhe lidhjes së tij me popullin dhe traditat e tij, aty ku ai i kërkon dhe gjen rrënjët e identitetit të tij, rrënjë këto që për të paraqesin një burim të pashtershmë. Narcizi i Koliqit është kërkues i pasionuar. Ai, për të gjetur fytyrën e tij të vërtetë hapëron nëpër kohë e hapësirë, brenda e jashtë, duke thithur nga rrënjët e të parëve si dhe nga kultura e huaj.

Pra, *tjetri* në këtë vepër të Koliqit, në radhë të parë, paraqet *tjetrin brenda vetes* ose *alteregon e tij*, krijuesin. Të vetmen prani të vërtetë të “*tjetrit*” në kuptimin e plotë të fjalës (në përjashtim të disa hijeve në pasqyra dhe të miqve që e shoqërojnë ose i viziton gjatë shëtitjes së tij) e gjejmë te figura e një nuseje malësore, që mezi ecte nga pesha e madhe e drunjve që mbante në shpinë. Kjo pamje prishi disponimin e mrekullueshëm që kishte ngjallë vizita në këto anë “*Aty mbaroi kremtja e syve të mi. Gjith*

ajo bukurí natyrore, ai blerim, ajo njomsí, ai qiell i kulluet, ajo dritë e gjallë bájshin me spikatë shemtimin e asaj krijatyre kërrutzue nën peshë qi barte” (Koliqi 2003: 341).

Kjo kreaturë, ia kujton autorit një fakt të hidhur, se si kjo nuse edhe shumë shqiptare tjera ngarkohen për t'i bërë punët e burrave, derisa burrat e tyre vriten për gjakmarrje ose detyrohet të qëndrojnë të ngujuar nëpër kullat e tyre.

Koliqi ishte i vetëdijshtë se rruga e poetit është e mundimshme dhe e gjatë, ashtu siç ishte i bindur se vetëm vepra e mirëfilltë i mundëson krijuesit që t'i ikë, t'i shpëtojë harresës, andaj shprehet: “*Poet njeriu len (asht dhuratë e natyrës kjo cilsí), artist bahet (mbas një mundimi të padam) dhe po aty ai sqaron: “Arti nuk asht një gjasend që krijohet aty për aty në kambë e në dorë. Arti don qindravjetsh kushtimi për t`u ba pajë e një kombi, don vjet e vjet punë për t`u ba zeje e njeriut*” (Autorë të ndaluar 2008: 121).

Në këtë rrugë të gjatë të vetëbulimit, vjen në shprehje edhe fenomeni i ndarjes, dyzimit të personalitetit, që bëhet me qëllim të njohjes dhe zotërimit më të mirë të vetvetes. Pra, bëhet fjalë për ndarje që nuk bëhet për qëllim të kundërvënies së *Vetes* dhe *Tjetrit* brenda vetes, por bëhet me qëllim të bashkimit të sërishëm, duke gjakuar një personalitet më të fortë, më unik që ka një synim të qartë, të cilit mundohet t'i shërbejë. Pra, bëhet fjalë për një ndarje konstruktive.

Në këtë vepër pas bashkimit të *vetes* dhe *tjetrit brenda vetes* dhe arritjes së unitetit të brendshëm, për të qenë ky unitet më i plotë, vjen deri te bashkimi i vetës së parë njëjes dhe shumës *Unë* me *Ne*, pra bëhet një simbiozë mes identitetit personal dhe atij kombëtar.

Dimë se identiteti është kategori komplekse që në vetë përfshin disa komponenta. Sigurisht nuk është e rastit që kur bëhet fjalë për çështjen komplekse të identitetit, tek shqiptari dhe ballkanasi në përgjithësi, së pari ky nocion do të zgjonte asociacione të identitetit kombëtar apo etnik. Prandaj për mentalitetin dhe psikologjinë e shqiptarit, uniteti i plotë identitar nuk mund të paramendohet pa këtë bashkëveprim dhe bashkim të *Unë* me *Ne*.

Versionet e veprës

Në versionin e parë të 1934 kemi dy proza poetike, te të cilat Koliqi ka intervenuar mjaft në botimin e dytë. Bëhet fjalë për prozat poetike “*Tue u shikue në sytë e saj*” dhe “*Çezmja e lulevileve*”, ku na paraqitet Narcizi fëmijë, Narcizi mohues i dashurisë së vajzës, Narcizi i dhënë pas qejfeve. Pra në këto pjesë të botimit të parë, kemi një Narcizi që përkon më tepër me Narcizin mitologjik.

Në prozën e parë të botimit të dytë me titull “*Ujë e pusit*”, Koliqi nuk ndalet në shpjegimin e hipotekstit të tij të njohur, i bindur se një shpjegim i tillë do të

ishite i tepërt dhe do ta rëndonte tekstin. Kronotopi i kësaj proze poetike është dukshëm më i ngushtë se ai i botimit të parë. Autori e saktëson kohën e ngjarjes, është gjysma e muajit maj, kurse vendi është oborri i shtëpisë së autorit, gjegjësisht pusi i këtij oborri, ku ai dëgjon zërin e të parëve. Te pusi preku ujin e ftohtë, që vinte nga projektet e tërë tokës shqiptare, ashtu siç mbledhte zemra e autorit gjakun e tërë fisit të tij.

Pavarësisht se Koliqi në këtë vepër zgjodhi që të ikë nga etja e Narcizit, ai megjithatë i është mirënjohës Narcizit, meqë ai i ndihmoi të gjejë rrugën e jetës dhe i fali një ëndërr të bukur.

Në prozën e dytë, autori paralajmëron humbjen e Narcizit mitologjik. Pra, me kohë kemi një transformim të figurës së Narcizit, gjegjësisht vdekjen e Narcizit të vjetër dhe lindjen e një Narcizi të ri, një Antinarcizi.

Në dy prozat e para poetike të botimit të vitit 1963, Koliqi bën shumë ndryshime nga versioni i parë (ai i vitit 1934). Vet ky fakt na njohton se Koliqi ruan një qëndrim kritik ndaj veprës së tij dhe investon në përkryerjen e saj. Në këto dy proza poetike intervenimet e Koliqit janë intervenime të tipit të versioneve e jo varianteve, meqë janë intervenime që prekin edhe semantostukturën e tekstit. Ndryshimet vërehen që në titujt e prozave poetike, si elemente të paratekstit.

Në këtë rast flasim për intervenime të ripunimit të veprës, kurse për intervenimet e fazës së përpunimit, njohja me të cilat do të na njihje me laboratorin krijues të autori, s'mund të flasim, përderisa burimet e tilla i kemi të panjohura.

Literatura

БЛЕЗ, Паскал (1965), *Мисли*, Култура, Београд.

GENETTE, Gerald (1997), *Paratexts*, Cambridge University Press, Cambridge.

HAMITI, Sabri (2003), *Studime letrare*, ASHAK (Botime të veçanta XLIX, Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Libri 21), Prishtinë.

KOLIQUI, Ernest (2003), *Vepra II*, Faik Konica, Prishtinë.

LOTMAN, Jurij (1991), *The structure of the artistic text*, Londër.

PLASARI, Aurel (1991), "Qasje tregimit të Koliqit", Nëntori, Tiranë.

PORADECI, Lasgush (1990), *Vepra letrare*, Naim Frashëri, Tiranë.

STUDIME për autorë të ndaluar (2008), Qendra e studimeve albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë.

SHEHRI, Dhurata (2006), *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë.

Intervenimet e bëra në këto dy proza poetike në të dy versionet e kryeveprës së Koliqit dhe njëres ndër veprave më të arrira të letërsisë shqipe të shek. XX, sidomos në prozën e parë, mendojmë se, pos mëtit për përkryerje artistike, kanë për qëllim edhe homogjenizimin e mikroteksteve në kuadër të makrotekstit, meqë janë edhe intervenime të natyrës integrale.

Përfundim

Nga gjitha ajo që përmendëm më sipër, mund të përfundojmë se *Pasqyrat e Narçizit*, si një vepër e madhe artistike, ofron mundësi për lexime dhe qasje të ndryshme. Ne, kësaj radhe, u munduar që gjatë këtij rileximi, të ndalemi në raportin e veprës me hipotekstin e saj mitologjik si dhe në dialogun mes *Vetes* dhe *Tjetrit brenda vetes* në këtë vepër, që paraqet kulmet e letërsisë shqiptare të kohës kur u shkrua, duke u munduar që të shfrytëzojmë përparësitë që ofron teoria e Zhak Lakanit për një qasje tjetërsoj ndaj këtij margaritari të letërsisë sonë, duke arritur në përfundim se në këtë vepër të Koliqit, vjen në shprehje edhe fenomeni i ndarjes, dyzimit të personalitetit, ndarje kjo që nuk bëhet me qëllim të ndarjes së *Vetes* dhe *Tjetrit brenda vetes*, por bëhet me qëllim të bashkimit të sërishëm, duke gjakuar një personalitet më të fortë, që synon vetëzbulimin dhe vetënjohjen si dhe identifikimin dhe sakrifikim e *Krijuesit* në emër të veprës, kreacionit. Pra, bëhet fjalë për një ndarje konstruktive, që shpie deri te bashkimi i *Unë* me *Ne*, duke krijuar kështu një simbiozë mes identitetit personal, kombëtar, madje edhe njerëzor, në përgjithësi.

PËRDORIMI I FJALËVE ANGLEZE NGA TË RINJTË SHQIPTAR THE USE OF ENGLISH WORDS FROM ALBANIAN YOUTH

ZURIJETA SALIU

Shkolla e mesme komunale "Negotinë" Negotinë
Dobridoll, Gostivar, REPUBLIKA E MAQEDONISË
zurijeta_saliu@live.com

Përmbledhje

Një ndër drejtimet kryesore të studimeve të sotme është edhe prania e fjalëve të huaja dhe përdorimi i tyre duke u lidhur me fjalët shqipe. Të rinjtë shqiptarë kohën e fundit kanë filluar që në fjalorin e tyre të përditshëm të fusin edhe fjalë angleze, që në të kaluarën ndodhte me fjalët turke dhe sllave. Arsyeja e përdorimit të anglicizmave është nga zhvillimi i teknologjive të reja informative që gjithkë e kanë në gjuhën angleze dhe kjo shumë lehtë depërton në gjuhën e përditshme. Këto fjalë jo vetëm që fliten, por edhe shkruhen gjatë komunikimit ndërmjet të rinjëve, nëpër rrjete të ndryshme shoqërore, programe që instalohen në telefona celularë, laptopa etj. Në këtë hulumtim do ti shohim fjalët më të përdorura që janë mbledhur nga një grup i të rinjëve, fjalët e folura dhe fjalët e shkruara angleze në vend të fjalëve shqipe.

Fjalë çelës: fjalët, komunikim, rinjtë, gjuha dhe angleze.

Abstract

One of the main directions of research today is the presence of foreign words and their use being associated with the Albanian words. Young Albanians have recently started in their daily vocabulary to enter the English word, which in the past was happening with turkish and slavic words. The reason of using English is the development of new information technologies that have everything in English and it easily penetrates into everyday language. These words not only spoken but written in communication among young people, through various social networks, programs that are installed on mobile phones, laptops etc. In this research will see the most used words that were collected by a group of young, words spoken and written English words instead of Albanian words.

Keywords: words, communication, youth, language and English.

Hyrje

Gjuha si mjet komunikimi gjatë përdorimit kohë pas kohe pëson ndryshime që nuk mund të ndërpriten. Sa i përket gjuhës shqipe në komunikimet e përditshme ka pësuar shumë ndryshime, gjithashtu edhe janë futur shumë fjalë të huaja, në kohën e fundit me të madhe janë duke u futur fjalët angleze që jo vetëm që fliten, por edhe shkruhen.

Fjalët angleze në fjalësin e të rinjve

Të shkruara i hasim më tepër në komunikimet elektronike në mes të rinjëve dhe arsyeja e përdorimit të këtyre fjalëve është se gjuha angleze është edhe gjuha e internetit. Kjo gjuhë është e përhapur, jo vetëm për anglezët, por edhe për të gjithë popujt tjerë ku ju bashkangjitet edhe populli shqiptar i cili me të madhe përdor fjalë angleze.

Përdorimi i këtyre fjalëve vjen jo vetëm nga pakujdesia e moskokëçarja, por gjithashtu edhe nga shpejtësia e të shkruarit. Disa fjalë dhe shprehje nga anglishtja janë më të shkurtëra se përgjegjëset në shqip, ndaj shqipshkruesit i bien shkurt. (Çepani, 2006:396)

Disa fjalë të huaja që i hasim më dendur janë: **away** – jo dhe aq zënë, **as soon as possible** – sa më shpejtë, **best friend** – shoku më i mirë, **best friend for ever** – shoku më i mirë përgjithmonë, **bay the way** – ndërmjet fjalës, **be right the back** –

kthehem menjëherë, **be right back** – kthehem menjëherë, **be back later** – kthehem më vonë, **busy** – e zënë, **boy friend** – i dashuri, **bye bye** – mirupafshim, **by the way** – me që ra fjala, **busy** – i zënë, **baby** – fëmijë, **bored** – bezdi, **blue** – e kaltërt, **don't worry** – mos u brengos, **don't like** – nuk e pëlqej, **for the record** – për rekord, **for the win** – për fitore, **friend** – shok, **for ever** – përgjithmonë, **for your eyes only** – vetëm për sytë e tu, **fifty – fifty** – pesëdhjetë – pesëdhjetë (gjysëm për gjysëm), **for you information** – për informimin tënd, **girlfriend** – e dashur, **great** – shkëlqyeshëm, **home** – shtëpi, **happy birthday** – urime ditëlindjen, **hugs and kisses** – përqafime dhe puthje, **hello** – tung, **in my opinion** – për mendimin tim, **in other words** – me fjalë tjera, **in your dreams** – në ëndërrat tuaja, **I miss you** – më mungon, **keep in touch** – do jemi në kontakt, **kiss** – puthje, **love yeah** – dashuria – po????, **I love you** – të dua, **like** – pëlqej, **laughing and loun** – qeshje me zë, **let me know** – më le ta dijë, **live** – jetoj, **laugh out loud** – qeshje me zë të lartë, **love** – dashuri, **I miss you** – më mungon, **never** – kurrë, **no problem** – nuk ka problem, **no think** – s'ka gjë, **on the other hand** – nga ana tjetër, **on line** – në linjë, **okay** – në rregull, **oh my good** – zoti im, **online** – lirë, **please** – të lutem, **party** – festë, **pink**

– rozë, **play** – lëshoje, **relation ship** – në një marrëdhënie, **someone** – dikush, **surprise** – befasi, **smile** – buzëqeshje, **single** – vetëm, **sweet** – e ëmbël, **take your time** – merre me avash, **thanks in advance** – para falënderim, **thanks** – faleminderit, **thank you** – ju faleminderit, **think** – mendoj, **very nice** – shumë bukur, **why** – përse, **what** – si, **welcome back** – mirë se u ktheve, **you got mail** – a e more postën elektronike, **yes** – po, **you only live once** - jetohet vetëm një herë, **you** – ti etj.

Ka edhe shumë e më shumë fjalë të tjera që përdoren nëpër rrjete të ndryshme sociale, pa dallim moshe dhe vendi, ato përdoren qoftë në trojet shqiptare, qoftë edhe nga populli shqiptarë në diasporë dhe anembanë botës.

Nëpër rrjete të ndryshme sociale hasim edhe shumë fjalë të tjera të gjuhëve të huaja, por këto janë disa nga fjalët që janë përdorur nga gjenerata të ndryshme si: nxënës të shkollave fillore, nxënës të shkollave të mesme, studentë, shqiptarë që jetojnë në diasporë etj.

Fjalët angleze përmes mjeteve elektronike sipas moshave

Gjuha shqipe ka pësuar shumë ndryshime, ndryshimet janë si pasojë e përdorimit të tepërt të internetit.

Sot të rinjtë në botë kanë krijuar gjuhën e internetit, që është një gjuhë e veçantë për secilin komb bazuar në gjuhën e tij, por me shkurtime. (Çepani, 2006:396)

Kur në krijimtarinë letrare gojore përdorim termin *forma të shkurtra*, që në gjuhë angleze sipas Taylor-it quhen *primary form* (formë primare), kemi parasysh ato krijime me përmbajtje të shkurtër. (Gega, 2012:672)

Përveç fjalëve që përdoren gjatë të folurit, një numër i madh i fjalëve gjenden edhe në të shkruar, e sidomos në komunikime elektronike nëpër rrjete të ndryshme sociale. Por këto fjalë më tepër i gjejmë të shkurtuara dhe të kombinuara me numra se sa fjalë të plota, ja disa të tilla: **asap** (as soon as possible) – *sa më shpejtë*, **brb** (be right back) – *kthehem menjëherë*, **bffe** (best friend for ever) – *shoqet më të mira*, **bf** (boy friend) – *i dashuri*, **4ever** (for ever) – *përgjithmonë*, **bf** (best friend) – *shoku më i mirë*, **btw** (by the way) – *me që ra fjala*, **bb** (bye bye) – *mirupafshim*, **fb** – facebook – facebook, **gf** (girlfriend) – *e dashura*, **hbd** (happy birthday) – *urime ditëlindjen*, **iou** (i love you) – *të dua*, **imy** (i miss you) – *më mungon*, **lol** (laugh out loud) – *qeshje me zë të lartë*, **luv** (love) – *dashuri*, **ly** (love yeah) – *dashuria*, **msn** (messenger) – *mesenxher*, **np** (no problem) – *pa problem*, **ok** (okay) – *në rregull*, **OMG** (oh my god) – *o Zot*, **pc** (personal kompjuter) – *kompjuter personal*, **pls** (please) – *të lutem*, **thnx** (thank you) – *faleminderit*, **u** (you) – *ti*, **vip** – (very important person) – *njeri shumë i njohur*, **x per** – *person i panjohur*, **xoxoxo** (hugs and kisses) – *përqaqime dhe puthje*, **YOLO** (you only live once) – *jetohet vetëm një herë*, **y** (why) – *përse* etj.

Përdorimi i këtyre fjalëve është bërë si shprehje e të gjithë popujve, poashtu edhe në të shumtën e raseve shkronja **ç** zëvendësohet me **ch** dhe shkronja **ë** zëvendësohet me shkronjën **w**.

Këto që theksuam më lartë ishin disa prej fjalëve më të përdorura që kam hasur gjatë këtij hulumtimi dhe jo vetëm që përdoren fjalë angleze, por edhe si akronime, përkatësisht fjalë angleze të shkurtuara.

Të dhënat janë marrë nga një grup i të rinjve që janë të evidentur më poshtë:

Tabela nr. 1

Meshkuj	72
Femra	96




Figura nr.1

Gjithesëj janë marrë 168 persona nga të cilët 72 meshkuj dhe 96 femra të moshave të ndryshme

prej 14 deri 23 vjet që në detaje do të shohim në tabelën më poshtë.

Tabela nr.2

14 vjet	22
15 vjet	22
16 vjet	18
17 vjet	5
18 vjet	19
19 vjet	38
22 vjet	32
23 vjet	12




Figura nr.2

Përfundim

Po ta shohim përdorimin e këtyre fjalëve për një periudhë më të gjatë, pa dyshim se do të gjejmë edhe një numër më të madh të fjalëve që përdoren nga populli shqiptar e sidomos nga të rinjtë, por këto ishin vetëm disa fjalë që unë i kam ndeshur gjatë hulumtimit nga të rinjtë shqiptar prej 14-23 vjet, e ndoshta shumë e më shumë përdoren nëse i hulumtojmë edhe moshat tjera.

Kështu që mendoj se këto fjalë duhet sa më pak të përdoren, kur dihet se shqipja ka thesar të pasur të fjalëve dhe shprehjeve të tilla. Përdorimi i tepërt i këtyre fjalëve ndoshta i sjell dëme gjuhës, ndërsa ne si shqiptarë duhet që sa më shumë të kujdesemi për gjuhë tonë, të mundohemi që t'i largojmë fjalët e huaja e ato ti zëvendësojmë me fjalët tona, për arsye se gjuha është mjete kryesor që e identifikon një komb.

Literatura:

Bejta, Murat (redaktor). (1988). *Fjalor i fjalëve të huaja*. Rilindja. Prishtinë.

Çepani, Anila. (2006). *Problemet e kulturës së gjuhës në përdorimin e shqipes në internet*. Në Seminari XXV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 25/1. Prishtinë.

Dajo, Stavri. (12.11.2012). *Gjuha e mesazheve elektronike të telefonisë celulare*. Në gazetën "Tribuna". Greqi.

Gega - Musa, Leontina. (2012). *Interferencat e dy formave të shkurtra të letërsisë gojore*. Në revistën shkencore të Institutit Alb – Shkenca, vëll. Nr. 4, 2012. Tiranë – Shkup – Prishtinë. F:672-676.

Spinnen, Burkhard & Verbica, Angelina. (2012). *Interneti përhap fjalë të reja – gjuha ruan të domosdoshmet*. Në Internet: www.dw.de/internet, qasja për here të fundit më 4 mars 2012.

Stefanllari, Ilo. (1988). *Fjalor Anglisht – Shqip*. Rilindja. Prishtinë.

Paçarizi, Rrahman. (2006). *Gjuha e mesenxherit*. Në "Filologji", nr.14. Prishtinë.

THE USE OF COMPUTER-BASED CORPORA AND WORD FORMATION RULES FOR THE ENRICHMENT OF STUDENT'S TECHNICAL ENGLISH VOCABULARY

PËRDORIMI I KORPUSEVE KOMPJUTERIKE DHE I RREGULLAVE TË FJALËFORMIMIT PËR PASURIMIN E FJALORIT TË ANGLISHTES TEKNIKE TË STUDENTËVE

VJOLLCA BELEGU-CAKA¹, SHYKRANE GËRMIZAJ²

University of Prishtina / Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

¹Faculty of Electrical and Computer Engineering, ²Faculty of Philology

¹Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, ²Fakulteti i Filologjisë

vjollca.caka@gmail.com; shgermizaj@yahoo.com

SUMMARY

General knowledge of English is not sufficient to study scientific and technical literature in English. Lack of knowledge of professional terminology in English affects the correct explanation of scientific phenomena, technical devices and systems. Compilation of linguistic corpora with computer software for generating vocabularies from various fields of science and technology is raising more and more attention of linguists. This process has been illustrated in this paper by using a specifically designed corpus for electrical and computer engineering. This corpus is built of 25 university text books, including main fields of studies in electrical and computer engineering, with approximately 5 million words.

Key words: Corpus linguistics, word formation, vocabulary, technical English.

PËRMBLEDHJE

